

# *Rimëkëmbje*

*dhe Zhvillim i Qëndrueshëm  
Ekonomik*

**#PDK134**

**#Rimëkëmbje**  
PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

**#PDK134**

**#Rimëkëmbje**

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



## NJË APEL PËR RIMËKËMBJE!

Partia Demokratike e Kosovës, si parti e pandashme nga projekti kombëtar i lirisë, pavarësisë dhe shtet-ndërtimit të Republikës së Kosovës, pas zgjedhjeve të 6 tetorit të vitit 2019, ka qenë një opozitë e fuqishme parlamentare, përballë dy qeverive të koalicionit të mashtrimit dhe dështimit.

Me veprimin politik opozitar, PDK-ja ka qenë opozitë e Qeverisë Kurti dhe Qeverisë Hoti, të cilat ishin qeveri të papërgjegjshme, të paafta dhe abuzuese me vullnetin e qytetarëve. Ato dështuan në ekonomi dhe në menaxhimin e pandemisë. Këto dy qeveri dhanë shembullin më të keq duke shkelur kushtetutën dhe degraduan asetet vitale të një qeverisje të përgjegjshme. Për më tepër, me paramendim, ato dëmtuan rëndë raportin special të Kosovës me Shtetet e Bashkuara të Amerikës dhe partnerët tanë strategjik,

Përballë këtyre zhvillimeve, PDK ka qenë opozitë e fuqishme ndaj Qeverive por asnjëherë nuk ka qenë opozitë ndaj interesave të vendit dhe të qytetarëve. Përkundrazi, PDK-ja ka dhënë modelin e një opozite të mirëfilltë që i përgjigjet interesit publik pavarësisht raportit me pushtetin. Këtë e kemi dëshmuar me ligjet e buxhetit, me Pakon e Rimëkëmbjes Ekonomike, me Marrëveshjet për Asistencë Ndërkombëtare etj.

Kjo mendësi, jo vetëm që ka bërë dallimin nga ajo çfarë kemi parë në të kaluarën nga të tjerët, por edhe e ka ngritur vetëdijen politike dhe kulturën e ndërgjegjësimit politik përballë nevojave të qytetarëve. Kjo është vlera dalluese e PDK-së. Ky është modeli për të cilin angazhohemi. Por tashmë duhet edhe të marrim përgjegjësi për t'i dhënë Kosovës qeverisjen që l duhet.

Viti që lamë pas, nuk ishte vit i lehtë për ne dhe qytetarët e Kosovës, jo vetëm përballë pandemisë e paafësisë së qeverive Kurti e Hoti, por edhe përballë lëndimit të trashëgimisë sonë historike. Procesi që po zhvillohet në Hagë, na ka lënë përkohësisht pa Kryetarin e PDK-së, z. Veseli, pa ish- kryetarin e PDK-së, Presidentin Thaçi dhe shumë bashkëlufëtare të tjerë. Edhe pse jemi shumë të lënduar pa prezencën dhe angazhimin e tyre ne megjithatë kemi qëndruar të bashkuar për ta përmbushur misionin tonë politik e shtet ndërtues.

Me PDK-në, janë përbyllur projektet më të mëdha politike kombëtare dhe pa PDK-në, tashmë është e qartë se nuk mund të gjenerohet perspektivë e qëndrueshme për shtetin dhe shoqërinë tonë.

Ky është obligimi ynë, për të cilin jemi gati të marrim përgjegjësi. Duhet ta frenojmë keq-qeverisjen dhe ta fuqizojmë Republikën, brenda dhe jashtë vendit.

Prandaj në zgjedhjet e 14 shkurtit, ne do të hyjmë me vendosmëri për ta rimëkëmbur Kosovën dhe për ta rikthyer në rrugën e drejt të integritit Euro-Atlantik. PDK-ja, ofron këtë platformë elektorale gjithëpërfshirëse, jo vetëm për rimëkëmbjen ekonomike, por edhe për rimëkëmbjen politike dhe kombëtare të atdheut tonë. PDK-ja jo vetëm që ka një vizion të qartë për të ardhmen, por ka edhe ekipin më të mirë, me integritet, profesionalizëm e kompetencë për ta vënë në jetë!

Mbi këto kredenciale, duke qenë të vetëdijshëm se PDK-ja është shpresë dhe parti e vendosur për të çliruar potencialin ekonomik e zhvillimor të Kosovës, kam kënaqësinë që t'iu prezantoj platformën e Rimëkëmbjes.

Këtu do të gjeni platformën tonë të Rimëkëmbjes, me plane e premtime konkrete të cilat do t'i bëjmë realitet!

I juaji

Enver Hoxhaj



## RIMËKËMBJE DHE ZHVILLIM I QËNDRUESHËM EKONOMIK

Pandemia ishte një fatkeqësi globale, por ajo që e dalloi vendin tonë është se erdhi në kushtet kur ne tashmë ishim të infektuar nga një epidemi e keq-qeverisjes e për rrjedhojë dëmi ekonomik ishte më i madh. PDK-ja ka qenë partia e parë dhe e vetme që ka propozuar masa ekonomike për t'i ardhur në ndihmë ekonomisë së vendit që në mars të vitit të kaluar kur pandemia sapo kishte përfshirë Kosovën. Pakoja e shpëtimit dhe rimëkëmbjes së ekonomisë që propozoi PDK-ja, hasi në indiferencën dhe papërgjegjshmërinë e qeverive Kurti dhe Hoti. Kjo është një ndër arsyet kryesore përse nga një ekonomi dinamike dhe me rritjen më të madhe në rajon, ajo sot është në recesion.

PDK-ja synon që në mandatin e ardhshëm qeverisës, përmes programit të Rimëkëmbjes të riparojë dëmet e pandemisë dhe papërgjegjshmërisë së qeverive të kaluara dhe të rikthejë zhvillimin e qëndrueshëm. Për të kapur kohën e humbur dhe për të arritur standardet që qytetarët meritojnë, PDK-ja synon që të ndërmarrë ata hapa që mundësojnë një rritje të qëndrueshme ekonomike prej 5 deri 7%. Ky objektivi madhor do të mund të realizohet duke iu dhënë prioritet investimeve në buxhetin për shëndetësi, arsim, infrastrukturë të re, rend dhe ligj, duke përfshirë edhe prioritetet tjera që do të sjellin zhvillim ekonomik, jo vetëm për vitet 2021 – 2025, por edhe për dekadat e ardhshme.



## PREMTIMET E PDK-SË PËR RIMËKËMBJE DHE ZHVILLIM TË QËNDRUESHËM EKONOMIK, JANË:

**Për t'i bërë ballë problemeve dhe nevojave imediate që ka ekonomia e tronditur rëndë prej Pandemisë dhe keq-qeverisjes, PDK-ja ka parashikuar dedikimin e një fondi prej 1 miliard euro. Ky fond, do të përdoret në mënyrë të shpejtë dhe efikase për rehabilitimin e situatës, nëpërmjet hapave të mëposhtëm:**

- Do të themelohet fondi për të ndihmuar bizneset në shumë mbi 500 milionë euro në formë të mbështetjes financiare sipas kriterëve dhe kushteve të caktuara me Ligjin e buxhetit të shtetit.
- Do të bëhen pagesat e shumë së interesit të huamarrjes në bankat komerciale të Kosovës, të paguar nga prodhuesit të cilët eksportojnë mallra jashtë Kosovës, ndërmarrjet të cilat merren me agrobiznes dhe përpunimin e produkteve agrare;
- Do të hiqet obligimi që bizneset të paguajnë Tatimin e Vlerës së Shtuar (TVSh) në kufi, në mënyrë që bizneset të kenë likuiditet shtesë për operim;
- Do të bëhet ulja e Tatimit në të Ardhurat e Korporatave nga 10%, në 8%, 7%, 5% dhe 0%, varësisht nga investimet dhe numri i të punësuarve;
- Rritja e kapitalit të Fondit Kosovar për Garantimin e Kredive, deri në 100%, për të garantuar projekte të ndryshme investuese në shumë prej 100% për bizneset;
- Krijimi i një linje buxhetore në shumën prej 15 milionë euro, në buxhetin e shtetit, për t'i mbështetur financiarisht nëpërmjet granteve (para pa kthim), të rinjtë dhe të rejtat që kanë ide biznesi në formë të vetëpunësimit.

## RUAJTJA E STABILITETIT MAKRO-FISKAL

**Një ndër arritjet më të mëdha të PDK-së gjatë qeverisjes, ka qenë garantimi i një stabiliteti makroekonomik shembullor për rajonin e Ballkanit. Zbatimi i zotimeve të PDK-së do të bëhet duke ruajtur stabilitetin e Buxhetit të Kosovës në bashkëpunim të ngushtë me Fondin Monetar Ndërkombëtar, Bankën Botërore dhe institucionet tjera financiare ndërkombëtare**

- 1. Do ta mbajmë deficitin buxhetor dhe borxhin publik në kuadër të kufizimeve të rregullës fiskale;
- 2. Nuk do të ketë vendosje të tatimeve të reja dhe nuk do të ketë ngritje të tatimeve ekzistuese me përjashtim të mbrojtës së ambientit;
- 3. Në qeverinë e PDK-së, rregulla e artë do të jetë që rritja e borxhit publik dhe shfrytëzimi i tij do të bëhen në mënyrë të kujdesshme vetëm për projekte konkrete zhvillimore;
- 4. Nuk do të ketë marrje të borxhit për financimin e shpenzimeve ditore, borxhi publik do të merret vetëm në ato raste kur dëshmohet se mungojnë financimet e brendshme, por edhe në ato raste borxhi eventual do të negociohet me kreditorët më të besueshëm ndërkombëtar;
- 5. Do të bëhet rishikimi i strukturës së shpenzimeve buxhetore në favor të rritjes së investimeve kapitale dhe financimit të projekteve tjera zhvillimore, duke trajtuar dhe duke mos e lënë anash asnjëherë aspektin social.

## RIMËKËMBJE E SEKTORIT TË PRODHIMIT

PDK gjykon se një ekonomi për të pasur bazë sa më të shëndoshë dhe të ketë një të ardhme sa më të begatë, ajo duhet të ketë një sektor prodhues sa më të konsoliduar dhe efikas. Ky sektor është shumë i rëndësishëm për Kosovën sepse siguron zhvillim të qëndrueshëm, hap vende të shumta të reja të punës, ulë koston e jetës së qytetarëve, siguron të ardhura të bollshme edhe për buxhetin si dhe ulë varësinë e vendit prej produkteve të importit.

Mirëpo, ky sektor u dëmtua shumë gjatë pandemisë dhe nuk mori ndihmën që meritonte prej qeverive Kurti e Hoti. Prandaj, Partia jonë, ka një plan të qartë e konkret për rehabilitimin dhe forcimin e biznesit prodhues si dhe për nxitjen e eksporteve “Made in Kosova”. PDK-ja do të angazhohet intensivisht për rritjen e prodhimit në vendin tonë, në mënyrë që të ulën kërkesat për import dhe të shtohen eksportet që do të ulin deficitin e lartë tregtar.

**Prandaj, Programi i Partisë Demokratike të Kosovës, për Rimëkëmbjen e sektorit të prodhimit, synon:**

- i. Të alokojë resurse të nevojshme për të mbështetur specializimin e prodhuesve vendorë në degët që i ofrojnë ekonomisë sonë përparësi krahasuese, kundruall sektorit të jashtëm. Nëpërmjet këtyre aktiviteteve, synojmë rritjen e prodhimit vendor dhe zëvendësimin e importit me produktet vendore si dhe rritjen e eksportit;
- ii. Të krijojë kushte më të favorshme për tërheqjen e investimeve të huaja të drejtpërdrejta, të cilat paraqesin një burim shumë të rëndësishëm të hyrjes së kapitalit të ri dhe të dijes. Po ashtu, synojmë avancimin e dispozitave të parapara në kuadër të Ligjit për Investimet Strategjike, duke shtuar edhe dispozita të reja stimuluese në këtë ligj, me qëllim të promovimit dhe të stimulimit të ardhjes së investimeve strategjike, sipas kërkesave edhe të shtetit të Kosovës, për t’i zhvilluar rajonet e vendit tonë në mënyrë të barabartë, duke motivuar ardhjen e teknologjisë më të re;
- iii. Përmes kushteve më të favorshme, do të promovohet sjellja e dijes për ta ndihmuar zhvillimin e të rinjve dhe të rejave me njohuri profesionale, sipas kërkesave të fundit të tregut rajonal e global. Kjo do të jetë një bazë shumë e rëndësishme për bërjen e ekonomisë sonë më tërheqëse për investitorët e huaj, dhe, në të njëjtën kohë, për promovim të mundësive të shtetit tonë për të investuar. Në këtë kapitull, vëmendje e veçantë do t’i kushtohet rritjes së bizneseve në diasporë dhe në këtë kuadër do të kemi komunikim të veçantë me diasporën mbi baza të partneritetit të rregullt;

- iv. Transferimi i KIESA-së në Agjencinë e Kosovës për Punësim dhe Zhvillim Ekonomik, e cila, për shkak të rolit të rëndësishëm që ka, në të ardhmen do të transferohet në Zyrën e Kryeministrit dhe do t'i raportojë Kryeministrit. Kjo Agjenci, synon zhvillimin ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës përmes fuqizimit të sektorit privat, gjë që është në përputhje me orientimin e Partisë Demokratike të Kosovës. Më tej, kjo agjenci do të shndërrohet në një sportel të vetëm që ka për qëllim mënjanimin e burokracisë me të cilën përballen bizneset dhe do të mundësojë marrjen e të gjitha shërbimeve në një vend (One Stop Shop). Agjencia do t'i ketë tri funksione kryesore:
  1. Të mbështesë konsolidimin dhe zgjerimin e bizneseve aktuale;
  2. Të inkurajojë dhe të ndihmojë duke u ofruar të gjitha palëve shërbime nga stafi i agjencisë për investitorët, për investime të reja të brendshme dhe të jashtme, përmes rrjetit në 6 qendrat rajonale të zhvillimit ekonomik dhe të punësimit, dhe
  3. Të promovojë eksportet vendase.
- Në këtë agjenci, do të shkrihen të gjitha institucionet ekzistuese, sikur që janë zyrat rajonale të punësimit dhe do të grumbullohet ofrimi i të gjitha shërbimeve në një adresë të vetme për investitorët, në mënyrë që ta eliminojmë burokracinë dhe korrupsionin që ka qenë i pranishëm në raste të caktuara.



## RIMËKËMBJE E KLIMËS PËR TË BËRË BIZNES

PDK-ja duke qenë parti konservatore e qendrës së djathtë, beson se ekonomia e tregut është sistemi i vetëm që mundëson adoptimin e të drejtave themelore të njerëzve në ekonomi si dhe që mundëson maksimalizimin e përdorimit të burimeve duke sjellë nivelin më të lartë të efikasitetit ekonomik dhe rritjes së pasurisë së qytetarëve. Për këtë arsye, PDK në veprimtarinë e saj politike, do të udhëhiqet nga parimi i përmirësimit të klimës për të bërë biznes e cila është dëmtuar prej qeverive të fundit, të papërgjegjshme dhe neglizhente.

Për t'i ardhur në ndihmë biznesit vendas, por edhe për të tërhequr investime të reja, PDK-ja propozon masat në vijim:

1. Do t'i funksionalizojmë zonat e lira ekonomike ekzistuese dhe do të krijojmë zona të reja ekonomike me stimulime të reja. Përmes qendrave të krijuara të biznesit dhe inkubatorëve, do të vazhdojë bashkëpunimi me komunat e qytetet në mënyrë që të përmirësohet infrastruktura sipërmarrëse dhe të sigurohet mbështetja këshilluese për ndërmarrjet e reja dhe në rritje, përmes këtyre institucioneve, sipas kushteve dhe kërkesave për zhvillimin e regjioneve të ndryshme të Kosovës, duke siguruar kompletimin e infrastrukturës fizike;
2. Do të hartohet një strategji e mirëfilltë për ristrukturimin e aseteve shtetërore me rëndësi të veçantë, siç janë: Trepça, Brezovica dhe kapacitet energjetike;
3. Do të punojmë në avancimin e mëtutjeshëm të formave të partneritetet publiko-privat, për projekte të cilat shtojnë cilësinë e shërbimeve për qytetarët e vendit tonë dhe për projektet që kanë kthim në zhvillimin ekonomik;
4. Do të punojmë për lidhjen e marrëveshjes me SHBA-në për lehtësimin dhe mbrojtën e investimeve strategjike në të dyja vendet me përkrahjen e qeverive tona;
5. Do të ofrojmë mbështetje me buxhet dhe masa administrative për aktivitetet dhe projektet inovative, të cilat tani do ta kenë vëmendjen e veçantë të qeverisë;
6. Me qëllim që bizneseve t'u krijojmë

lehtësira sa më të mëdha, do të thotë se automatikisht do të krijohet hapësirë për investime të reja, apo zgjerim të biznesit ekzistues, Tatimi i Vlerës së Shtuar (TVSh), nuk do të paguhet në kufi, siç ka ndodhur deri tash, por mbledhja e TVSh-së do të behet në brendi të vendit. Me këtë reformë, biznesi do të ketë likuiditet shumë më të madh sesa që kishte deri tash dhe do të kursehet nga kreditë e ndryshme, bashkë me këtë, edhe nga detyrimet apo obligimet tjera ndaj bankave të ndryshme;

7. Do të eliminohet periudha kohore dhe shumica e mjeteve të TVSh-së për rimbursim, me qëllim që biznesi në çdo kohë ta ketë të drejtën t'i shfrytëzojë mjetet e veta që rrinë në Administratën Tatimore. Kjo do t'i japë mundësi biznesit t'i investojë mjetet e veta në shtimin e aktivitetit biznesor ose edhe në themelimin e biznesit të ri;

8. PDK-ja do të angazhohet për themelimin Bordin të Pavarur për Ankesa, si shkallë administrative dhe të Gjykatës Komerciale, me kompetencë të plotë që do të ndihmojë në krijimin e një ambienti më të mirë për bizneset vendore, por edhe për investitorët e huaj, si dhe në luftimin e korrupsionit;

9. Do të eliminohet vlerësimi i mallit në Doganë, i cili deri më tani ka shkaktuar pasiguri të bizneset gjatë importimit të mallit. Të gjithë ata që posedojnë kontratat, faturat dhe dokumentet e tjera të kërkuara sipas legjisllacionit në fuqi, nuk do të kenë vlerësim të mallit sikur deri më sot. Prandaj, do të krijojmë siguri për biznesin që çmimi i blerjes do të jetë bazë për vlerësimin dhe llogaritjen e tatimeve, si dhe do ta luftojmë korrupsionin në doganë duke eliminuar këtë mundësi për doganierët që në bazë të vullnetit të tyre të bëjnë vlerësimin e mallit.





## LEHTËSIRAT NË TATIMIN E TË ARDHURAVE TË KORPORATAVE

Një tjetër mjet i rëndësishëm i përmirësimit të klimës së biznesit dhe i konkurrencës me vendet fqinjë për investime të drejtpërdrejta të huaja, është krijimi i lehtësirave tatimore. Prandaj, në Tatimin e të Ardhurave të Korporatave të gjithë investitorët do të kenë këto stimulime:

1. Në investimet mbi 100,000,00 euro, që krijojnë mbi 5 vende të punës, tatimi në të ardhura të korporatës, do të jetë 8%;
2. Në investimet prej 500,000.00 deri në 1,000,000.00 euro, që krijojnë mbi 8 vende të punës, tatimi në të ardhura të korporatës, do të jetë 7% për 10 vite;
3. Në investimet prej 1,000,000.00 deri në 3,000,000.00 euro, që krijojnë mbi 20 vende të punës, tatimi në të ardhura të korporatës, do të jetë 5% për 10 vite;
4. Në investimet mbi 3,000,000.00 euro, që krijojnë mbi 30 vende të punës, tatimi në të ardhura të korporatës, do të jetë 0% për 10 vite;

## RIMËKËMBJE DHE FUQIZIM I NDËRMARRJEVË TË VOGLA DHE TË MESME

Bizneset e vogla dhe të mesme, luajnë një rol jashtëzakonisht të rëndësishëm në zhvillimin e ekonomisë sonë, në luftën kundër papunësisë si dhe në garantimin e maksimumit të konkurrencës në treg. Prandaj, PDK do vazhdojë t'i shikojë bizneset e këtij lloji me prioritet, duke ndërmarrë politika që të kontribuojnë sa më shumë në shtimin dhe konsolidimin e tyre. Këto biznese faktikisht janë prekur ndjeshëm prej pandemisë dhe meritojnë mbështetje nga qeveria.

Mbështetjen për bizneset e vogla dhe të mesme nuk do ta bazojmë vetëm në përmirësimin e ambientit të përgjithshëm të të bërit biznes, por edhe në një sërë masash konkrete të posaçme, nëpërmjet të cilave synojmë të ndikojmë në mënyrë të drejtpërdrejtë në fuqizimin e zhvillimit të këtij sektori. Këto masa përfshijnë: • Eliminim e shumë certifikatave, autorizimeve, lejeve të ndryshme, si dhe shumë barrierave administrative, duke i sjellë në minimumin e mundshëm vetëm ato të cilat janë të domosdoshme dhe që nuk kanë asnjë kosto (shpenzim) për krijimin e bizneseve të reja dhe për zgjerimin e atyre ekzistuese. Të gjitha licencat, do të lëshohen përmes një sistemi elektronik, pa pasur nevojë që pala të paraqitet fizikisht pranë sporteleve të ndryshme në administratën e shtetit. Përmes këtyre masave, do të kontribuojmë në dekurajimin e informalitetit, zvogëlimin e korrupsionit, si dhe në rritjen e efikasitetit të bizneseve;

- Mbështetjen e veçantë për firmat e reja ("start-ups"), duke përfshirë edhe rimbursim të pjesshëm në para të gatshme, për ato firma të cilat i plotësojnë kriteret që do të përcaktohen nga ministria kompetente. Kjo skemë ka për synim të mbështesë kryesisht ndërmarrësinë të rinjtë;
- Shfrytëzimi i tokës publike/shtetërorë = lease/qiradhënie afatgjate deri në 99 vjet për 1 euro/m<sup>2</sup>;
- Lirimin nga pagesa e tatimit në pronë për një periudhë kohore prej 5 viteve;
- Lirimin nga tatimi doganor për të gjitha kompanitë transportuese të udhëtarëve për mjetet e tyre të punës;
- Lirimin nga TVSh-ja për të gjitha barnat që importohen në Republikën e Kosovës;
- Mbështetjen për rritjen e konkurrueshmërisë së prodhuesve vendorë, si parakusht shumë i rëndësishëm për të konkurruar kundrejt produkteve nga tregjet e jashtme. Në këtë kontekst, Qeveria e PDK-së, do të promovojë rritjen e efikasitetit në prodhim, duke ofruar mbështetje financiare për prodhuesit që të investojnë në zëvendësimin e teknologjisë së vjetër me teknologji moderne;
- Inkurajimin e pjesëmarrjes së NVM-ve në projekte përmes prokurimit publik, duke rishikuar kriteret e tenderimit, si dhe duke trajnuar personelin e NVM-ve për të aplikuar në projekte të ndryshme;
- Financimin e programeve të ndryshme të edukimit dhe të trajnimit për ndërmarrësit dhe për personelin e NVM-ve me qëllim të rritjes së kulturës ndërmarrëse dhe të pajisjes me njohuri rreth praktikave moderne të menaxhimit;
- Ofrimin e mbështetjes së nevojshme për të mundësuar rritjen e qasjes së bizneseve të Kosovës në financim nga institucionet financiare ndërkombëtare, siç është Banka Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim;
- Sigurimin e konkurrencës së lirë ndërmjet bizneseve, duke luftuar ekonominë joformale, si dhe duke i ofruar mbështetje të plotë rritjes së kapaciteteve të Agjencisë së Konkurrencës;
- Rritjen e bashkëpunimit ndërmjet institucioneve të ndryshme hulumtuese, odave të bizneseve dhe qeverisë për t'i identifikuar masat e nevojshme për të mbështetur zhvillimin e bizneseve;
- Themelimin e zyrës së veçantë në Kryeministri, ku do të merren me studimin e kërkesave në fusha dhe rajone të ndryshme të Kosovës për investime. Zyra do të përgatisë projekt propozime dhe do të jetë në dispozicion të rinjve dhe të rejave për t'i konsideruar si mundësi investimi në ato projekte.

- Do të rritet mjaftueshëm numri i Inspektorëve të punës për mbikëqyrjen e zbatimit të Ligjit të Punës dhe mbrojtjen e të drejtave të të punësuarve;
- Do të ulim Tatimin mbi të Ardhurat e Korporatës nga 10% në 5% me qëllim të rritjes së pagave në mbi 500 euro në muaj në sektorin privat;
- Do të rriten pagat ekzistuese në mesatare prej 30%, për të gjithë zyrtarët në sektorin publik, përmes rregullimit të ligjit për paga. Do të rregullohen kualifikimet adekuate të pozitës së punës sipas përvojës dhe kualifikimeve profesionale;
- Do të rritet shumta e ndihmës sociale mbi 30% për të gjithë përfituesit e ndihmës sociale;
- Do të ketë rritje të të gjitha llojeve të pensionit, varësisht prej kategorisë së pensionit dhe reforma të thella për trajtimin e drejtë dhe të barabartë të të gjithë qytetarëve pensionistë, duke përfshirë në skemat e kontribut dhënësve ata qytetarë të cilët kanë pasur pengesa për arsye të mungesës së 15 viteve, ku do të jetë pension i shkallëzuar, sipas përqindjes dhe viteve:
  - I). Pensionistët e moshës ..... 40%,
  - ii). Pensionistët kontribut dhënës.....30%,
  - iii). Pensionistët veteranë të luftës.....30%, dhe
  - iv). Të gjitha pensionet tjera, në shumën.....30%.
- Familjet e dëshmorëve, do të realizojnë pensione varësisht nga numri i anëtarëve dëshmorë që kanë;
- Veteranëve nuk do t'ju ndërpritet pensioni i veteranit nëse kanë kontrata pune.
- Do të rregullohet çështja e pensioneve ku pensionistët e moshës do t'ju lejohet që të jenë përfitues edhe i pensioneve tjera ku i plotësojnë kushtet me ligj;
- Pensionistët që gëzojnë pensione bazike, nuk do të jenë të detyruar që të zgjedhin cilin do ta marrin në mesin e pensioneve, por do ta marrin edhe pensionin e moshës edhe pensionin tjetër që ia njihet ligji;
- Do të reduktohet norma TVSh-së për gjërat ushqimore për konsum të përditshëm të qytetarëve, e cila do të llogaritet dhe paguhet prej tetë për qind (8%) nga 18% sa është tani për furnizimin e mallrave dhe importin e tyre në Republikën e Kosovës;
- Do të lirohen nga TVSh-ja barnat që prodhohen në vendin tonë e të cilat eksportohen.



## RIMËKËMBJE E SHËNDETËSISË

Ngritja e një sistemi shëndetësor me vlera profesionale dhe shoqërore, është sfidë e çdo vendi, për më tepër e vendeve si Kosova, duke u bazuar në trashëgiminë e saj. Prandaj, sot kemi një sistem shëndetësor të brishtë dhe me shumë të meta, shtu këtu edhe pasojat e Pandemisë Covid -19 dhe keq-qeverisjes së qeverive të dala nga zgjedhjet e tetorit 2019. Pra, kemi një gjendje shumë të rëndë. Kjo katastrofë globale që ka prekur edhe Kosovën, do ishte shumë më e lehtë e do të kishte më pak humbje jetësh nëse qeveritë Kurti e Hoti do të kishin marrë masa me kohë dhe nëse ata liderë do të ishin përgjegjshëm, të ndjeshëm dhe të aftë për t'iu ardhur në ndihmë qytetarëve.

Që nga fillimi i pandemisë, rasteve të para në mars të 2020, Qeveria e Kosovës nuk ka arritur të menaxhojë situatën e pandemisë. Si rrjedhojë kemi pasur:

Numër të vogël të testeve; mos raportimi i rasteve nga komunat serbe; manipulimi me raportim të testeve, pranimin e mijëra testeve nga Serbia; lejimin e personelit shëndetësor nga Serbia të operojnë në territorin e Kosovës pa licencë pune të Republikës së Kosovës, emërimet politike në Bordin e ShSKUK-së nga dy Qeveritë Kurti e Hoti, abuzimet me tenderë gjatë pandemisë, blerje të barnave dhe pajisjeve mbrojtëse me çmime abuzive shumëfish më të shtrenjta, etj., janë disa nga dështimet e Qeverive të dala nga zgjedhjet e tetorit 2019.

Si rrjedhojë, Kosova është vendi i vetëm në botë që ka kaluar tri faza të pandemisë. Faza e parë nga marsi deri qershor 2020, Faza e dytë nga korriku deri në shtator 2020, dhe Faza e tretë, ka filluar në tetor 2020 dhe është në vijim e sipër.

Prandaj, Partia Demokratike ka dizajnuar një program, i cili i jep përgjigje pandemisë, fillon me sigurimet shëndetësore si mburojë financiare për qytetarët, afron mjekun dhe qytetarin, si dhe modernizon sistemin shëndetësor. Një program që rikthen punët e mira që ne nisëm në vitin 2017, por të cilat u ndalën nga Qeveria Kurti dhe Hoti. Ata i ndalën shërbimet falas në spitalet publike që ishin jetike për qytetarët. I ndalën stentimet në zemër në QKUK, përderisa ato vazhduan në spitale private. Detyruan qytetarin që për një shërbim, të cilin e merrte falas, të paguajë prapë mijëra euro, në një kohë krize të thellë ekonomike.

Kur PDK-ja ka drejtuar Ministrinë e Shëndetësisë, në vitin 2017, numri i stentimeve ishte vetëm 650 në vit. Me reformë dhe investime, në vitin 2019, stentimet arritën në 2350 në vit.

Fatkeqësisht, edhe këtë shërbim esencial që shpëton jetë, qeveritë Kurti e Hoti një herë e ndalën, pastaj e përgjysmuan dhe përfundimisht e përkeqësuan. Në vitin 2020, u bënë vetëm 1150 stentime, pra gjysma e vitit pararendës.

Abuzimi ndodhi edhe në blerjen e barnave dhe materialeve shpenzuese. Në emër të pandemisë, dy Qeveritë blenë deri në 3000% më shtrenjtë. Kjo tregon qartë përkeqësimin në shëndetësi vitin e fundit, ndërsa e bën edhe më të domosdoshme rimëkëmbjen në këtë sektor.

Partia Demokratike e Kosovës, ka dizajnuar programin konkret për shëndetësinë, i cili ka katër shtylla kryesore:

## **SHTYLLA E PARË: PANDEMIA NËN KONTROLL**

### **VAKSINIMIN PËR TË GJITHË**

Zbulimi i një vaksine efektive ka qenë ndër lajmet më të mira që kemi dëgjuar muajve të fundit. Fatkeqësisht, në Kosovë nuk ka ende asnjë vaksinë, nuk ka as datë të fillimit, dhe as plan se si do të bëhet vaksinimi dhe kur do të përfundojë pandemia.

Partia Demokratike e Kosovës, konsideron se vaksinimi është prioriteti më i lartë për shëndetin publik. Qeverisja e PDK-së do të vendosë kontaktet e menjëhershme me prodhuesit kryesorë në botë dhe me një transparencë të plotë do të nënshkruajë kontratat për t'i blerë vaksinat për të gjithë qytetarët e Kosovës.

Do të funksionalizohen 30 qendra të vaksinimit në tërë Republikën e Kosovës.

Qytetarët do të kenë qasje të lehtë, do të jenë publike të gjitha kriteret se kush do të vaksinohet së pari – siç janë personeli shëndetësor, personat në moshë të shtyrë dhe ata me sëmundje kronike. Vaksinimi do të kryhet shpejt – duke filluar nga ata që kanë nevojë më së shumti e jo nga ata që mbajnë privilegje. Qeverisja e PDK-së do të ndjekë trendin e përcaktuar nga Bashkimi Evropian, ku deri në fund të verës të vaksinohen 70% të popullatës sonë.

## QENDRA PËR TESTIME NË TËRË KOSOVËN

Meqenëse vaksinimi merr disa muaj, është e rëndësishme që sistemi i testimeve t'u përgjigjet nevojave të qytetarëve në kohë reale.

Plani i PDK-së parasheh që përveç se në Prishtinë, testimet të bëhen edhe në gjashtë qendra tjera rajonale, duke u dhënë kështu fund pritjeve të gjata.

Brenda tre muajsh, me qeverisjen e PDK-së, këto qendra do të funksionalizohen, duke e shumëfishuar numrin e testeve dhe duke e rritur sigurinë për qytetarët tanë.

## PAKO MBËSHTETËSE PËR TË INFEKTUARIT ME COVID

Për shumë familje në Kosovë që u përballën me virusin, pagesa për barnat dhe analizat ishte edhe një vështirësi shtesë.

Në mungesë të mjeteve financiare, qytetarët nuk kanë arritur ta marrin terapinë e duhur dhe t'i bëjnë analizat e ndryshme, duke ua vështirësuar kështu gjendjen.

Plani ynë parasheh që çdo i infektuar me Covid, i regjistruar në IKShPK, të marrë një ndihmë financiare deri në 250 euro - për t'i bërë ekzaminimet dhe për t'i marrë ilaçet e duhura.

Një pako e tillë mbështetëse, përpos aspektit shëndetësor, do të lehtësojë edhe gjendjen e tyre ekonomike.



## SHËNDETI MENDOR POST-COVID

Duke e ditur se ankthi dhe depresioni janë në pikat më të larta prej shumë dekadash, Partia Demokratike, do të krijojë program të veçantë për trajtimin e tyre, sidomos te punëtorët shëndetësorë – të cilët kanë qenë tash e afro një vit në vijën e parë në luftë me Covidin. Atyre u duhet mbështetje dhe PDK do t'ua japë atë.

## SHTYLLA E DYTË: MJEK PËR ÇDO FAMILJE

Pandemia ka treguar se sa e rëndësishme është që qytetari ta ketë një komunikim të drejtpërdrejtë në institucionet shëndetësore, kur ai ose familja e tij është përballur me probleme të shëndetit.

Sot, edhe pse qytetari e ka adresë të parë qendrën e mjekësisë familjare dhe ambulancat, prapë se prapë kjo nuk është përgjigje e mjaftueshme ndaj kërkesave të tij.

PDK do të investojë në kujdesin primar, duke fuqizuar qendrat e mjekësisë familjare, që ata të jenë me të vërtetë adresë ku qytetari merr përgjigjen në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe kujdesin e duhur. Një adresë pranë qytetarit, afër vendbanimit të tij.

Plani ynë parasheh si prioritet implementimin e shpejtë të konceptit të mjekësisë familjare. Pra, që çdo familje në Kosovë ta ketë mjekun familjar, i cili ka përgjegjësinë ta përcjellë gjendjen shëndetësore të asaj familjeje, t'i japë këshilla dhe t'i ofrojë shërbime shëndetësore.

Më konkretisht, përmes zonimit, për çdo 2 mijë banorë në Kosovë do të jetë një ekip mjekësor, i përbërë nga një mjek dhe dy infermierë, të cilët ofrojnë kujdes individual dhe familjar.

Investimi në mjekun familjar, forcimin e lidhjes së tij direkte me qytetarin, është një ndër investimet me kthimin më të madh – në aspektin e shëndetit publik, ose atë ekonomik. Sepse, parandalohen sëmundjet, nuk mbingarkohen spitalet dhe përmirësohet shëndeti i përgjithshëm i popullatës.

Prandaj, PDK do të investojë fuqishëm në të gjitha komunat e Kosovës që shërbimi parësor i mjekësisë familjare të jetë pranë qytetarit në çdo kohë.

## SHTYLLA E TRETË: SIGURIME SHËNDETSORE DHE BARNALAS

Partia Demokratike ka një plan konkret që në tre muajt e parë të qeverisjes të fillojë shërbimet e para të sigurimeve shëndetësore.

Për një kohë shumë të gjatë, qytetarët tanë kanë shpenzuar para nga xhepi i tyre për shërbime mjekësore dhe barna. Familjet janë të rënduara nga shpenzimet e larta çdo muaj.

Edhe Banka Botërore i ka dhënë një theks të veçantë faktit se një pjesë e madhe e këtyre shpenzimeve në Kosovë shkon për blerjen e barnave.

Prandaj, në planin tonë, një ndër shërbimet e para të Fondit të Sigurimeve Shëndetësore do të jetë ofrimi i barnave falas për personat me sëmundje kronike.

Do të jetë një listë prej 580 forma të barnave, të cilat do të jepen gjithmonë falas.

Kjo nënkupton që secili qytetar që vuan nga sëmundjet kronike, siç janë tensioni i lartë, diabeti, sëmundjet e zemrës, e të tjera që klasifikohen brenda kësaj pakoje, do të jetë përfitues nga Fondi i Sigurimeve Shëndetësore.

Ky proces do të jetë digjital. Receta do të përshkruhet në mënyrë elektronike dhe qytetari me letërnjoftim të Kosovës do të shkojë t' i marrë këto barna falas në cilëndo barnatore në Kosovë.

Kjo garanton ndaljen e abuzimeve me barna, transparencë dhe shërbime të shpejta.

## **SHTYLLA E KATËRT: SISTEM SHËNDETËSOR MODERN**

PDK ka plan investues për QKUK-në dhe për të gjitha Spitalet e Përgjithshme - si ai në Prizren, Mitrovicë, Gjilan, e të tjerë, me qëllim të modernizimit të infrastrukturës dhe krijimit të kushteve më të mira për pacientët, por edhe për personelin shëndetësor.

Ky plan do të jetë në vlerën prej 150 milionë euro, për katër vitet e ardhshme dhe do të krijojë efekte të dukshme dhe reale.

Plani i Rimëkëmbjes për Shëndetësinë, parasheh edhe blerjen e pajisjeve në vlerë prej 50 milionë eurosh, për QKUK-në dhe për Spitalet e Përgjithshme, për ta rritur kualitetin e shërbimeve mjekësore dhe për t' i shtuar kapacitetet diagnostike dhe ato klinike.

Plani i PDK-së adreson edhe një kërkesë të kamotshme të Prishtinës.

Kur PDK-ja ka drejtuar Ministrinë e Shëndetësisë, është lënë i gatshëm për zbatim projekti i fizibilitetit që parasheh ndërtimin e një spitali tejet modern për Prishtinën. Për fat të keq, as edhe një hap i vetëm nuk është ndërmarrë nga të dy qeveritë e fundit.

Plani i Rimëkëmbjes për Shëndetësinë, i jep prioritet të veçantë Spitalit të Prishtinës dhe në 6 muajt e parë të qeverisjes sonë do të fillojnë punimet në ndërtimin e këtij spitali.

Spitali i Prishtinës do të ketë 200 shtretër, 4 salla të operimit, 54 dhoma të intervenimit dhe mbi 200 pjesëtarë të personelit shëndetësor.

## **RRITJA E MOTIVIMIT TË PUNONJËSVE SHËNDETËSORË**

Prioritet i PDK-së është rritja e kujdesit për jetën dhe shërbimeve shëndetësore duke ngritur ndjeshëm rrogat e personelit mjekësor në mënyrë që të shtohet më shumë stimulimi i tyre material.

Prandaj, plani për Rimëkëmbje i kushton vëmendje të veçantë punonjësve shëndetësorë të cilët edhe pse qeveria nuk i kishin dhënë kushtet dhe trajtimin e duhur, kanë luftuar në mënyrë shembullore kundër koronavirusit në vijën e parë të frontit duke rrezikuar edhe jetën e vetë. Fatkeqësisht, shumë prej tyre edhe e humbën jetën në këtë luftë fisnike që ata bënë për të shpëtuar jetët e qytetarëve.

Prandaj, me programin tonë të Rimëkëmbjes, personelit shëndetësor do t' u rriten pagat.

Do të kemi një përshkallëzim, ku paga e mjekut specialist do të jetë deri në 1500 euro. Infermierët, ndërkaq, do të kenë një pagë jo më të ulët se 650 euro.



## RIMËKËMBJE E SUNDIMIT TË RENDIT DHE LIGJIT

Qeveritë e fundit e kanë dëshmuar qartë se sundimi i rendit dhe ligjit nuk ka qenë prioritet i tyre dhe ky sektor është neglizhuar shumë gjatë periudhës së fundit. Përkundër që në Kosovë janë bërë ndryshime ligjore që mundësojnë luftën kundër korrupsionit dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme, shumë pak është bërë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit e shumë më pak në konfiskimin e pasurisë së fituar me vepra korruptive.

Kosova, si vend i pas luftës, ka arritur të vendosë institucione, mekanizma dhe parime qeverisëse duke u bazuar në modele dhe me ndihmën e vendeve më të zhvilluara. Këto të arritura kanë mundësuar që vendi të ketë një demokraci funksionale, legjislacion të avancuar në të gjitha fushat, institucione dhe administratë funksionale në të gjitha sferat e jetës publike, duke përfshirë këtu edhe sundimin e rendit dhe ligjit.

Janë bërë arritje substanciale në luftën kundër krimit të organizuar, dhe terrorizmit, ku vlen të theksohet koordinimi institucional në trajtimin e rasteve të terrorizmit dhe kthimi i familjarëve (Fëmijëve dhe grave) të Luftëtarëve nga Kosova që marrin pjesë në luftëra terroriste jashtë vendit. Përkundër që janë bërë ndryshime ligjore që mundësojnë luftën kundër korrupsionit dhe konfiskimin e pasurisë së paligjshme, shumë pak është bërë në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit e shumë më pak në konfiskimin e pasurisë së fituar me vepra korruptive.

Duke qenë se Sundimi i rendit dhe ligjit është një ndër parimet kryesore të rendit kushtetues të Republikës së Kosovës, përkundër të arriturave, mbetet ende shumë punë për t'u bërë në mënyrë që parimet më të avancuara ndërkombëtare të sundimit të rendit dhe ligjit të zbatohen edhe në Kosovë. Prandaj, PDK, gjatë mandatit të saj qeverisëse, do t'i kushtoj rëndësi këtyre parimeve dhe fokus i saj i drejtpërdrejt do të jenë:

## DREJTËSIA

Sistemi i drejtësisë përfshinë Prokurorinë si organ që ushtron ndjekjen penale, Gjyqësorin i cili përfshinë të gjitha gjykatat si dhe organizimin e tyre nëpërmjet Këshillit Gjyqësor të Kosovës si një trup kushtetues për administrimin e përgjithshëm të gjykatave si dhe për rekrutimin, transferimin, avancimin, disiplinimin dhe shkarkimin e gjyqtarëve. Për më tepër, në Kosovë është zgjeruar arkitektura e sistemit të drejtësisë përmes sistemeve të tjera mbështetëse dhe vendimtare, pa të cilat funksionimi i sistemit gjyqësor është i pamundur, e ato janë: Shërbimi Korrektues (burgjet dhe qendrat e ndalimit), Sistemi Sprovues, Sistemi i Ndihmës Juridike, Sistemi i Noterisë, Ndërmjetësimi, Arbitrazhi, Sistemi i Përmbartimit Privat dhe ai i Administrimit të Falimentimit. Të gjitha këto kanë për qëllim që ta bëjnë punën e gjyqësorit shumë më të lehtë dhe më funksionale për zgjidhjen e kontesteve gjyqësore ose për gjetjen e zgjidhjeve në mënyrë më kreative dhe efikase brenda kornizës ligjore.

Përkundër të arriturave, gjendja aktuale e sistemit të Drejtësisë mbetet sfiduese, me theks të veçantë në reformat e nevojshme për ngritjen dhe fuqizimin e sektorit, luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, qasje më të lehtë në drejtësi për qytetarët, si dhe zbatim më efikas të sanksioneve penale. Për më tepër efektet e pandemisë Covid-19 kanë ndikuar në efikasitetin e institucioneve të drejtësisë duke suspenduar për një kohë të gjatë shumicën e seancave, dhe si pasojë një numër i rasteve janë kthyer në pikën zero. Nga ana tjetër, si pasojë e keq-qeverisjes gjatë vitit 2020, një numër i reformave të parapara nuk kanë përfunduar. Reforma si Rishikimi Funksional i Sektorit të Sundimit të Ligjit, përfundimi i hartimit të një serë ligjesh si Kodi i procedurës penale, Kodi Civil, Ligji për Agjencinë Anti Korrupsion, Ligji për Deklarimin dhe kontrollin e prejardhjes së pasurisë, dhe kjo ka ndikuar në procesin e Integritimeve Evropiane.





## PRIORITETET NË DREJTËSI

Kosova tashmë ka kaluar nëpër një numër reformash të rëndësishme të sistemit të drejtësisë të cilat kanë përfshirë aspekte të shumta duke filluar nga ndryshimi i legjisllacionit, emërimi, riemërimi dhe rritja e numrit të gjyqtarëve dhe prokurorëve, ristrukturimi i gjyqësorit dhe prokurorisë, vënia në funksion e shërbimeve mbështetëse të sistemit të drejtësisë si profesionet e lira dhe të tjera. Por, bazuar në sfidat e identifikuar, efektet negative të Pandemisë Covid-19, si dhe keq qeverisja e koalicioneve të dala nga zgjedhjet e tetorit të 2019, PDK prioritet kryesor të sektorit të drejtësisë gjatë qeverisjes së ardhshme ka:

1. Përfundimin dhe zbatimin e rishikimit funksional të sektorit të sundimit të ligjit (RFSSL), si një nga iniciativat kyçe të ndërmarra në funksion të përmirësimit të politikave të sektorit të sundimit të ligjit;
2. Zbatimin e Strategjisë së dalë nga procesi i RFSSL, nëpërmjet të cilit mundësohet reformim i strukturuar i politikave dhe kornizës ligjore;
3. Ngritjen e pavarësisë, profesionalizmit, transparencës dhe efikasitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë;
4. Përmirësimin e politikave, kornizës ligjore, zbatimin e agjendës evropiane dhe obligimeve të tjera ndërkombëtare;
5. Konsolidimin, forcimin, dhe mbikëqyrjen e profesioneve të lira ligjore;
6. Zbatim më i mirë i sanksioneve penale dhe masave alternative.

## RISHIKIMI FUNKSIONAL I SEKTORIT TË SUNDIMIT TË LIGJIT

Si një nga reformat më të mëdha të ndërmarra, është bazuar në nevojën që Kosova të ketë një strategji sektoriale të sundimit të ligjit dhe duke marrë në konsideratë raportet e vendit për Kosovën nga Komisioni Evropian ku thekson që Kosova ende nuk ka një strategji sektoriale. Qeveria e Kosovës, në vitin 2016, ka miratuar vendimin për iniciimin e këtij procesi, proces që ka filluar dhe marrë formën e vetë në shkurt të vitit 2018. Procesi i RFSSL ngërthen në vete diagnostikimin e sektorit, analiza për sektorin, konsultime me institucionet relevante dhe shoqërinë civile dhe në bashkërendim të plotë me partnerët strategjik, duhet të kulmoj me strategji sektoriale.

Përkundër aktiviteteve të shumta që janë ndërmarrë gjatë viteve 2018 dhe 2019, ky proces pothuajse ka ngecur në vitin 2020 dhe ende nuk është përfunduar strategjia siç ishte planifikuar. Për më tepër, si pasojë e stërzgjatjes së këtij procesi, shumë rekomandime të dala nga ky proces e kanë humbur relevancën e tyre dhe duhet t'i nënshtrohen një vlerësimi shtesë. Prandaj, PDK do të rivlerësoj strategjinë e dalë nga Rishikimi Funkcional dhe do ta miratojë këtë strategji në 6 mujorin e parë të qeverisjes.

**Zbatimi i Strategjisë së dalë nga procesi i RFSSL, nëpërmjet të cilit mundësohet reformim i strukturuar i politikave dhe kornizës ligjore** - Qeveria e Kosovës posedon numër të madh të strategjive dhe politikave tjera të hartuara nga institucionet e ndryshme, me prioritet të shumta, dhe pa prioritetizim të mirëfilltë. Prandaj, PDK do të kujdeset që prioritetet e përfshira në RFSSL, do të jenë prioritetet me kosto mirë të trajtuar, të koordinuara me hisedarët kyç të sektorit dhe me shoqërinë civile, gjë që mundëson zbatim më të mirë të prioritetëve.

Duke marrë parasysh që është strategjia e dalë nga RFSSL do të paraqes për herë të parë prioritetet e sektorit në mënyrë të analizuar dhe mirë të koordinuar, mundëson që këto prioritetet t'i paraqitën edhe partnerëve strategjik për bashkëfinancim, gjë të cilën PDK do ta adresojë gjatë vitit të parë të qeverisjes. Po ashtu, këto prioritetet do t'i prezantohen edhe donatorëve kyç për financimin e tyre.

**Ngritja e pavarësisë, profesionalizmit, transparencës dhe efikasitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë mbetet një nga sfidat qenësore në zbatimin e ligjit.** Studimet e shumta dëshmojnë një rënie të besimit të qytetarëve në drejtësi që lidhet drejtpërdrejt me perceptimin e mungesës së integritetit të gjyqtarëve dhe prokurorëve;

1. Rritja e vazhdueshme dhe zbatimi i pavarur i buxhetit të gjyqësorit dhe prokurorisë përkitazi me planifikimin e tyre, në mënyrë që të ndikojë në pavarësinë e funksionimit të gjyqësorit dhe prokurorisë;
2. Hartimin dhe miratimin e ligjit për statusin, mandatin dhe përgjegjësitë e gjyqtarëve dhe prokurorëve;
3. Rritja e efikasitetit të gjyqësorit dhe prokurorisë, nëpërmjet adresimit adekuat të Gjykatës Themelore në Prishtinë, si gjykata me më së shumti lëndë;
4. Funkcionalizimi i plotë i sistemit të SMIL, me synim përmirësimin e mbledhjes së të dhënave dhe monitorimit të lëndëve, dhe zbatimi i standardeve të Këshillit të Evropës për menaxhimin e lëndëve;
5. Themelimi i gjykatës komerciale e cila brenda vetes do t'i përmbajë dy shkallë të gjykimit, do të ketë kompetenca të qarta, numër të mjaftueshëm të gjyqtarëve të specializuar për fushën e së drejtës komerciale dhe do të ketë kompetenca për të gjitha rastet e fushës ekonomike, qysh nga fillimi e deri te përfundimi i procedurave të përbarimit.

## ZBATIMI I AGJENDËS EVROPIANE DHE OBLIGIMEVE TJERA NDËRKOMBËTARE

Arritjet e deritanishme në sundimin e ligjit kanë pasur gjithnjë fokus kryesor përafrimin e Kosovës me Bashkimin Evropian dhe standarde të tjera të rëndësishme të sektorit të drejtësisë. Kjo sjellë nevojën për plotësimin e standardeve si në politikëbërje, në zbatim të politikave dhe në funksionim të mbarë të të gjitha hallkave që mundësojnë zbatimin e drejtësisë:

1. Hartimi dhe miratimi i ligjeve bazike në praktikën më të mira ndërkombëtare, në funksion të kësaj do të riprocedohen draftligjet si: Kodi i Procedurës Penale, Kodi Civil, pakaja e ligjeve të antikorrupsionit (Ligji për Agjencinë Kundër Korrupsionit dhe për Deklarimin e Pasurisë) etj.;
2. Forcimi i mekanizmave institucionalë për adresimin e obligimeve që dalin nga kapitulli 23 i Acquis dhe zbatimi i obligimeve që dalin nga ERA II;
3. Fuqizimi i Gjykatës Themelore në Mitrovicën Veriore dhe mekanizmave tjerë të drejtësisë në veri, përkthazi me zbatimin e Marrëveshjes për Normalizimin e Marrëdhënieve me Serbinë;
4. Rritja e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar dhe lidhja e marrëveshjeve bilaterale për bashkëpunim të ndërsjellë juridik, ekstradim dhe transferim të të burgosurve, me theks të veçantë zbatimin e Marrëveshjes së Ekstradimit në mes të Republikës së Kosovës dhe Shteteve të Bashkuara të Amerikës dhe thellimi i bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në luftimin e terrorizmit;
5. Vazhdimi i anëtarësimit të Kosovës në World Justice Program dhe anëtarësimi në institucione dhe organizata ndërkombëtare tjera të drejtësisë si EUROJUST, etj.;

## FUQIZIMI I PROFESIONEVE TË LIRA

Me zhvillimin e noterisë, ndërmjetësimit, jurisprudence, administratorëve falimentues, përbaruesve privatë dhe arbitrazhit, konsiderohet se është plotësuar arkitektura e drejtësisë. Por, do të vazhdohet me plotësimin e kornizës ligjore, lehtësimin e punës së gjyqësorit përmes funksionimit të sistemit të noterisë, ndërmjetësimit, administratorëve falimentues dhe përbaruesve privatë.

Sistemi i noterisë është fuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri të noterisë më 2018, i cili parashih rritjen graduale të numrit të noterëve nga 1/20000



në 1/10000 banorë dhe mbulimin e gjithë territorit të Kosovës me noter. Nëpërmjet Ligjit për noter, Ligjit për trashëgiminë dhe Ligjit për procedurën jokontestimore, është siguruar mbrojtje më e fuqishme e të drejtave trashëgimore të grave dhe vajzave.

Ndërmjetësimi është fuqizuar me hyrjen në fuqi të Ligjit të ri për ndërmjetësim më 2018. Ligji i ri ofron stimuj që qytetarët t'i qasen ndërmjetësimit në vend të gjykatave për ta fuqizuar qasjen e qytetarëve në drejtësi dhe ngritjen e efikasitetit të gjykatave

Vendosja e tarifave për ndërmjetësim. Ligji i ri parashih tarifa më të përballueshme për qytetarë, prandaj me një analizë të gjendjes socio-ekonomike do të vendosen tarifa të përballueshme dhe efektive për sektorët.

Forcimi i sistemit të mbikëqyrjes së profesioneve të lira. Duke qenë se profesionet e lira si noteria dhe përmbauesit kanë ndikim të madh në ekonominë e vendit, duhet që veprimtaria e tyre të jetë e bazuar në ligj.

Prandaj prioritete të PDK-së për Drejtësinë janë:

1. Rritja e numrit të noterëve dhe mbulimi i tërë territorit të Kosovës me noterë;
2. Rritja e numrit të përmbauesve dhe mbulimi i tërë territorit të Kosovës me përmbaues;
3. Rritja e efikasitetit të ndërmjetësimit dhe përfshirja e ndërmjetësimit të detyrueshëm për lëndë kontestimore;
4. Pastrimi i listave të ndërmjetësuesve dhe rritja e tarifave për ndërmjetësues;
5. Zhvillimi i një mekanizmi elektronik të mbikëqyrjes së profesioneve të lira ligjore.

## ZBATIM MË I MIRË I SANKSIONEVE PENALE DHE MASAVE ALTERNATIVE

Shërbimi Korrektues i Kosovës dhe Shërbimi Sprovues i Kosovës janë mekanizmat kryesorë të cilët merren me ekzekutimin e sanksioneve penale të burgimit dhe masave alternative. Këta janë mekanizma të cilët funksionojnë si organe të mëvetësishme në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. Baza ligjore e funksionimit të këtyre shërbimeve rrjedhë nga Ligji për ekzekutimin e sanksioneve penale, Kodi i Drejtësisë për të Mitur, Kodi i Procedurës Penale të Kosovës si dhe nga shumë instrumente tjera ndërkombëtare të cilat diktojnë standardet për ekzekutimin e sanksioneve penale. Prioritetet kryesore të PDK-së për sa i përket ekzekutimit të sanksioneve penale dhe masave alternative janë:

1. Ngritja e kapaciteteve të institucioneve korrektuese si rritja e kapaciteteve të Burgut të Sigurisë së Lartë prej 390 shtretërish për të burgosurit me rrezikshmëri të lartë, ndërtimi dhe funksionalizimi i Qendrës së Paraburgimit në Gjilan, me kapacitet prej 300 shtretërish për të burgosur, si dhe ndërtimi dhe funksionalizimi i Qendrës së Paraburgimit në Prishtinë, me kapacitet prej 300 shtretërish, për të burgosur sipas standardeve ndërkombëtare;
2. Avancimi i sistemit të sigurisë në institucionet e shërbimit korrektues dhe sprovues nëpërmjet ngritjes së kapaciteteve të njësisë së inteligjencës dhe duke investuar në pajisje për furnizim me armë, instalim të kamerave vëzhguese, pengues të valëve, detektorë të lëvizjes, skaner X-Ray, blerje të automjeteve për transportin e të burgosurve dhe pajisje të tjera të sigurisë (sistem të kamerave për vëzhgim, aplikim të sistemit të mbikëqyrjes elektronike për të dënuarit) etj.;
3. Ndërtimi i punëtorive për njësinë ekonomike me qëllim të punësimit të të burgosurve, duke përfshirë prodhimin në zdrukthëtarë, përpunim metali, rrobaqepësi, printim/shtypje, agrikulturë, pemëtarë, blegtori, etj.;
4. Krijimi i kapaciteteve të mjaftueshme për akomodimin, trajtimin, edukimin dhe risocializimin e të miturve me masë edukuese korrektuese dhe atyre të dënuar me burg për të mitur.

## **MBROJTJA LIGJORE E INTERESAVE TË AUTORITETEVE PUBLIKE DHE ARBITRAZHIT**

Institucioni përgjegjës për mbrojtjen ligjore të interesave të institucioneve publike dhe përfaqësimin e saj në Gjykata, është Avokatura Shtetërore (AVSH) në kuadër të Ministrisë së Drejtësisë. AVSH ka për detyrë, që me rastin e mbrojtjes së interesave të autoriteteve publike dhe organizatave buxhetore (në procedura gjyqësore, administrative dhe të arbitrazhit), t'i ndërmarrë të gjitha veprimet e lejuara juridike, gjatë përfaqësimit, këshillimit, respektivisht dhënies së mendimeve juridike, në mënyrë që mbrojtja e autoriteteve publike/buxhetore, të nivelit qendror në Republikën e Kosovës, të jetë sa më gjithëpërfshirës, profesional dhe efikas.

Institucionet publike dhe shteti i Kosovës, gjatë viteve të fundit, është ballafaquar me një numër të madh të rasteve (rreth 20 mijë), raste që implikojnë vlerë prej qindra milionë euro. Për më tepër, Avokatura Shtetërore përfaqëson interesat e shtetit në rastet e Arbitrazhit ndërkombëtar, ku vendi ynë ballafaqohet me kërkesa me vlerë qindra milionë euro nga kompani të ndryshme ndërkombëtare që kanë investuar në Kosovë.

Përkundër faktit që në 3 vitet e fundit janë bërë përparime të dukshme, adresimi i mandatit të AVSH mbetet sfidë pasi që AVSH nuk posedon kapacitetet e nevojshme për mbulimin e të gjitha obligimeve që janë të parapara me ligjin për AVSH. Për më tepër, institucionet qeveritare nuk kanë një koordinim për adresimin e obligimeve ligjore të tyre, qoftë ajo në instancat e drejtësisë vendore apo edhe të Arbitrazhit.

Prandaj, në mënyrë që të evitohen humbje të qindra milionë euro, PDK ka prioritet që:

Të angazhohet në menaxhimin dhe monitorimin e të gjitha veprimtarive, me qëllim të realizimit të mandatit dhe misionit të Avokaturës Shtetërore, si dhe sigurimi i bashkëpunimit dhe koordinimit në mes të strukturave të Avokaturës Shtetërore me Ministrinë e Drejtësisë dhe institucioneve tjera.

**5.** Ngritja e kapaciteteve, duke përfshirë rritjen e numrit të avokatëve, bashkëpunëtorëve profesional dhe stafit tjetër mbështetës për avokat;

**6.** Themelimin e një departamenti të veçantë për arbitrazh ndërkombëtar, duke rekrutuar staf profesional dhe staf tjetër mbështetës.

**7.** Aftësim i rregullt profesional për avokatë të shtetit.

**8.** Koordinim më të mirë në mes të institucioneve shtetërore dhe AVSH në lidhjen e kontratave që tejkalojnë shumën mbi 1.000.000,00 Euro;

**9.** AVSH do të adresojë të gjitha lëndët që kanë indice të korrupsionit në Prokurorinë e Shtetit

- **10.** AVSH do të përfshihet në dhënien e këshillave dhe rekomandimeve për rastet specifike, varësisht siç e përcakton Qeveria e Kosovës me akt të veçantë.



## LUFTA KUNDËR KORRUPSIONIT

Korrupsioni konsiderohet si problemi i dytë më domethënës pas papunësisë në Kosovë, sipas Anketës së opinionit publik. Nga raportet e Komisionit Evropian dhe Departamentit të Shtetit, korrupsioni në Kosovë vlerësohet të jetë endemik dhe sistematik dhe Kosova rangohet e parafundit në rajon apo vendi i 93, më pak i korruptuar në Indeksin e Perceptimit të Korrupsionit të Transparency International. Korrupsioni sistematik ka ndikuar në masë të madhe në rrjedhën e zhvillimeve politike dhe ekonomike në vend.

Përkundër faktit që ekziston bazë e mirë ligjore me standarde ndërkombëtare dhe institucione relevante për luftimin e korrupsionit, pak është bërë në trajtimin ligjor të korrupsionit me theks të veçantë nga Policia, Prokuroria, dhe Gjykatat. Për më tepër, nuk ka qartësi institucionale në parandalimin dhe luftimin e korrupsionit, duke ditur se një numër i madh i institucioneve janë me mbivendosje apo paqartësi të kompetencave. Si rrjedhojë, shumë raste ngritën për gjykim, pak nga to përfundojnë me vendime të prera dënuese për të akuzuarit. Dy palët kryesore të përfshira në këtë proces, gjykatat dhe prokuroria, e drejtojnë gishtin te njëra-tjetra si përgjegjëse për këtë dështim. Po ashtu, shumë nga përgjegjësit për parandalimin, luftimin dhe dënimin e të korruptuarve, kanë mungesa të theksuara të aftësive të tyre dhe ekzistojnë perceptime që edhe vet mekanizmat relevant janë të korruptuar.



Përkrahja politike për luftën kundër korrupsionit, me theks në vitin 2020, ka qenë më shumë verbale sesa që janë marrë masa adekuate. Qeveritë e dala nga zgjedhjet e tetorit të 2019, kanë dështuar të miratojnë ligje, hartojnë strategji, ose politika tjera që do t'u mundësonte institucioneve përgjegjëse të ndër marrin veprime në luftën kundër korrupsionit. Përkundrazi, ka pasur anëtarë të Qeverisë të përfshira në afëra korruptive, kanë ndërmarrë veprime korruptive gjatë mandatit qeverisës, dhe kanë shfuqizuar mekanizma përgjegjës për luftën kundër korrupsionit.

Prandaj, për të luftuar këtë të keqe endemike të shoqërisë sonë, PDK zotohet që Qeveria do të bazohet në parimet e Qeverisjes së mirë, ku të gjithë anëtarët e Qeverisë do të jenë respektues të ligjit të cilët nuk do të kenë asnjë aktakuzë dhe do të iniciojnë politika që do të mundësojnë luftimin pa kompromis të korrupsionit. Prioritetet e PDK-së në luftën kundër korrupsionit, do të jenë:

- 1. Veting institucional të Gjyqtarëve dhe Prokurorëve** - nëpërmjet themelimit të një njësie specifike me lidhje ligjore me të gjithë mekanizmat relevant të sigurisë dhe financiar (Policia e Kosovës, Agjencia e Kosovës për Inteligjencë, Njësia e Inteligjencës Financiare, etj.) për veting institucional, do të zgjerohet spektri i dokumentacionit të nevojshëm për aplikim, ngritje në detyrë, dhe rialokim të gjyqtarëve dhe prokurorëve. Po ashtu, përveç deklarimit të pasurisë në baza vjetore, një herë në tri vite, çdo ngritje në detyrë dhe rialokim do të bëhet verifikim i detajuar i gjyqtarëve dhe prokurorëve;
- 2. Mënjanimi i korrupsionit dhe nepotizmit në administratën** publike nëpërmjet reformës së administratës publike dhe në zbatim të ligjit për konflikt të interesit;
- 3. Rritja e numrit të deklaruesve të pasurisë** përkitazi me funksionet dhe mundësinë për përfshirje në vepra korruptive. Korniza aktuale ligjore për deklarim të pasurisë nuk përfshin një numër të zyrtarëve të cilët kanë potencial të kryer aktivitete korruptive (p.sh. mjekët, profesorët, zyrtarët në zyra të prokurimit etj.);
- 4. Themelimi i Fondit të Konfiskimit të pasurisë së fituar me vepra korruptive.** Kjo pasuri do të dedikohet për kompensimin e viktimave të dhunës, dhe financime tjera sipas nevojës;
- 5. Qartësimi i kompetencave të institucioneve përgjegjëse dhe me rol në luftën kundër korrupsionit.** Ekzistojnë afro 20 institucione të cilat kanë rol në luftën kundër korrupsionit, por janë shpesh të dobëta, jo profesionale dhe të pa integruara mirë, me ndeshje dhe mbivendosje të ndryshme apo duplikim të kompetencave midis institucioneve, siç vërehet tek Agjencia Kundër-Korrupsionit, Task forcat e ndryshme brenda Prokurorisë e Policisë, një numër Koordinatorësh Anti-Korrupsion, strukturat brenda gjyqësorit e deri te organet brenda Administratës Tatimore e Doganave. Një strukturë e këtillë tejet e ndërlikuar dhe e paqartë, mundëson edhe kulturën e fajësimit dhe mos përgjegjësisë në mungesën e rezultateve të prekshme në luftën kundër korrupsionit;
- 6. Barta e disa kompetencave tek Agjencia Kundër Korrupsionit (AKK),** më konkretisht, kompetenca të saj për të parandaluar korrupsionin, siç janë: Vlerësimi anti-korrupsion i legjisllacionit (p.sh. ekspertiza e projektligjeve kundër korrupsionit), vlerësimi i rrezikut të korrupsionit, Planet e Integritetit dhe Kontrollimi i Integritetit institucional;
- 7. Qartësimi i ciklit institucional në luftimin e korrupsionit** - Korniza ligjore nuk ofron kufij të qartë midis kompetencave të AKK-së në hetimin e korrupsionit në njërin anë, dhe prokurorisë e policisë në anën tjetër. Duke qenë se as mënyra e bashkëpunimit nuk është krejtësisht e qartë, mund të ndodhë që të gjitha institucionet të iniciojnë rastin e njëjtë pa dijeninë e njëra-tjetrës;
- 8. Adresimi i ligjor i kompetencave të Drejtorisë për Hetimin e Krimeve Ekonomike dhe Korrupsionit,** në kuadër të Policisë e cila funksionon vetëm në bazë të Procedurave Standarde të Veprimit, pa bazë ligjore tjetër, dhe rrjedhimisht mandati i saj, bashkëpunimi me organet tjera dhe bashkërendimi me to, duke përfshirë këtu AKK-në, është krejtësisht i paqartë. Adresimi i mungesës së burimeve njerëzore drejt funksionalizimit të Divizioni të veçantë për Luftimin e Korrupsionit dhe Krimin e Organizuar brenda Departamentit të Hetimeve, në kuadër të Inspektoratit Policor të Kosovës;

**9. Deklarim dhe kontroll i detajuar i pasurisë për zyrtarët e lartë** (Presidenti, Kryeministri, Zëvendës Kryeministri/at dhe Ministrat, Kryetari i Kuvendit, etj.). Sistemi aktual i kontrollimit të deklarimeve të pasurisë, pamundëson që zyrtarëve të lartë t'i kontrollohet deklarimi i pasurisë në baza të rregullta;

**10. Rritja e efikasitetit të mekanizmave përgjegjës për luftën kundër korrupsionit** - Ndonëse janë bërë disa arritje në luftimin e ryshfetit apo korrupsionit në masë më të vogël, korrupsioni po bëhet më i sofistikuar dhe i fshehur si dhe po lëviz në sferat ku qëndrojnë paratë dhe fuqia më e madhe. Rrjedhimisht, skemat e korrupsionit po bëhen më të rafinuara dhe më inteligjente. Prandaj ekziston nevojë urgjente për trajnime të specializuara për prokurorët, përfshirë këtu edhe ata të Prokurorisë Speciale, për teknikat hetuese kundër korrupsionit, për të siguruar që të rritet cilësia e dëshmvive të cilat paraqiten pranë gjykatave.

## LUFTA KUNDËR INFORMALITETIT

Një ndër prioritetet kryesore të PDK-së në mandatin e ardhshëm qeveritar, do të jetë luftimi i ekonomisë joformale dhe evazionit fiskal. Informaliteti i lartë është terren shumë i përshtatshëm për korrupsionin, prandaj duke kufizuar hapësirën informale në vend, shtohet edhe zbatimi i ligjit dhe minimizohet hapësira për abuzime. Informaliteti është shumë dekurajues për bizneset sepse u shkakton bizneseve të ndershme një konkurrencë jo të drejtë, pothuaj, të papërbalueshme.

Po ashtu, dëmton rëndë buxhetin e shtetit. PDK-ja synon që mjetet e grumbulluara përmes luftës kundër informalitetit, të shfrytëzohen për investime publike, për përmirësimin e sistemit edukativ në vend, për përmirësimin e shërbimeve shëndetësore, si dhe për hapjen e mundësive të reja për rininë e Kosovës që të heqë dorë nga emigrimi.

Puna në kushte të informalitetit, kufizon marrjen e shumë përfitimeve si për shembull, marrjen e kredive. Kompanitë që punojnë në informalitet, dëmtojnë më së shumti të varfrit, sepse vështirëson mobilitetin e shtresave të varfra të shoqërisë dhe forcimin e kapaciteteve të tyre njerëzore.

Në luftën kundër informalitetit, Qeveria e drejtuar nga PDK-ja, do të bashkëpunojë ngushtë me shoqatat e komunitetit të biznesit, me shoqërinë civile dhe me mekanizmat tjerë të rëndësishëm në vendin tonë. Për ta luftuar informalitetin, PDK-ja, do t'i përdorë jo vetëm masat represive, por edhe parandaluese dhe motivuese. Ulja e barrës fiskale dhe ofrimi i lirimeve doganore për lëndën e parë, makineritë, linjat prodhuese dhe të tjera, do të shërbejnë si stimuj për sektorin privat që të largohet nga informaliteti.

Gjykata Komeriale, e propozuar nga PDK-ja, do të shërbejë, gjithashtu, duke ofruar drejtësi dhe shpejtësi për zgjidhjen e kontesteve, veçanërisht në fushën ekonomike dhe komerciale, në mënyrë që sektori privat të fokusohet në zhvillimin e ideve të tyre biznesore.

Një ndër hapësirat kryesore ku lulëzon korrupsioni në Kosovë, është çështja e patundshmërisë që lidhet me lejet e ndërtimit dhe ndërtimet pa leje. Në kushtet kur ka zbrazëti apo mbivendosje ligjore, zyrtarët kanë më shumë fuqi për të vendosur në mënyrë diskreionale e arbitrare, gjë që u jep mundësi të bëjnë shantazhe për të marrë ryshfete. Po ashtu, në Kosovë ka mbi 300 mijë ndërtime informale dhe shumë qytetarë janë të kërcënuar nga zyrtarët për shkatërrimin e pronës së tyre që ende nuk e ka marrë tapinë.

Për ta arritur formalizimin e ekonomisë, PDK-ja do t'i bëjë hapat e mëposhtëm:

- Do të angazhohet për përmirësimin e legjislacionit dhe akteve të tjera normative dhe për garantimin e zbatimit të tyre për ta arritur reduktimin e shkallës së lartë të informalitetit në ekonominë e vendit tonë;

- Do të bëjë një riorganizim të Administratës Doganore dhe Tatimore, me ç'rast gjatë qeverisjes, Administrata Doganore do të jetë e orientuar për garantimin e sundimit të ligjit duke e luftuar më shumë kontrabandën dhe evazionin fiskal, ndërsa auditimi i tatimpaguesve do të jetë i shtrirë tek Administrata Tatimore, e cila, po ashtu, do të jetë e orientuar që vetëm në rast se ka indikacione të rrezikut shumë të lartë të shmangies nga detyrimet tatimore, ta bëjë inspektimin e hapësirave të tatimpaguesit. Në të gjitha rastet tjera, përmes auditimit të dokumenteve nga zyra, ta konstatojë deklarimin e rregullt të tatimpaguesit;
- Do të themelohen njësi të përbashkëta operative midis Doganës, Administratës Tatimore dhe Policisë së Kosovës, me qëllim të luftimit të evazionit fiskal;
- Do të krijohet një Agjenci e Veçantë për TVSh-në, e cila do të jetë përgjegjëse për kontrollin dhe mbikëqyrjen e TVSh-së nga momenti i deklarimit qoftë në kufi apo në brendësi të vendit, deri te shitësi i fundit;
- Do t'i ashpërsojë dënimet e veprave penale që lidhen me kontrabandën, evazionin fiskal, shmangien nga detyrimet tatimore dhe mos deklarimin e të dhënave për qëllime të kalkulimit të tatimeve;
- Do ta zhvillojë programin e deklarimit elektronik dhe mesazheve të komunikimit automatik përmes telefonave mobilë të mençur në relacionin tatimpagues-administratë, në mënyrë që ta eliminojmë kontaktin fizik dhe burokracinë në administratën e shtetit, duke e thjeshtëzuar mënyrën e deklarimit dhe duke e informuar tatimpaguesin në kohë reale për obligimet dhe të drejtat e tij;
- Do të inkorporohen të gjitha kriteret e Bashkimit Evropian për një konkurrencë të barabartë për të gjitha bizneset në tregun tonë;
- Do të rishikohen dhe do të eliminohen të gjitha burokracitë apo dispozitat kufizuese për të bërë biznes në tregun tonë.
-

## LEGALIZIMI I NDËRTIMEVE PA LEJE DHE LEJET ELEKTRONIKE

Ka mbi 352 mijë ndërtesa dhe banesa pa leje në Kosovë që bllokojnë rreth 10 miliardë euro kapital. Kosova ka pasur nisma të ndryshme ligjore, por vetëm rreth 8.600 janë përfshirë në proces. Me këtë ritëm, duhen 75 vjet për t'u mbyllur kjo çështje. Një prej nismave ndërkombëtare në këtë fushë është Deklarata e Vjenës për Vendbanimet Joformale në Evropën Juglindore, të cilën e ka firmosur edhe Kosova në vitin 2005.

Prandaj, PDK-ja propozon amendamentimin e ligjit ekzistues për ta bërë legalizimin e përsheptuar brenda dy vjetësh, për vetëm me një euro për metër katror, të të gjitha ndërtimeve pa leje që nuk prekin pronat publike apo interesin publik. Për kategori të veçanta sociale, do të ketë pushim, pra asnjë pagesë (familjet në asistencë sociale, veteranë, dëshmorë, invalidë lufte, etj.). Në bazë të këtij ligji, ata që nuk aplikojnë brenda dy vjetësh për ta formalizuar ndërtesën apo banesën e tyre, do të kenë përgjegjësi penale.

Në këtë mënyrë, kësaj çështjeje i jepet fund njëherë e mirë, duke e formalizuar sektorin e ndërtimit. Për ta përsheptuar këtë proces, PDK-ja do të ndërtojë një agjenci të specializuar të përkohshme (Agjencia e Trajtimit të Ndërtesave Pa Leje ATNPL) deri në përmbylljen e procesit të formalizimit, që do të shërbejë si "one stop shop/të gjitha shërbimet nën një çati" për ta përmbyllur procesin sa më shpejt, në mënyrë që të koordinohen të gjitha institucionet e përfshira, mirëpo qytetarët t'i marrin të gjitha, ekskluzivisht në një sportel. ATNPL do të funksionojë nën Zyrën e Kryeministrit dhe në koordinim me institucionet e ndryshme shtetërore, do të bashkëpunojë me komunat duke i ndihmuar për ta përsheptuar procesin e legalizimit brenda afatit dyvjeçar. ATNPL do të shërbejë edhe si institucion i ankesës, për ta administruar procesin e legalizimit nëse komuna nuk vihet në veprim, deri në dy javë pas dorëzimit të dokumenteve nga qytetari i interesuar.

Do të parandalohet informaliteti në sektorin e ndërtimeve duke mundësuar sistemin e lejeve elektronike të ndërtimit. Nëpërmjet planifikimit urban të hollësishëm që sqaron kushtet e ndërtimit deri në nivel parcele, automatizohet procesi i dhënies së lejeve duke eliminuar kontaktin mes qytetarëve dhe zyrtarit.



## POLICIA

Më 6 shtator bëhen 20 vjet që prej themelimit të Policisë së Kosovës. Edhe pse është policia më e re në rajon dhe Evropë, Policia e Kosovës, falë përkushtimit të zyrtarëve policorë, sot është një forcë profesionale, me integritet dhe besueshmëri të lartë të të gjithë qytetarët e Kosovës. Megjithatë, Policia e Kosovës ballafaqohet me sfida të shumta të cilat ndikojnë në efikasitetin, pastërtinë, mirëqenien e policëve, etj. prandaj i duhet mbështetje më e madhe politike dhe financiare për të bërë polici moderne dhe të krahasueshme me policitë e shteteve të zhvilluara perëndimore.

Partia Demokratike e Kosovës, gjatë mandatit të ardhshëm, do të fokusohet në prioritetet e mëposhtme për Policinë:

- Largimi i individëve nga policia me të kaluar apo veprime kriminale, apo të lidhur me struktura të krimit të organizuar dhe korrupsionin;
- Miratimi i Ligjit për pensionimin e parakohshëm të zyrtarëve policorë, në bazë të kërkesave dhe të drejtave të zyrtarëve policorë të cilat i kërkojnë tash e disa vjet, e të cilat padrejtësisht u janë mohuar;
- Sigurim shëndetësor dhe të jetës, si kushte themelore dhe tejet të rëndësishme;
- Rregullimi i objekteve të policisë, përmes të cilëve do të përmirësohen kushtet e punës së zyrtarëve policorë, por edhe shërbimet ndaj qytetarëve;
- Transferimi i zyrtarëve policorë nga detyra e ruajtjes së objekteve në luftimin e krimit të organizuar dhe korrupsionit dhe forcimi i sigurisë publike;
- Avancimi i pajisjeve dhe rritja e numrit të veturave për patrullim dhe reagim, sidomos pajisjeve kibernetike, por edhe për të kryer detyra policore;
- Digjitalizimi i sigurisë rrugore. Do të vendosen kamera dhe radarë të shpejtësisë në qytete, autostrada, rrugë magjistrale e rrugë të tjera që paraqesin rrezik për aksidente. Tejkalimi i shpejtësisë dhe thyerja e rregullave të trafikut nuk do të jetë më e negociueshme për falje apo ulje të dënimit. Korrupsioni dhe mundësia për t'u ikur dënimeve do të jetë zero



Përmes këtyre prioriteteve do të arrihet:

1. Polici pa krim dhe korrupsion nëpërmjet vetingut që do të sigurojë integritet dhe besueshmëri më të lartë;
2. Rritje e numrit të policëve në luftën kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit;
3. Polici më e re në moshë, aktive, efikase dhe më afër qytetarit;
4. Kushte më të mira të punës për zyrtarët policorë;
5. Siguri më e lartë rrugore dhe ulje e aksidenteve, vdekjeve dhe lëndimeve;
6. Kohë më e shpejtë për reagim pas thirrjeve të qytetarëve.

## ZJARRFIKËSIT

Zjarrfikësit janë ndër ofruesit kryesorë të shërbimeve emergjente dhe të cilët e rrezikojnë jetën e tyre në shpëtim të jetës së qytetarit, pronës dhe ambientit. Zjarrfikësit në Kosovë vazhdimisht janë ballafaquar me mungesë të rregullimit të statusit të tyre, mungesë të kompensimit për punën jashtë orarit, mbulim të shpenzimeve mjekësore, pajisje të vjetërsuara dhe kushte të vështira të punës. Zjarrfikësit meritojnë trajtim të dinjitetshëm dhe vëmendje nga Qeveria.

Gjatë mandatit të ardhshëm, do të rregullohet përfundimisht statusi i tyre duke u bartur në nivelin qendror, do të kenë sigurim shëndetësor dhe jetësor, do të kompensohen për punën jashtë orarit dhe do t'u përmirësohen kushtet e punës dhe pajisjet.

Do të procedohet ligji për pensiononim të parakohshëm në moshën 55-vjeçare, me pension të dinjitetshëm për punën e dinjitetshme që kanë bërë në shërbim të qytetarëve, ndërsa do të hapet rruga për gjeneratat e reja të zjarrfikësve.

Përmes luftës kundër krimit të organizuar dhe korrupsionit, do të kursehet dhe rritet buxheti për sektorin e emergjencave civile. Investimet dhe reformat që do të realizohen, do ta bëjnë profesionin e zjarrfikësve atraktiv për gjeneratat e reja. Ky sektor, përfundimisht do të marrë përkrahjen e duhur politike që i ka munguar.

## SIGURIA NË TRAFIK

Rritja e numrit të aksidenteve në trafik dhe humbja e jetës dhe lëndimet, janë shqetësime serioze. Krahas rritjes së dënimeve, patrullave policore dhe kampanjave vetëdijesuese, duhet të ndërmerren veprime shtesë për ta ofruar sigurinë e duhur në trafik. Korrupsionit dhe krimit të organizuar në sistemin e provimit për patentë shofer do t'i japim fund. Do të rritet transparenca, llogaridhënia dhe mbikëqyrja gjatë provimeve. Kriteret e kalueshmërisë së provimeve do të jenë me standarde evropiane. Do të vendosen kamera dhe radarë të shpejtësisë në qytete, autostrada, rrugë magjistrale e rrugë të tjera që paraqesin rrezik për aksidente. Tejkalmi i shpejtësisë dhe thyerja e rregullave të trafikut nuk do të jetë më e negociueshme për falje apo ulje të dënimit. Korrupsioni dhe mundësia për t'u ikur dënimeve do të jetë zero.





## RIMËKËMBJE E IMAZHIT NË ARENËN NDËRKOMBËTARE

Kosova në vazhdimësi ka gëzuar një imazh pozitiv në arenën ndërkombëtare, si një vend dhe shoqëri e dalë nga një luftë ku shumë pjesëtarë të popullsisë së saj janë ballafaquar me krime makabre. Si e tillë, është vlerësuar nga pothuajse të gjitha vendet që duhet ndihmuar dhe përkrahur Kosovën. Kjo ndihmë dhe përkrahje ka vazhduar me shpalljen e pavarësisë dhe me njohjet e shumta të arritura menjëherë pas shpalljes së pavarësisë dhe në vitet në vazhdim. Prandaj, si rrjedhojë e përkrahjes së vazhdueshme dhe gëzimit të imazhit pozitiv, diplomacia e Kosovës kishte pranuar afër 120 njohje nga vende të ndryshme të botës. Konsistenca e qëndrimeve të Kosovës, koordinimi në qëndrime me partnerët strategjik si ShBA, BE, etj. zhvillimi institucional dhe politik i brendshëm, leadership konsistent dhe të përgatitur në diplomaci, ishin disa nga parimet kyçe që mundësuan që Kosova të gëzojë imazh pozitiv në arenën ndërkombëtare.

Në vitet e fundit, ky imazh ka pësuar rënie të vazhdueshme, si pasojë e politikave të ndjekura nga lidhshipi si në sferën vendore ashtu edhe në marrëdhënie bilaterale dhe multilaterale. Nga perspektiva e vendeve tjera, Kosova është parë si vend me institucione fragjile si në drejtësi, siguri, diplomaci, etj., duke u raportuar në raportet e BE dhe ShBA, si vend me korrupsion të lartë, ku institucionet e sigurisë ndërrojnë udhëheqësit shumë shpesh dhe pa procedura, ku shumica e diplomatëve janë të emëruar politik, ku Ministri i Punëve të Jashtme është i akuzuar për vepër penale, etj. Për më tepër pozicioni ynë është dëmtuar akoma më shumë nga mos konsistenca e qëndrimeve dhe mos koordinimi me partnerët më të rëndësishëm strategjik për çështjet kyçe, siç janë demarkacioni me Malin e Zi, dialogu me Serbinë, etj.

Prandaj, PDK-ja e ka prioritet të orientimit të politikës së jashtme të Kosovës, kthimin e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, si një vend që promovon dhe eksporton vlera të qeverisjes së mirë, sundimit të ligjit, partneritetin e bazuar në respekt dhe vlera me aleatët tanë si dhe mbajtjen e qëndrimeve parimore dhe konsistente në arenën ndërkombëtare, duke mbështetur vlera si vetëvendosja, demokracia, liritë dhe të drejtat e njeriut si dhe tregtinë e lirë. PDK është partia e vetme në Kosovë që posedon bagazhin e nevojshëm politik dhe intelektual të përmirësues të imazhin e Kosovës në arenën ndërkombëtare.





Partia Demokratike të Kosovës, gjatë mandatit të ardhshëm qeverisës, do të fokusohet në fuqizimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës, duke konsoliduar njohjen ndërkombëtare të pavarësisë dhe sovranitetit të Kosovës. Procesi i njohjes së Kosovës, ka treguar se shteti i Kosovës është realitet i pakthyeshëm dhe faktor i domosdoshëm i paqes dhe i stabilitetit në rajon.

Politika jonë e jashtme, do të udhëhiqet nga parimet e parashikueshmërisë, qëndrueshmërisë dhe vazhdimësisë. Ajo e ka në qendër të misionit mbrojtjen dhe promovimin e interesave shtetërore, konsolidimin e pozicionit ndërkombëtar të Kosovës, parandalimin e konflikteve dhe kontributin për stabilitetin demokratik në rajon e më gjerë.

Synimi kryesor i Qeverisë së ardhme, do të jetë anëtarësimi i Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara (OKB), Paktin e NATO-s, dhe Këshillin e Evropës, si dhe marrja e statusit të vendit kandidat i Bashkimit Evropian (BE).

Heqja e pengesave politike për anëtarësim në OKB do të bëhet përmes marrëveshjes, qëllimi kryesor i së cilës është sigurimi i njohjeve dhe pranimit të sovranitetit të Kosovës si shtet i pavarur, me zotime ligjërish të detyrueshme nga Serbia, e cila do të detyrohet të heqë dorë nga kundërshtimi, ose ndikimi mbi palët e treta që ta kundërshtojnë anëtarësimin e Kosovës në Organizatën e Kombeve të Bashkuara, Bashkimin Evropian, Këshillin e Evropës, OSBE-në dhe agjencitë ndërkombëtare.

Pas transformimit të suksesshëm, në mandatin e kaluar të Forcës së Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës, do të arrihet edhe përafrimi kontraktual me NATO-n, ku Kosova do të jetë pjesë e kornizës së mbrojtjes kolektive për parandalimin e kërcënimeve të mundshme, sfidave dhe rreziqeve për stabilitetin e vendit dhe të rajonit. Kosova do të vazhdojë të angazhohet për të arritur qasje në Programin e Partneritetit për Paqe (PfP) përmes implementimit të partneritetit të zgjeruar ndërmjet Kosovës dhe NATO-s. Kosova do ta rrisë angazhimin në mekanizma dhe struktura rajonale të sigurisë, për të qenë partnere e përgjegjshme e NATO-s në rajon.

Në veçanti, do t'i kushtohet rëndësi edhe anëtarësimit të Kosovës në tri prej agjencive të specializuara më të rëndësishme të OKB-së: Organizata Botërore e Shëndetësisë (WHO), Organizata Ndërkombëtare e Aviacionit Civil (ICAO) dhe UNESCO. Synim do të jetë anëtarësimi i shpejtë në INTERPOL dhe avancimi i bashkëpunimit me EUROPOL-in, në shërbim të forcimit të sigurisë së brendshme dhe asaj rajonale.

### **Për përmirësimin e imazhit të Kosovës në arenën ndërkombëtare, PDK, do të ketë prioritet:**

- Marrëdhëniet e veçanta me Shtetet e Bashkuara të Amerikës në nivel të partneritetit të thelluar strategjik;
- Vazhdimin e bashkëpunimit strategjik me Gjermaninë, Francën, Britaninë e Madhe, Italinë dhe vendet tjera aleate evropiane;
- Promovimi i fqinjësisë së mirë dhe konstruktive me të gjitha shtetet e rajonit;
- Zbatimi i partneritetit strategjik me Shqipërinë.



## DIPLOMACIA EKONOMIKE

**Në mandatin e ardhshëm, një ndër prioritetet kryesore të politikës së jashtme do të jetë vendosja e diplomacisë kosovare në shërbim të mirëqenies ekonomike të qytetarëve, për ta nxitur zhvillimin ekonomik dhe hapjen e vendeve të reja të punës. Prandaj do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:**

- **Ndërtimi i kapaciteteve për diplomacinë ekonomike** - Në kuadër të diplomacisë ekonomike, do t'i ndërtojmë kapacitetet e brendshme në Ministrinë e Jashtme dhe Korpusin diplomatik për t'i analizuar ekonomitë e vendeve të ndryshme, marrëdhëniet tregtare, të drejtën ndërkombëtare tregtare dhe mënyrën e funksionimit të organizatave kryesore ndërkombëtare, politikat bashkëkohore të tërheqjes së investimeve dhe promovimit të eksporteve, si dhe njohjen më të mirë të korporatave më të fuqishme shumëkombëshe.

- **Ndërveprim të politikave ekonomike** - Do të forcohet lidhja mes politikës së jashtme dhe politikës së brendshme ekonomike, duke nxitur bashkëpunimin intensiv me ministri të linjës që lidhen drejtpërdrejt me ekonominë si: Ministria e Financave, Zhvillimit Ekonomik, Bujqësisë dhe e Tregtisë dhe Industrisë.
- **Rol proaktiv të ambasadave në diplomacinë ekonomike** - Do të ndërmerren prej ambasadave tona veprimtari të shumëfishta në vendet pritëse për ta përmirësuar imazhin, reputacionin, kredibilitetin jo vetëm për Kosovën si shtet, por edhe për produktet e eksporteve të Kosovës si dhe për Kosovën si destinacion investimesh.
- **One stop shop** - Tërheqja e investimeve të drejtpërdrejta të huaja serioze, lehtësimi i procedurave për investitorët e interesuar, do të jetë një nga detyrat më të rëndësishme për diplomatët tanë.
- **Roli i diasporës** - Mobilizimi i diasporës sonë dhe përfshirja e saj në zhvillimin e vendit, duke nxitur kthimin e trurit, të sipërmarrësve apo përdorimin sa më të mirë të remitencave nga njëra anë e nga ana tjetër duke targetuar diasporën si konsumator të eksporteve të Kosovës.
- **Promovimi i marrëveshjeve për tregti të lirë** - Po ashtu prioritet i PDK do të jetë ndërmarrja e negociatave bilaterale apo multilaterale për marrëveshje që lehtësojnë tregtinë me Kosovën, mbrojnë interesat ekonomike të vendit tonë si dhe hap rrugë të reja për marrëdhënie tregtare që i leverdisin ekonomisë sonë.



- a.** Prioritet në fushën e tregtisë do të jetë nxitja e tregtisë me Shqipërinë, Bashkimin Evropian dhe vendet e rajonit;
- b.** Shtimi i Marrëveshjeve të Tregtisë së Lirë me sa më shumë vende dhe përmirësimi i pozicionit në marrëdhëniet multilaterale;
- c.** Do t'i ndërmarrim hapat e parë të anëtarësimit të Kosovës në Organizatën Botërore të Tregtisë si dhe t'i forcojmë marrëdhëniet e Kosovës me organizata ndërshtetërore si EFTA, OECD, etj.;
- d.** Krijimi i lehtësirave të udhëtimit të afaristëve nga Kosova dhe të qarkullimit ndërkombëtar të mallrave dhe kapitaleve nga Kosova;
- e.** Ne do të ndërtojmë një partneritet të mirëfilltë me biznesin e Kosovës, odat e tregtisë, në mënyrë që misionet tona diplomatike të shndërrohen në institucione të marketingut të ekonomisë së Kosovës dhe të produkteve "Made in Kosova";
- f.** Promovimi i Kosovës si destinacion turistik për të tërhequr sa më shumë turistë të huaj për të zhvilluar këtë sektor;
- g.** Sigurimi i furnizimit të vazhdueshëm e të mjaftueshëm me energji, qoftë kjo me rrymë, naftë apo gaz, për të mundësuar lëndë të parë të bollshme për zhvillimin e ekonomisë së vendit;
- h.** Nxitja e transferimit të shkencës, teknologjisë dhe të shkathtësive praktike (know-how) në Kosovë;
- i.** Do t'i angazhojmë ambasadat tona në vendet e zhvilluara që të gjejnë dhe shfrytëzojnë mundësi dhe hapësira për ndihmë ekonomike, kredi të buta, donatorë të huaj, asistencë teknike dhe programe bursash apo trajnimesh për ta rritur kapitalin tonë njerëzor;
- j.** Prioritet i politikës sonë të jashtme do të jetë, gjithashtu, përfshirja e Kosovës në sa më shumë projekte rajonale infrastrukturore të transportit e telekomunikacionit.

## DIASPORA

Partia Demokratike e Kosovës që nga themelimi i vet, është angazhuar vazhdimisht për garantimin e të drejtave të diasporës së Kosovës në botë dhe për pjesëmarrje sa më aktive në jetën publike në Kosovë. Republika e Kosovës është në një fazë jashtëzakonisht të rëndësishme të shtetndërtimit, në një fazë që kërkon angazhimin e të gjithëve për ta arritur përmbylljen e suksesshme të këtij procesi dhe kalimin në ndërtimin e një shoqërie dhe ekonomie të fortë.



Diaspora jonë është e një rëndësie të veçantë jo vetëm për faktin se përfaqëson një segment të rëndësishëm të shoqërisë, por edhe për kontributin e madh që ka dhënë për proceset historike në çlirimin, pavarësimin dhe ndërtimin e shtetit të pavarur të Kosovës. Ky kontribut dhe angazhim i diasporës është një prej faktorëve vendimtarë për ndryshimet pozitive në shtetin tonë.

Numri i aktual i diasporës kosovare llogaritet të jetë 703.978, ku koncentrimi më i madh është në Gjermani me 35.25%, e pasuar nga Zvicra me 22.94 %, por fokusi dhe angazhimi i PDK-së do të jetë në të gjitha shtetet me diasporën e Kosovës. Për ta bërë angazhimin e diasporës në Kosovë dhe të shtetit të Kosovës ndaj diasporës më efektiv, Partia Demokratike e Kosovës do të hartojë një plan veprimi me qëllime dhe objektiva, si vijon:

- Forcimin e lidhjes së diasporës me Kosovën;
- Përmirësimin e kushteve dhe shërbimeve për diasporën në Kosovë (zgjatja e orarit të punës së administratës gjatë verës, hapja e konsullatave të reja dhe zgjerimi i shërbimeve konsullore);
- Përfaqësimin në institucionet e Kosovës: vendet e garantuara të përfaqësimit në Kuvend me tre kandidatë dhe Qeveri;
- Pjesëmarrjen më të madhe në zgjedhje: organizimi i votimit nëpër ambasada, konsullata, qendra kulturore dhe lokacione të tjera ku ka shtrirje të përqendruar diaspora e Kosovës;
- Krijimi i mundësive dhe lehtësive për investime strategjike nga diaspora duke përfshirë pjesëmarrje në proceset e privatizimit;
- Krijimi i regjistrave të diasporës sipas profesioneve (studentë, ndërmarrës, sportistë, etj.);
- Hapja e qendrave të reja kulturore (deri më tani ekzistojnë vetëm në Turqi, Suedi dhe Zvicër; duhet të hapen në Gjermani, ShBA, Mbretëri të Bashkuar, etj.);
- Mësim plotësues në gjuhën shqipe dhe përkrahje e mësuesve për certifikim;
- Afirmim i identitetit kombëtar në diasporë (përmes angazhimeve dhe kampanjave të vazhdueshme, ndërlidhja me projektet politike në vend);
- Angazhimi i diasporës në lobim të vazhdueshëm për avancim të subjektivitetit ndërkombëtar të Kosovës dhe sjelljen e investimeve të huaja;
- Iniciativa për projekte të drejtpërdrejta të diasporës në Kosovë (p.sh., sportistët e Kosovës jashtë të kontribuojnë dhe menaxhojnë projektin e ndërtimit të një stadiumi);

## **PËRFSHIRJA E DIASPORËS NË JETËN PUBLIKE NË KOSOVË: STORIT E SUKSESIT DHE KTHIMI I “TRURIT”**

Partia Demokratike e Kosovës, synon që t’i identifikojë ekspertët e fushave të ndryshme, ndërmarrës dhe njerëz të artit, kulturës dhe shkencës, të cilëve do t’u ofrohet hapësirë për ta dhënë kontributin e tyre profesional në fushat përkatëse.

- Për ndërmarrësit do ta miratojmë **Ligjin për Investime Strategjike të Diasporës** në Kosovë, i cili do të krijojë përparësi në kushte të barabarta për realizimin e projekteve publike në Kosovë, eliminimin e barrierave për investime të drejtpërdrejta dhe subvencionimin nga shteti;
- **Program i punës praktike** (internship) për të rinjtë e diasporës në institucionet publike, do të ofrohet për të rinjtë nga diaspora me qëllim të krijimit të lidhjeve të reja dhe identifikimit të potencialeve për angazhime të ndryshme;
- **Universitetet verore për diasporën** - Në të gjitha universitetet publike do të përkrahët program i veçantë për pjesëmarrjen e studentëve nga diaspora;
- **Forumi i përvitshëm i diasporës** - Çdo verë në Kosovë do të organizohet forum i madh për diasporën, ku do të marrin pjesë struktura të ndryshme nga diaspora, varësisht nga tema vjetore që do të ketë Forumi;
- Bashkëpunimi me organizata të diasporës kosovare në funksion të krijimit të një rrjeti sa më të gjerë dhe mundësive për bashkëpunim.

## Caktimi i personave përgjegjës të diasporës në baza tematike dhe gjeografike

Partia Demokratike e Kosovës, do të krijojë një skemë strukturore për secilin shtet ku ka numër të madh të pjesëtarëve të diasporës, me qëllim të krijimit të skeletit organizativ të PDK-së jashtë vendit, e cila strukturë do të plotësohet me persona përgjegjës me ndikim, të cilët do të punojnë për rritjen e bazës së votuesve të Partisë Demokratike.

Caktimi i personave përgjegjës do të fokusohet kryesisht në:

- shkollat dhe universitetet në të cilat mësohet gjuha shqipe;
- shkencëtarët dhe studiuesit;
- ekspertët e fushave përkatëse;
- lobistët për interesa të Kosovës;
- politikanë dhe përfaqësues parlamentarë;
- artistë, sportistë dhe forma të ndryshme të organizimit të tyre;
- rrjetet e të rinjve, profesionistëve dhe formave të tjera të organizimit të tyre.

## FUQIZIMI I POTENCIALIT ZHVILLIMOR TË DIASPORËS

Shteti i Kosovës, do të përftojë shumë nëse e sheh diasporën si burim të investimeve të drejtpërdrejta të huaja dhe do ta përdorë Ministrinë e Jashtme dhe Ministrinë e Diasporës për të tërhequr investime, duke lehtësuar marrëdhënien e diasporës me agjencitë apo institucionet shtetërore përkatëse. Ministria mund të shërbejë, gjithashtu, duke i ofruar diasporës informacione të hollësishme lidhur me legjislacionin e Kosovës, jetën financiare dhe ekonomike, politikën fiskale dhe monetare dhe të tjera të ektorë me prioritet të lartë, si:



dhëna të nevojshme, për të investuar apo bërë tregti në Kosovë. Gjithashtu, mund të ndihmojë për vendosjen e lidhjeve në mes të biznesmenëve të diasporës dhe biznesit vendës.

Në fushën e ekonomisë, PDK-ja do të përplojë që ta mundësojë shtimin e eksporteve kosovare, duke promovuar konsumimin e tyre nga diaspora. Përpos promovimit të produkteve nga Kosova, Ministria mund ta promovojë edhe ofertën turistike të Kosovës, duke nxitur "turizmin patriotik", pra, duke mundësuar tërheqjen e turistëve që vizitojnë Kosovën nga radhët e diasporës. Me rëndësi të veçantë është edhe nxitja e përfshirjes së diasporës në Kosovë në si: arsimit, shëndetësia, teknologjia e lartë si dhe në veprimtaritë humanitare, sportive apo kulturore. PDK-ja, nëpërmjet vendosjes së lidhjeve sa më të mirë të potencialit intelektual dhe afarist të diasporës, do të mundësojë që të mbajë diasporën të lidhur me vendlindjen e tyre, Kosovën.

## KONSERVIMI I IDENTITETIT KOMBËTAR DHE FORCIMI I LIDHJES ME ATDHEUN

Gjatë mandatit të ardhshëm, do ta fuqizojmë bashkëpunimin me Republikën e Shqipërisë, për të krijuar një program të përbashkët për zhvillimin e mësimit plotësues në diasporë dhe mërgatë.

PDK-ja do të punojë edhe më shumë për ringjalljen, konservimin, pasurimin dhe trashëgiminë e identitetit kombëtar, kulturës, gjuhës dhe traditës shqiptare në diasporë.

Në kuadër të kësaj, synohet të thellohet institucionalizimi i organizimit të mësimit plotësues në diasporë, me qëllim të përfshirjes së një numri më të madh të fëmijëve që marrin pjesë në proces, si dhe modernizimin e procesit edukativo-arsimor sipas standardeve bashkëkohore nëpërmjet unifikimit të planprogrameve mësimore dhe përgjithësisht sistemit të mësimit plotësues.

Kosova tashmë ka filluar themelimin e qendrave kulturore të diasporës dhe mërgatës dhe një qendër e tillë është hapur në Stamboll. Megjithatë, në mënyrë që të kemi një qasje gjithëpërfshirëse gjatë mandatit të ardhshëm, në kuadër të marrëveshjeve me Qeverinë e Shqipërisë, do të punojmë për themelimin dhe funksionimin e përbashkët të qendrave kulturore. Kjo do të ndihmonte në organizimin më të mirë të mërgatës shqiptare si dhe për krijimin e urave të komunikimit ndërkulturor me përfitime të ndërsjella, për krijimin e partneritetit strategjik midis shteteve ku themelohen këto qendra dhe dy republikave, asaj të Kosovës dhe të Shqipërisë.



## ANGAZHIMI I DIASPORËS NË SFIDAT DIPLOMATIKE TË KOSOVËS

PDK-ja do të përqipet që diaspora kosovare të angazhohet jo vetëm në zhvillimin ekonomik të Kosovës, por edhe në përpjekjet diplomatike dhe politike të Kosovës. Mund ta mobilizojë diasporën që të llobojë në vendet pritëse lidhur me prioritetet kombëtare sikurse janë njohja ndërkombëtare e Kosovës, integrimi euroatlantik i Kosovës, apo realizimi i të drejtave apo përmirësimi i gjendjes së shqiptarëve në shtetet ku janë minoritetet. Në këtë kontekst, PDK-ja do ta përfshijë diasporën në përpjekjet që bëhen për promovimin e kulturës, traditës, gjuhës, personaliteteve dhe monumenteve kosovare në vendet pritëse. Mund ta nxisë diasporën të angazhohet në nisma, fushata apo projekte që synojnë ta përmirësojnë imazhin e Kosovës dhe shqiptarëve nëpër botë dhe mundësojnë një brendim (brand) të suksesshëm të shtetit tonë.

## KTHIMI “TRURIT”

PDK-ja, do të punojë akoma më shumë me diasporën për ta rritur cilësinë e burimeve njerëzore të Kosovës, duke u përpjekur që ta kthejë “trurin”, pra individët më të mirëkualifikuar që gjenden në diasporë. PDK-ja në lidhje me diasporën, do të merret, pos të tjerave, me identifikimin e talenteve të sportit dhe artit në diasporë dhe përfshirjen e tyre në jetën sportive dhe artistike të Kosovës. Për këtë qëllim, mund të shërbejë për lehtësimin e konvalidimit në Kosovë të diplomave apo kualifikimeve të tjera të anëtarëve të diasporës. Ajo duhet ta bëjë evidentimin e kapaciteteve njerëzore të diasporës, duke ndërtuar një databazë ekspertësh të mirëkualifikuar si dhe do ta bëjë identifikimin e nevojave se ku mund të shfrytëzohen këta profesionistë.

Po ashtu, mund ta nxisë integrimin e akademikëve apo shkencëtarëve të diasporës me komunitetin akademik e shkencor në atdhe. Fillimisht, do të punojë në drejtim të promovimit të kthimit të potencialit intelektual të diasporës, përmes krijimit të një regjistri për profilin profesional të diasporës. Një aspekt tjetër do të jetë krijimi i një mekanizmi për shkëmbimin e përvojave ndërmjet profesionistëve nga diaspora dhe atyre rezidentë në fusha të ndryshme profesionale, me theks të veçantë në mjekësi, teknologji, shkencë dhe inovacion. Në kuadër të përkrahjes që do ta bëjmë për zhvillimin e shkencës dhe teknologjisë, ne do të punojmë në atë drejtim që ta inkurajojmë bashkëpunimin ndërmjet shkencëtarëve nga diaspora dhe atyre rezidentë, në projekte të ndryshme shkencore.

## INTEGRIMI MBARËSHQIPTAR

PDK-ja si një parti me rrënjë të forta dhe të dëshmuara patriotike, do të angazhohet për rritjen dhe forcimin e lidhjes mes shqiptarëve që jetojnë në shtetet e ndryshme të rajonit, duke respektuar njëherazi sovranitetin e shteteve përkatëse. Për këtë arsye, do të synohet harmonizimi i politikave dhe qëndrimeve gjeopolitike me faktorët shqiptarë në shtete të ndryshme, do të nxitet integrimi i plotë i jetës kulturore, akademike dhe artistike si dhe do të lehtësohet qarkullimi i njerëzve dhe mallrave. Po ashtu, do t'i mbrojmë dhe promovojmë të drejtat e shqiptarëve që janë pakicë në shtetet fqinje si dhe do t'i mbështesë përpjekjet e tyre për ta ruajtur identitetin, gjuhën, arsimin, kulturën, traditën dhe monumentet shqiptare.

PDK-ja, gjithashtu, do t'i përkrahë hapat që përshpejtojnë integrimet evropiane në rajon me shpresën që realizimi i ëndrrës së kamotshme të shqiptarëve për bashkim kombëtar të realizohet kur të gjitha shtetet ku jetojnë shqiptarët të bëhen anëtare në Bashkimin Evropian.





Duke pasur këtë aspiratë atdhetare, ashtu sikurse ka bërë deri më tani, PDK-ja do të vendosë prioritet në qeverisjen e saj:

- **Përfshirjen e kandidatëve** nga Lugina e Preshevës në listën elektorale të PDK-së për zgjedhjet e 14 Shkurtit;
- **Projektet infrastrukturore** që kanë për qëllim lidhjen më të shpejtë e më të ngushtë me bashkëkombësit përtej kufirit. Të tilla do të jenë në mandatin e ardhshëm projektet si rruga Deçan - Plavë, Prizren - Tetovë, Restelicë - Dibër si dhe ndërtimi i autostradës së Gjilanit e cila do ta ruaj, shpejtojë dhe forcojë lidhjen me Preshevën.
- **Konsultimet për çështje rajonale** - PDK-ja, gjithashtu, do të angazhohet për bashkëpunim sa më të ngushtë dhe konsultime të shpeshta për çështjet rajonale me partitë politike shqiptare në Shqipëri, Maqedoni, Mal të Zi, Luginë të Preshevës dhe Sanxhak. Po ashtu, do të organizojë një program masiv bursash të plota për të nxitur ardhjen në Kosovë të studentëve nga të gjitha viset e sipërpërmendura të banuara nga shqiptarët.

## INTEGRIMI EVROPIAN

PDK-ja është një parti pro perëndimore dhe e konsideron integrimin e Kosovës në Bashkimin Evropian si një ndër qëllimet e veta kryesore. Qeveritë Kurti dhe Hoti e kanë lënë anash agjendën evropiane duke mos i kushtuar vëmendjen e duhur reformave të brendshme si dhe duke mos punuar sa duhet për përmirësimin e raporteve me institucionet evropiane të Brukselit dhe vendet anëtare të BE-së. Kosova është pjesë e natyrshme dhe e pashmangshme e kontinentit evropian. Po ashtu, anëtarësimi në BE do ta përbëjë arritjen e standardeve më të larta të lirisë, demokracisë, ekonomisë së tregut, të drejtave të njeriut dhe pakicave, marrëdhënieve fqinjësore dhe paqes, mundëson bashkimin kombëtar në familjen e madhe evropiane.

Për këtë qëllim, PDK-ja do ta dedikojë maksimumin e energjive dhe burimeve për t'i shtyrë përpara reformat dhe proceset që bëjnë të mundur përbushjen e kriteve të përcaktuara për çdo hap të nevojshëm deri në anëtarësim. Po ashtu, do të angazhohet tërësisht për të arritur një konsensus gjithëpartiak në Kosovë, në mënyrë që të sigurohet mbështetja sa më e fuqishme për t'i zbatuar rekomandimet për të harmonizuar legjislacionin me Bashkimin Evropian.



Nën udhëheqjen e PDK-së, integrimi i Kosovës në Bashkimin Evropian do të kthehet në prioritet shtetëror dhe në këtë aspekt do të punohet intensivisht në dy qasje.

1. Nga njëra anë politika e jashtme e Kosovës do të punojë për të mbajtur, kultivuar dhe thelluar bashkëpunimin me shtetet anëtare të kësaj organizate mbi nacionale;

2. Nga ana tjetër, do të punojë për ta forcuar bashkëpunimin dhe partneritetin me institucionet e BE-së. Lidhur me këtë të fundit PDK-ja do të përqendrohet për t'i përmirësuar marrëdhëniet duke synuar njohjen me pesë vendet anëtare të BE-së që ende nuk na njohin.

Në aspektin konkret teknik, PDK-ja do të përqendrohet për vënien në jetë sa më shpejt të Planit Kombëtar për Zbatimin e MSA-së (PKZMSA), si dokumenti kryesor për integrim evropian në Kosovë. Për ta bërë këtë gjë të mundur do të përqendrohet në këto aktivitete:

Përditësimi vjetor dhe përmirësimi i saktësisë së PKZMSA-së në bashkëpunim të ngushtë me ministrinë;

Promovimi i rezultateve të arritura të zbatimit të PKZMSA-së përmes vlerësimeve cilësore nga departamentet relevante në ZKM;

Prezantimi i arritjeve dhe gjendjes aktuale në Kuvend me qëllim të marrjes së mbështetjes së plotë për zbatimin e çështjeve që janë më të vështira dhe politikisht të ndjeshme;

Ngritja e besueshmërisë për PKZMSA si dhe ngritja e transparencës dhe gjithëpërfshirjes gjatë implementimit të saj, aspekte këto të cilat do ta rrisin besimin ndaj institucioneve të BE-së dhe shteteve anëtare të saj;

Departamentet relevante për procesin e integritit evropian, duhet të sigurojnë zbatim të plotë të ERA 2, në mënyrë gjithëpërfshirëse, transparente dhe brenda afateve. Pasi që ERA është subjekt i Dialogut të nivelit të lartë, mbi prioritetet kyçe në mes të Kosovës dhe BE-së, atëherë rezultatet e prekshme të saj do të kenë ndikim të drejtpërdrejtë në pozicionet e shteteve anëtare të BE-së;

Rishikimin e Listës së Projekteve prioritare, duke përfshirë në të edhe projektet e infrastrukturës digjitale, përpos projekteve mjedisore, të transportit, sociale dhe të energjisë. Kjo listë e përditësuar do të jetë udhërrëfyese e Kosovës për procesin e Berlinit, për investitorët e huaj, donatorët dhe institucionet financiare ndërkombëtare.

Për sa i përket aplikimit të Kosovës për anëtarësim në BE duhet që para së gjithash, Kosova ta japë shembullin para partnerëve strategjikë që lidhshipi i saj do të veprojë në linjë me agjendën e BE-së dhe të shteteve anëtare të saj, ashtu sikundër që duhet t'u përshtatet vendimeve dhe aktiviteteve në përputhje me dinamikat e procesit të zgjerimit të BE-së, në katër vitet e ardhshme. Portugalia aktualisht e ka Presidencën e BE-së, shtet ky që është mbështetës i madh i procesit të zgjerimit, ndërkohë që pas saj kryesimin e merr Sllovenia, një vend që ka lidhje të forta dhe interesa në Ballkan Perëndimor dhe që është shumë miqësore ndaj Kosovës. Ky është një rast i mirë i Kosovës, Qeverisë së ardhshme të saj dhe tërë shoqërisë tonë që të bëhen hapa shtesë për aplikimin e Kosovës për anëtarësim në BE dhe të vazhdohet me punë drejt arritjes së qëllimit strategjik. Presidencat e radhës do të jenë nga Franca, Republika Çeke, shtete të gjitha këto mike të Kosovës. Prandaj, PDK-ja në mandatin e ardhshëm do të angazhohet intensivisht që ta shfrytëzojë rastin për ta përshpejtuar procesin e integritit evropian të Kosovës.

## DIALOGU

Partia Demokratike e Kosovës, në kuadër të prioriteteve të politikës së jashtme, të mandatit të ardhëm qeverisës, do të vazhdojë të jetë e angazhuar për fqinjësi të mirë me të gjitha shtetet e rajonit, duke përfshirë Serbinë. PDK-ja ka qenë e para dhe e vetmja parti që në formë të shkruar ka prezantuar një vizion të qartë për dialogun. Përpos kësaj, ka qenë e para dhe e vetmja që në shumë raste është përpjekur me nisma konkrete që të sigurojë një konsensus politik dhe një gjithëpërfshirje partiake për t'i dhënë zgjidhje çështjes së dialogut. Është partia e parë dhe e vetme që ka pasur strategji të qartë në dialog, të koordinuar me partnerët strategjik dhe ka mbajtur qasje të integruar në dialog. Prandaj, në mandatin e ardhshëm PDK do të fokusohet në:



- **Marrje të përgjegjësisë** - Dialogu me Serbinë nuk është temë popullore, por është një çështje që kërkon një përgjegjësi politike dhe që kërkon epilog, në mënyrë që mos t'ia lëmë barrë këtë çështje te brezat që vijnë. PDK-ja është parti që merr përgjegjësi dhe në Qeverinë e ardhshme, do të vazhdojë në mënyrë pragmatike këtë proces duke mbrojtur interesat shtetërore të Kosovës dhe marrëdhëniet me aleatët tanë. Ne jemi e vetmja parti që dimë t'i mirëmbajmë dhe shtypmë përpara këto dy synime.
- **Konsensus ndër-partiak** - PDK-ja do të angazhohet për ndërtimin e një konsensusi të gjerë në mes të subjekteve politike të përfaqësuara në Kuvendin e Kosovës për çështjen e dialogut, për normalizimin e marrëdhënieve në mes të Republikës së Kosovës dhe Serbisë, i ndërmjetësuar nga Bashkimi Evropian dhe me përkrahje aktive të Shteteve të Bashkuara të Amerikës.
- **Respektim të Kushtetutës** - Dialogu do të zhvillohet në pajtim të plotë me Kushtetutën e Republikës së Kosovës dhe ligjet në fuqi. Prandaj, çdo marrëveshje e arritur do të jetë subjekt i vlerësimit të Gjykatës Kushtetuese. E gjithë kjo, pasi qëllimet kryesore të dialogut janë forcimi i sovranitetit shtetëror të Kosovës, anëtarësimi i Kosovës në OKB dhe realizimi i vizionit euroatlantik të Kosovës për integrim në Bashkimin Evropian dhe strukturat euroatlantike në respektim të plotë të sovranitetit, integritetit territorial dhe rendit kushtetues të Kosovës.
- **Jo dialog pa fund** - Dialogu do të rifillojë me një ritëm të përshpejtuar sapo të përmbushen kushtet e domosdoshme, siç janë: zbatimi i plotë i marrëveshjeve të arritura deri më tash nga dialogu i Brukselit, duke përfshirë këtu edhe marrëveshjen e Uashingtonit, dhe negocimi për arritjen e marrëveshjes gjithëpërfshirëse dhe ligjërisht obliguese e cila do t'i mbyllë të gjitha çështjet e hapura në mes dy shteteve tona dhe do t'i sigurojë Kosovës anëtarësim në OKB dhe organizata të tjera ndërkombëtare.

## PARIMET KRYESORE TË DIALOGUT



Parimi kryesor që do t'i karakterizojë marrëdhëniet në mes të Kosovës dhe Serbisë do të jetë reciprociteti. PDK-ja, në mandatet e kaluara qeverisëse, për herë të parë ka propozuar dhe zbatuar masa reciproke ndaj Serbisë. Për mandatin e ardhshëm të qeverisjes, PDK-ja ka hartuar planin e masave reciproke që do të zbatohen si kundërpërgjigje ndaj politikave destruktive të Serbisë.

- Dialogu në çdo rrethanë duhet të përfshijë vetëm çështje të interesit të ndërsjellë mes dy shteteve, pa prekur në asnjë rast sovranitetin e shtetit të Kosovës, pavarësinë, integritetin territorial dhe rregullimin e brendshëm kushtetues të Kosovës.
- PDK-ja në asnjë rast nuk do të pranojë që të negociohet në formë të ndonjë konference ndërkombëtare, ngaqë ajo do të nënkuptonte diskutime për çështjen e statusit të cilin Kosova e ka përmbyllur më 17 shkurt 2008 dhe është konfirmuar nga GjND-ja;
- PDK-ja do ta parandalojë dialogun e ndërmjetësuar apo të drejtpërdrejtë me pakicat, ngaqë kjo do ta nënkuptonte heqjen e kushtëzimit të Serbisë nga BE-ja të përcaktuar në Kapitullin 35 e, po ashtu, tejkalim të drejtave që u janë dhënë minoriteteve në Kosovë sipas pakos së Ahtisarit;
- PDK-ja nuk do të lejojë asociacion me kompetenca ekzekutive apo ndonjë pushtet të tretë. Pakoja e Ahtisarit garanton, përtej konventave ndërkombëtare, të drejtat e pakicave në Kosovë, e sidomos ato të minoritetit serb;
- Marrëveshja e prillit 2013, e ratifikuar në Kuvendin e Kosovës dhe interpretimet e Gjykatës Kushtetuese për marrëveshjet e Brukselit, janë të mbyllura dhe do të zbatohen në përpikëri;
- Marrëveshja e ardhshme do ta garantojë respektimin plotë të sovranitetit shtetëror dhe integritetit territorial mes dy shteteve, njohjen e ndërsjellë dhe anëtarësimin e Kosovës në OKB. Po ashtu, heqjen dorë të Serbisë nga kundërshtimi, ose ndikimi mbi palët e treta që ta kundërshtojnë anëtarësimin e Kosovës në organizatat ndërkombëtare;
- Respektimin e ndërsjellë të të drejtave të minoriteteve në të dyja shtetet; ajo çka vlen për serbët në Kosovë të vlejë për shqiptarët e Luginës së Preshevës në Serbi;
- Burimet natyrore dhe asetet të cilat janë në territorin sovran të Republikës së Kosovës janë ekskluzivisht të Republikës së Kosovës dhe rrjedhimisht nuk janë të hapura për negociim.
- Marrëveshja përfundimtare, ligjërishet e detyrueshme, do të hyjë në fuqi vetëm pas njohjes së Kosovës nga Serbia dhe aprovimit popullor të marrëveshjes me anë të referendumit.

## ÇËSHTJET QË DUHET T'I PËRMBAJË MARRËVESHJA FINALE:

1. Zgjidhja e plotë e çështjes së personave të pagjetur. Do të kërkohet rol aktiv i BE-së, duke e emëruar një emisar special për këtë çështje. Do të kërkohet hapja e arkivave, e ish-Ushtrisë Jugosllavisë dhe informacion i plotë për fatin e të pagjeturve;
2. Vendosja e bashkëpunimit ndërshtetëror në fusha me interes të ndërsjellë, në bazë të parimit të reciprocitetit (transporti rrugor, hekurudhor, transporti ajror, njohja reciproke e certifikatave të vlerësimit të konformitetit, etj.);
3. Respektimi i ndërsjellë i të drejtave të minoriteteve në të dy shtetet;
4. Ndërprerja e ndërhyrjeve të Serbisë në Kosovë në fushat e tjera që nuk janë trajtuar në Marrëveshjen e Brukselit, shuarja e të gjitha strukturave paralele;
5. Sukcesioni mbi parimin e zhbërjes së ish-Jugosllavisë ku Kosova ishte një nga tetë njësitë federale. Ndarja e pasurisë së ish-Jugosllavisë dhe borxhi ndërkombëtar; asetet financiare; pronat e misioneve diplomatike dhe konsullore; pronat e luajtshme; pronat ushtarake; arkivat dhe dokumentet e ish-Jugosllavisë për Kosovën; kthimi i listës me të dhënat e plota për të gjitha objektet dhe pajisjet radioaktive, etj.;

6. Reparacionet e luftës, kompensimi i dëmeve të luftës, dëmshpërblimi për shkatërrimin e sistemit buxhetor dhe financiar të Kosovës dhe dezinvestimet. Kompensimi për humbjet e pagave të personave të përjashtuar nga puna, për shkatërrimin e sistemit pensional, sistemit bankar dhe kursimet devizore. Dëmshpërblimi për dëmet e luftës në pronën private dhe publike dhe objektet e trashëgimisë kulturore dhe fetare. Zhdëmtimi i familjarëve të atyre që janë vranë dhe zhdukur nga Serbia, dëmshpërblimi i personave apo familjarëve të atyre që janë mbajtur politikisht nëpër burgjet e ish-Jugosllavisë dhe dëmshpërblimi i grave të dhunuara gjatë luftës së fundit në Kosovë;
7. Kthimi i të zhvendosurve, ashtu siç është cekur edhe në pakon e Ahtisarit, i të gjithë refugjatëve dhe personave të zhvendosur brenda vendit nga Kosova, do të kenë të drejtën e kthimit dhe kërkimit të pronës së tyre dhe posedimeve personale, në pajtim me ligjet vendore dhe ndërkombëtare. Kjo duhet të ndodhë në të gjithë territorin e Kosovës, përfshirë pjesën veriore ku kthimi i shqiptarëve të shpërngulur nuk ka ndodhur ende;
8. Kthimin e eksponateve të trashëgimisë kulturore të marra/huazuara nga Serbia, kthimi i filmave të "Kosovafilm"-it, kthimi i fondit pensional dhe invalidor të qytetarëve të Kosovës si dhe kthimi i depozitave bankare të qytetarëve të Kosovës.

## PRANIMI I PËRGJEGJËSIVE DHE KËRKIMI I FALJES

Shteti serb duhet ta pranojë përgjegjësinë për gjenocidin në Kosovë dhe liderët serbë të kërkojnë falje publike për krimet e bëra në Kosovë. Po ashtu, të angazhohen që këtë të vërtetë historike ta raportojnë në edukimin e brendshëm publik si masë që një qasje e tillë të mos përsëritet më nga shteti serb. Një çështje me rëndësi që do të kërkohet është përfshirja e krimeve të Serbisë në Kosovë në librat e tyre shkollorë në mënyrë që edhe shoqëria serbe të njohë të vërtetën e mos të ushqejë urrejtje në të ardhmen ndaj fqinjëve.

## NJOHJA NDËRKOMBËTARE E GJENOCIDIT SERB NË KOSOVË



Lidershipi i PDK-së ka nisur dhe do ta çojë më tutje kërkesën për njohjen ndërkombëtare të gjenocidit serb në Kosovë. Deri më tani, në cilësinë e tij sa ishte kryetar i Kuvendit, z. Kadri Veseli, kishte dërguar letra shumë liderëve botërorë, përfshirë Kongresin Amerikan, për të nxjerrë rezoluta që njohin krimet dhe gjenocidin që Serbia ka kryer në Kosovë gjatë luftës së fundit, në vitet 1998-1999.

Nën udhëheqjen e PDK-së, diplomacia e vendit, të gjithë përfaqësuesit qeveritarë dhe i gjithë spektri shoqëror, do të angazhohen që të ndërkombëtarizojnë informimin se nën regjimin brutal të Millosheviqit, shqiptarët në Kosovë ishin viktima dhe objektivi i dhunës sistematike. Si pasojë, rreth një milion shtetas të Kosovës, më shumë se gjysma e popullsisë, janë detyruar të largohen nga Kosova, një gjysmë milioni të tjerë janë zhvendosur brenda vendit. Në total, rreth 90 për qind e popullsisë etnike shqiptare u bënë refugjatë ose persona të zhvendosur. 13.535 u vranë, në mesin e tyre ishin 1.230 fëmijë, duke përfshirë foshnja. Prandaj, një krim i tillë duhet të dënohet nga të gjitha vendet e komunitetit paqedashës ndërkombëtar, në mënyrë që krime të tilla të jenë pjesë e së kaluarës historike të botës.

Gjatë dhjetë vjetëve të ekzistencës së saj shtet, Kosova ka treguar se është një vend paqedashës dhe që në mënyrë aktive kërkon marrëdhënie pozitive me të gjithë fqinjët, duke përfshirë këtu Serbinë. Megjithatë, duhet bërë shumë për ta mundësuar shërimin, pjesë e këtij shërimi është pranimi i së vërtetës.

## MBROJTJA



Partia Demokratike e Kosovës i ka prirë procesit të shtetndërtimit dhe ngritjes së institucioneve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes dhe ky sektor do të vazhdojë të përbëjë prioritet të veçantë edhe për qeverisjen gjatë mandatit të ardhshëm. Në këtë drejtim, PDK-ja është përkushtuar për zhvillimin dhe profesionalizimin e Forcave të Armatosura të Kosovës për ta mbrojtur integritetin dhe sovranitetin shtetëror dhe për të garantuar siguri për pronën dhe jetën e të gjithë qytetarëve të Republikës së Kosovës.

Për këtë arsye, PDK-ja do ta vazhdojë mbështetjen e transformimit të plotë nga Forca të Sigurisë së Kosovës në Forcat e Armatosura të Kosovës, në bashkëpunim të ngushtë me NATO-n, duke përkrahur: ngritjen e kapaciteteve të plota operationale, menaxhimin e kapaciteteve për operatione paqeruajtëse, menaxhimin e personelit përmes edukimit dhe trajnimit të vazhdueshëm brenda dhe jashtë vendit, thellimin e partneritetit me ShBA-në dhe partnerët e tjerë si dhe arritjen e standardeve të NATO-s.

PDK-ja do të kujdeset që Forcat e Armatosura të Kosovës (FAK) të jenë forca profesionale, shumetnike, të pajisura në mënyrë moderne, me kuadro kompetente dhe të udhëhequra sipas parimeve të kontrollit demokratik dhe civil. Vëmendje e madhe do t'i kushtohet përfshirjes së sa më shumë pjesëtarëve të komuniteteve jo shumicë.

Në kuadër të rritjes së kapaciteteve të Forcave të Armatosura të Kosovës, vëmendje e veçantë do t'i kushtohet përmirësimit të kushteve të punës së ushtarakëve në mënyrë që ata të ndihen të motivuar dhe të jenë sa më besnikë ndaj interesave të shtetit. Prandaj kujdes i veçantë do t'i jepet përmirësimit të trajtimit financiar të ushtarakëve aktivë si mënyra më e mirë për ta siguruar mbajtjen dhe tërheqjen e burimeve njerëzore cilësore në Forcat e Armatosura të Kosovës gjatë të ardhmes, por edhe për trajtimin dinjitoz të ushtarakëve në rezervë apo pension.

Prioritet, pa dyshim, do të jetë avancimi në procesin e anëtarësimit në NATO si dhe bashkëpunimi i ngushtë me KFOR-in. PDK-ja e shikon anëtarësimin në NATO si formën e vetme për parandalimin e kërcënimeve të mundshme, sfidave dhe rreziqeve për stabilitetin e Kosovës dhe të rajonit. Për këtë arsye, Kosova do të vazhdojë të angazhohet për ta arritur anëtarësimin në Programin e Partneritetit për Paqe (PfP) të NATO-s dhe mekanizmat tjerë euroatlantike, për t'i avancuar marrëdhëniet me NATO-n dhe për ta forcuar stabilitetin, sigurinë dhe paqen në Kosovë dhe në rajon.

Prandaj, PDK-ja do ta japë maksimumin që Kosova të luajë një rol sa më aktiv e cilësor në mekanizma dhe struktura rajonale të sigurisë, për t'u dëshmuar partner i përgjegjshëm i NATO-s në rajon. Prioritet i PDK-së në fushën e mbrojtjes do të jetë forcimi i lidhjes me NATO-n në dy rrafshje, politik dhe ushtarak. Në rrafshin politik, do të synohet që nëpërmjet Partneritetit për Paqe të fillohet një fazë e re e bashkëpunimit me NATO-n e cila do ta çojë Kosovën më afër anëtarësimit të plotë në këtë aleancë. Në rrafshin ushtarak, Kosova do të përpiqet të përfitojë sa më shumë nga ekspertiza dhe përvoja e vendeve të Aleancës Veri-Atlantike duke u përfshirë sa më shumë në stërvitjet e përbashkëta ushtarake dhe duke dërguar sa më shumë ushtarakë për t'u aftësuar në këto vende.

Kosova ka qenë për një kohë të gjatë përfituese ose importuese e sigurisë dhe me konsolidimin e shtetit, vendi ynë nën udhëheqjen e PDK-së, do të dëshmojë se e meriton vendin në rendin e shteteve të pavarura. Këtë gjë do ta bëjë duke zhvilluar kapacitete për të kontribuar në misionet ndërkombëtare të paqes, dialogut dhe zgjidhjes së krizave dhe asistencës humanitare dhe zhvillimore.



## RIMËKËMBJE E SEKTORIT TË ARSIMIT

Mësimdhënia dhe mësimnxënia në të gjitha nivelet e Arsimit në Kosovë, është ballafaquar me vështirësitë më të mëdha gjatë periudhës së Pandemisë Covid-19. Nevoja për izolim, pamundësia e zhvillimit të mësimin nëpër shkolla, paaftësia e MASHT dhe DKA-ve për adresimin e nevojave për mbarëvajtje të arsimit, mungesa e digjitalizimit në shkolla, vendimet kontradiktore të Qeverisë të cilat ndikuan tek nxënësit dhe mësimdhënësit, etj., janë vetëm disa nga efektet negative me të cilat janë ballafaquar qytetarët e vendit tonë si pasojë e pandemisë Covid-19 dhe keq-menaxhimit të Qeverisë. PDK me të marrë qeverisjen, do të punojë në adresimin e efekteve të menjëhershme të Pandemisë Covid-19 duke marrë veprime adekuate.

Pasi të sanohet gjendja në arsim nga keqqeverisja e Kurtit dhe pastaj Hotit, atëherë qeverisja e PDK-së do të fokusohet në forcimin e arsimit në bazë të trendeve globale. Kjo do të bëhet përmes mekanizmave, konkret në ofertën e PDK-së për qytetarët e Kosovës duke u bazuar në rekomandimet e organizatave ndërkombëtare si Banka Botërore, Forumi Ekonomik Botëror, OECD dhe sugjerimet e palëve të interesit në Kosovë, siç janë mësimdhënësit, nxënësit, prindërit, SBASHK-u, shoqëria civile, etj.



- Zbatimi dhe mirëmbajtja e Learning Management Systems dhe G-suite
- Trajnimi i mësimit dhe mësimit në distancë/virtual;
- Rritja e stafit mbështetës në shkollë (Specialistë të IT, psikologë, etj.);
- Zbatimi i konceptit hibrid të klasave – me rotacion gjysma fizikisht dhe gjysma virtual;
- Sigurimi i mjeteve mbrojtëse kundër pandemisë Covid-19 për mësimit dhe nxënës;
- Anulimi i shkurtimit të orëve të mësimit në 20 minuta dhe si pasojë humbja e më se 33% e mësimit;
- Sigurimi që çdo fëmijë të ketë kushtet për ndjekje të mësimit;
- Përkrahja e familjeve me fëmijë në shkollim me 50/100/200 euro.

Zhvillimi i një shoqërie dhe mirëqenia e saj, në mënyrë të drejtpërdrejtë matet dhe varet me zhvillimin e arsimit, shkencës dhe teknologjisë. Prandaj, programi i Rimëkëmbjes i PDK-së, parasheh ndërmarrjen e një sërë masash afatgjata të cilat do të ndikojnë që sistemi arsimor i Kosovës të jetë në funksion më të drejtpërdrejtë të edukimit të fëmijëve, nxënësve dhe studentëve tanë të cilat ndikojnë në zhvillimin ekonomik dhe të rritjes së punësimit.

Edhe pse në vitet e fundit Kosova ka rritur mbështetjen e saj në arsim duke rritur ndjeshëm buxhetin dhe pagat e mësimit dhe mësimit, kjo rritje nuk është reflektuar në cilësinë në arsim, siç është konfirmuar edhe nga testi PISA. Që fëmijëve tanë t'u sigurojmë një të ardhme në bashkësinë e shoqërive të dijes dhe shkathtësive, duhet që sistemi i arsimit të reformohet, vazhdimisht dhe në të gjitha nivelet, duke reflektuar zhvillimet teknologjike dhe kërkesat dinamike të tregut të punës. Vetëm një arsim cilësor, në të gjitha nivelet, nga ai parashkollor deri tek arsimi i lartë, është siguria e vetme e Kosovës për zhvillim. Për të arritur këto, PDK synon të rrisë buxhetin e përgjithshëm të arsimit, ulë koston e arsimit në vetëm kosto administrative, të rrisë buxhetin e R&D në 20 milion euro.

Arsimi, shkencë dhe teknologjia mbesin sfera shumë dinamike të zhvillimit të çdo shoqërie dhe si pasojë ato nuk mund të jenë statike, por të ndryshueshme me kohën dhe kërkesat e tregut. Modeli ynë i reformimit, fillon nga cikli parashkollor deri tek arsimi i lartë. Prandaj qasja e PDK dhe oferta e saj për qytetarin, bazohen në qasje për adresimin e problemeve dhe transferimin e këtyre problemeve në mundësi reale për përmirësimin e gjendjes në arsim.

#### **Prioritetet e PDK-së për sektorin e arsimit, janë:**

- Rritja e kapaciteteve në edukimin parashkollor
- Adresimi i rangimit në testin e PISA (Arsimi parauniversitar)
- Krijimi i aftësive shtesë nëpërmjet Arsimit alternativ (Shkollave profesionale)
- Fuqizimi i mendjeve kreative, Arsimi i lartë (universitar)
- Edukatori, mësuesi dhe profesori i kualifikuar dhe me dinjitet
- Shkollimi Dual – Industri, Akademi
- STEM (SHTIM)
- Krijimi i një databaze në mes të MPMS, Agjencia e akreditimit, universiteteve dhe MASHT;
- Nxjerrja e ligjit për Agjencinë e Akreditimit të Kosovës dhe ligjin mbi Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve.

## RRITJA E KAPACITETEVE NË EDUKIMIN PARASHKOLLOR

Përfshirja e fëmijëve të moshës 0-6 vjeç në Kosovë në programe arsimore, është shumë më e ulët se në rajon dhe vendet e zhvilluara, pandemia COVID-19, ka pasur efekte edhe më të mëdha në mbarëvajtjen, menaxhimin dhe përfshirjen e këtyre moshave në edukim parashkollor. Regjistrimi në arsimin parashkollor dhe parafillor, në vitet para pandemisë ka qenë në nivelin prej 25-30% ndërsa ka dallime ndërmjet zonave urbane dhe rurale ku në zona rurale përfshirja është shumë e ulët. Në nivelin parashkollor, problemi kryesor është mungesa e infrastrukturës fizike dhe kuadrit mësimdhënës, ndërsa në nivelin parafillor problemi qëndron më shumë në infrastrukturën e mangët.

Përfshirja në aktivitetet parashkollore ka rol vendimtar në performancën më të mirë në fazat tjera të arsimit, meqenëse mosha 0-6 është vendimtare për zhvillimin e fëmijëve pastaj në të gjitha nivelet. Ajo, gjithashtu, ka efekt pozitiv në rritjen e pjesëmarrjes së femrave në tregun e punës, teksa mungesa e institucioneve parashkollore bën që ato të detyrohen të mbeten në shtëpi.



PDK për rritjen e kapaciteteve në edukimin parashkollor do të ndërmarrë këto veprime:

- Përfshirje e obligueshme në arsimin parafillor dhe rritja numrit të regjistrimeve parashkollore;
- Përfshirja e fëmijëve me aftësi të kufizuara në edukim parashkollor;
- Investim infrastrukturor, human dhe programor;
- Sigurimi i lokacioneve për ndërtimin e çerdheve;
- Hapja e një vije buxhetore të veçantë nga qeveria, me dedikim për shpronësimin e lokacioneve për ndërtimin e çerdheve që financohen nga donatorët;
- Ndërtimi i 60 çerdheve në periudhën 4 vjeçare, bashkë me planifikimin e buxhetit për rekrutimin e stafit profesional dhe mbështetës si dhe pajisjet me inventar;
- Licencimi i institucioneve parashkollore private;
- Trajnimi adekuat i edukatorëve para shërbimit dhe gjatë karrierës;
- Rekrutimi i mësuesve – asistentë në shkolla me qëllim që të ndihmohen nxënësit me vështirësi në mësimnxënie.

PDK synon që shumicën e veprimeve të parapara për Arsimin parashkollor, t'i zbatoj duke krijuar një partneritet publiko-privat, me qëllim të uljes së kostos për buxhetin e stërngarkuar shtetëror, ekonominë familjare dhe në anën tjetër, të ndihmojë bizneset në këtë veprimtari.

## PROJEKTI I KUJDESIT PËR FËMIJËRINË E HERSHME

Studime të shumta kanë vënë në dukje rëndësinë që ka arsimi parashkollor për ndërtimin e aftësive kyçe kognitive, emocionale, sociale dhe fizike të njeriut. Njëherazi liron gratë nga obligimi i kujdesit për fëmijët duke ua dhënë mundësinë atyre që të marrin një rol më aktiv në shoqëri dhe ekonomi.

Prandaj, PDK-ja do të ndërmarrë një program kombëtar për zhvillim gjatë fëmijërisë së hershme, i cili do të jetë gjithëpërfshirës dhe i përhapur në çdo pjesë të Kosovës. Ky projekt do të konsistojë në ndërtimin e 300 çerdheve në gjithë vendin në vendbanimet që kanë mbi 1.000 banorë, duke u dhënë përparësi zonave të thella rurale. Rreth 2.000 gra nga këto zona do të aftësohen dhe punësohen për të vënë në punë këto çerdhe.

## ADRESIMI I RANGIMIT NË TESTIN E PISA (ARSIMI PARAUNIVERSITAR)

PDK-ja beson shumë në rolin edukativ të shkollimit parauniversitar dhe do të kujdeset që programet shkollore të arsimit fillor dhe të mesëm, të jenë në linjë me bashkëmoshatarët e tyre në vendet e përparuara. Këtë duhet ta dëshmojnë me arritjet në testin PISA. Ky nivel i arsimit, duhet të përgatisë studentë të ardhshëm, të gatshëm për jetën dhe veprimtarinë e tyre, të jenë kritik ndaj zhvillimeve që i rrethojnë, por edhe të përgatitur për tregun e punës.

Mësuesit duhet t'i japin më shumë përparësi aspektit edukativ e moral të nxënësve. Ne do të përpiqemi që në programet e këtyre niveleve të shkollimit, të ketë më shumë mundësi që individit t'i njohë dhe përqafojë vlerat themelore të shoqërisë sonë, të ketë dashuri për atdheun, ta kuptojë dhe përvetësojë demokracinë, respektin për ligjin, tolerancën, mirësjelljen si dhe ndërgjegjësimin shoqëror.

Për të pasur politikë të suksesshme arsimore, në radhë të parë, duhet vendosur ngritja e dinjitetit dhe autoritetit të punëtorëve arsimor që nuk mund të ndodhë pa përmirësimin e vazhdueshëm të gjendjes materiale të arsimtarëve. Për këtë arsye, PDK, do të angazhohet për t'ua siguruar mësimdhënësve statusin profesional të mbrojtur.

PDK do të investojë në infrastrukturën e fortë dhe të butë që nxënësi dhe mësuesi të kenë vende pune të dinjitetshme që të arrihen rezultatet e dëshirueshme.

### Prioritetet e PDK për Arsimin parauniversitar janë:

- Ridefinimi i përgjegjësiave MASHT, DKA, Shkollë duke dhënë më shumë përgjegjësi tek shkollat;
- Rritja e cilësisë në arsimin parauniversitar;
- Shtrirja e mësimi tërëditor në të gjitha shkollat fillore;
- Rishikimi i teksteve shkollore dhe fuzionimi i tyre;
- Zbatimi i kurrikulës në të gjithë vendin për arritje të mësimnxënies;
- Harmonizimi i teksteve shkollore me tekstet e vendeve të zhvilluara, sidomos në lëndët shkencore;
- Digjitalizimi i përmbajtjeve mësimore bazuar në modelet e reja digjitale të mësimi;
- Funksionalizimi i shkollës digjitale, klasës dhe ditarit digjital;
- Komunikimi obligues (digjital) në mes të prindërve, mësimdhënësve dhe nxënësve;
- Rritja e numrit të mësuesve në ciklin e ulët;
- Pagesa shtesë e kujdestarisë së klasës +5% në raport me pagën bruto;
- Pagesa e kryetarëve të aktivëve të klasave dhe fushave +3% në raport me pagën bruto;
- Nxitja e mësimdhënësve dhe shkollave për punë shtesë me grupe të talentuara dhe me nevoja të veçanta;
- Zhvillimi dhe vlerësimi i vazhdueshëm i mësimdhënësve;
- Përqendrimi te përvetësimi i aftësive të transferueshme dhe shkathtësi praktikë;
- Riorganizimi i testit shtetëror të maturës;
- Orientimi dhe përgatitja në karrierë, në gjysmëvjetorin e dytë të klasës së 9 dhe 12 (talent check);
- Rritja e sigurisë në shkolla dhe parandalimi i dukurive negative;
- Rritja e numrit të stafit përkrahës në shkollë si Psikologë, zyrtarin për orientim në karrierë dhe zyrtari për teknologji.

## ARSIMI PROFESIONAL DHE GJATË GJITHË JETËS

PDK-ja mendon se duhet të ketë më shumë përkushtim dhe mbështetje për arsimin profesional dhe të mësuarin gjatë gjithë jetës. Kjo mundëson një lidhje më të mirë të sistemit arsimor me tregun e punës si dhe mundëson që forca jonë e punës të jetë në hap me kohën për sa i përket ekspertizës dhe kompetencës.

Mospërputhja e nevojave të tregut të punës me njohuritë e fituara në arsimin e rregullt dhe profesional, është identifikuar si një prej pengesave kryesore për rritjen e punësimit dhe zhvillimin ekonomik në vend. Numër i madh i firmave në Kosovë ende ankohen se fuqia punëtore ka shkathtësi të mangëta dhe të papërputhshme me nevojat e tyre. Në anën tjetër, pothuajse të gjithë investitorët e huaj e nënvizojnë cilësinë e fuqisë punëtore si faktor kryesor kur marrin vendime për investime.

Prandaj, PDK-ja do të mundësojë që të hapen shkolla të reja profesionale, të zgjerohet gama e programeve të ofruara në shkollat ekzistuese si dhe të mundësohen programe rifreskuese apo përditësuese për qytetarët që kanë kohë të gjatë që janë shkëputur nga arsimi formal. Po ashtu, përparësi do të kenë prioritetet e mëposhtme:

## ARSIMI UNIVERSITAR

PDK-ja e konsideron rritjen e autonomisë universitare si thelbësore për rritjen e cilësisë së arsimit të lartë, prandaj zotohet që do të bëjë çmos që universitetet të kenë autonomi më të madhe jo vetëm në programet mësimore, por edhe në administrimin e buxhetit, në mënyrë që ata t'i përdorin në mënyrë sa më optimale dhe fleksibile burimet e kufizuara materiale që zotërojnë.

PDK-ja e gjykon, gjithashtu, lirinë akademike dhe frymën e pluralizmit dhe debatit si thelbësore për rritjen e nivelit të botës sonë akademike dhe përpiqet që të eliminojë çdo barrierë apo orvatje që synon ta kufizojë këtë liri dhe të politizojë, instrumentalizojë apo kontrollojë jetën akademike shqiptare.

Nga ana tjetër, PDK-ja konsideron se plagjiatura, kopjimi apo fabrikimi i të dhënave, është një kërcënim i rëndë për jetën akademike në Kosovë, prandaj avokon për një kontroll më të rreptë për sa i përket saktësisë dhe autenticitetit të veprimtarisë akademike si dhe angazhohet për t'i rritur standardet etike dhe profesionale në fushën e arsimit universitar dhe kërkimeve shkencore.

Për arsimin universitar, PDK do të ndërmarrë këto veprime:



**UNIVERSITETI I PRISHTINËS - UNIVERSITY OF PRISHTINA**  
**"HASAN PRISHTINA"**

- Harmonizimi i profileve me nevojat e tregut;
- Të mbështetet Fakulteti i Matematikës, dhe matematika të trajtohet si lëndë deficitare e shkencave ekzakte;
- Të sigurohet platforma antiplagjiaturë për të gjitha nivelet e studimit;
- Ndërtimi i konvikteve në rajonet e mëdha të Kosovës;
- Decentralizimi i buxhetit në fakultete në UP dhe decentralizimi për universitetet në rajone.

## **MASAT E TJERA TË RËNDËSISHME NË FUSHËN E ARSIMIT TË LARTË QË DO TË NDËRMERREN NË MANDATIN E ARDHSHËM, JANË:**

- Ristrukturimi i Institucioneve të Arsimit të Lartë (IAL) publike në universitete dhe universitete të shkencave të aplikuara (profesionale) pas një konsultimi gjithëpërfshirës;
- Krijimi i rangimit shtetëror, gjithëpërfshirës dhe sipas fushës, për të gjitha IAL, publike dhe private;
- Krijimi i skemave nxitëse të mbështetjes financiare të bazuar në performancë për IAL publike;
- Stimulimi IAL, publike dhe private, për hulumtime shkencore;
- Krijimi i skemave nxitëse mbështetëse për digjitalizimin e të gjitha shërbimeve administrative dhe studentore për të gjitha IAL, publike dhe private;
- Krijimi i skemave nxitëse mbështetëse për bashkëpunim me qendra të inovacionit dhe ndërmarrësisë;
- Java e Shkencës të bartet tek universitetet, varësisht nga fusha, dhe punimet shkencore aty, të vlerësohen dhe publikohen sikurse bëhet gjithandej shteteve të zhvilluara;
- Bursa dhe mbështetje për studentët e dalluar për të gjitha IAL, publike dhe private, varësisht nga suksesi i studentit dhe rangimi shtetëror IAL;
- Bursa dhe mbështetje për studentët që studiojnë në fushat: shkencë, teknologji, inxhinieri dhe matematikë.

## **MËSIMI I BAZUAR NË PROJEKTE DHE BASHKËPUNIM, ME VLERËSIM GJITHËPËRFSHIRËS**

### **STUDIME TË INTEGRUARA**

Mësimi i bazuar në projekte e bashkëpunim, është një metodë bashkëkohore shumë e suksesshme për zhvillimin profesional të nxënësit të studentët, ku nxënësit fitojnë shkathtësi dhe dije duke punuar në projekte të cilat zgjidhin probleme të jetës reale, për dallim nga mësimi tradicional i cili çdoherë e më shumë po përkon vetëm me aftësimin e njohurive bazike si shkrim, lexim e matematikë, ndërsa nuk zhvillohet mendimi e shkrimi kritik, menaxhimi i kohës e hulumtimet dhe punimet shkencore. Në këtë formë, nxënësit mësojnë edhe aftësitë e bashkëpunimit e menaxhimit të emocioneve, kështu, ata marrin dije dhe zhvillojnë aftësi që ju duhen tërë jetën. Kjo lidhet direkt edhe me vlerësimin gjithëpërfshirës, pra duke mos u ndalur vetëm tek rezultatet e testit, por, ka synim vënien në pah të pikave të forta të studentëve përmes monitorimit të progresit akademik të tyre.

## SIGURIMI I CILËSISË

Cilësia paraqet, pa dyshim, hallkën më të dobët në zinxhirin e arsimit në Kosovë, e dëshmuar së fundmi edhe me rezultatet e testit PISA dhe radhitjet tjera ndërkombëtare. Do të zhvillohet një sistem funksional për sigurimin e cilësisë në të gjitha nivelet e arsimit, prej parashkollor deri tek arsimi i lartë, në përputhje me standardet ndërkombëtare, ku nxënësi dhe studenti janë në qendër të vëmendjes. Prandaj, për këtë qëllim PDK do të fokusohet që:

1. Secila shkollë do të ketë së paku një koordinator të licencuar për sigurimin e cilësisë të institucionit dhe programit të mësimt;
2. Të gjitha programet e shkollave profesionale dhe gjimnazeve do të jenë të akredituara;
3. Do të jepet mbështetje më e madhe për Autoritetin Kombëtar të Kualifikimeve dhe Agjencinë e Kosovës për Akreditim;
4. Ngritje të transparencës nëpërmjet digjitalizimit të shërbimeve dhe publikimit të vendimeve në internet;
5. Krijim të skemave nxitëse mbështetëse për bashkëpunim me industrinë;
6. Nxitje për më shumë teknologji, në të gjitha fushat dhe në të gjitha shkollat;
7. Harmonizim i profesioneve të rregulluara sipas standardeve të Bashkimit Evropian;
8. Sigurim fizik në shkolla.





## ZHVILLIMI PROFESIONAL I MËSIMDHËNËSVE

Zhvillimi profesional i mësimitdhënësve, i të gjitha niveleve, është parakusht kryesor për sukses në sistemin e arsimit. Freskimi i kornizës ligjore dhe aplikimi i saj për zhvillimin profesional të mësimitdhënësve në këtë fazë, është i domosdoshëm, duke ndërlidhur zhvillimin profesional dhe performancën e tyre me sistemin e gradimit. Licencimi i të gjithë mësimitdhënësve duhet të shtrihet në të gjitha nivelet e arsimit parauniversitar. Prandaj, për këtë qëllim:

1. Do të freskohet Korniza për Zhvillim Profesional të Mësimitdhënësve;
2. Do të bëhet themelimi i institucioneve dhe mbështetja e qendrave për ngritje profesionale;
3. Licencimi i të gjithë mësimitdhënësve në nivel vendi;
4. Trajnimi i obliguar i mësimitdhënësve të rinj;
5. Mbështetje për bashkëpunim me Fakultetin e Edukimit;
6. Digjitalizim të përmbajtjeve mësimore;
7. Zhvillim të shkathtësive digjitale.



Kërkimi shkencor është një ndër themelet kryesore të përgatitjes së burimeve cilësore njerëzore dhe të ndërtimit të një ekonomie të mbështetur në dituri. Kërkimi shkencor është shumë i nevojshëm për procesin mësimor pasi i çon studentët drejt zbulimit dhe kuptimit të mirëfilltë të diturive. Po ashtu, kërkimi shkencor është hapi i parë drejt proceseve inovative e mund të gjejë aplikim të shpejtë në ekonomi duke përmirësuar dhe modernizuar produktet dhe shërbimet.

Praktikat e vendeve të zhvilluara kanë dëshmuar se rezultatet e kërkimeve shkencore në universitete janë shpesh baza e krijimit të kompanive të reja të suksesshme të cilat kanë hapur vende të reja pune dhe kanë zhvilluar ekonominë. Po ashtu, studime të shumta ndërkombëtare shohin një lidhje shkak-pasojë mes sasisë së fondeve të dedikuara për kërkim, zhvillim dhe rritjes ekonomike. Prandaj, ekonomia jonë që të ecë në hap me kohën dhe të mund të zhvillojë sektorë të avancuar të teknologjisë së informacionit apo fushave të tjera të shkencave të aplikuara, PDK-ja në mandatin e ardhshëm do ta shtojë ndjeshëm fondin për kërkimin shkencor.

Hulumtimet shkencore dhe inovacioni janë pjesë e domosdoshme e zhvillimit të stafit akademik në arsimin e lartë dhe paraqesin përkushtimin e shoqërisë për t'i ndjekur trendet botërore të zhvillimit teknologjik. Kosova ende mbetet e fundit krahasuar me vendet e rajonit sa iu përket shpenzimeve për hulumtime shkencore, më pak se 0.1% e Bruto Produktit Vendor (BPV), edhe pse korniza ligjore parasheh deri më 0.7% të BPV-së. Kuptimi dhe fryma e ndërmarrësisë ende nuk është përkrahur si duhet të studentët tanë. Prandaj, për këtë qëllim:

- Do të freskohet Programi Kombëtar i Shkencës në përputhje me trendet botërore;
- Fuqizimi dhe funksionalizimi i zyrës mbështetëse në kuadër të ministrisë për hulumtime shkencore;
- Krijimi i skemave nxitëse për aplikim në projekte dhe publikime shkencore, inovative dhe të ndërmarrësisë;
- Rritja graduale e buxhetit për hulumtime dhe inovacione deri në 1% të BPV-së;
- Digjitalizimi i procesit të aplikimit dhe ndarjes së projekteve shkencore;
- Bashkëpunimi obligues i IAL me qendra inovative dhe ndërmarrësisë.

## BASHKËPUNIMI RAJONAL DHE NDËRKOMBËTAR

Bashkëpunimi rajonal dhe ndërkombëtar, paraqet formën më të mirë për ngritjen e cilësisë së arsimit në të gjitha nivelet. Bashkëpunimi rajonal paraqet hallkën e parë të krahassimit dhe mundësi të mirë të marrjes së praktikave të mira për implementim. Prandaj, për këtë qëllim:

- Vizitat e punës do të bëhen obliguese gjatë zhvillimit profesional të mësimdhënësve;
- Shkëmbimi disajavësh (një semestral) do të bëhet obligues gjatë zhvillimit profesional të stafit akademik;
- Krijimi i skemave nxitëse për bashkëpunim në projekte rajonale dhe ndërkombëtare;
- Pjesëmarrje aktive në vlerësime dhe teste ndërkombëtare të cilësisë;
- Krijim të skemave nxitëse për programe të studimeve në gjuhën angleze dhe gjuhë të tjera të huaja.

## PROGRAMI SHTETËROR I AFTËSIMIT EKONOMIK

Ka një nivel të ulët të përdorimit, kuptimit dhe besimit të sektori financiar dhe qytetarët kanë tendencë paternaliste duke mos marrë përsipër përgjegjësi për vendime apo zgjidhje ekonomike që kanë bërë duke kërkuar gjithçka të shteti. Po ashtu, niveli i planifikimit ekonomik personal lë shumë për të dëshiruar të shumica e qytetarëve. Ndërkaq globalizimi dhe forcimi i sektorit financiar po e bën ekonominë më komplekse dhe më të vështirë për t'u kuptuar.

Prandaj, do të ndërtohet programi shtetëror për t'i pajisur qytetarët e rinj të Kosovës me njohuri bazë për ekonominë, tregtinë, financën dhe menaxhimin e biznesit duke i integruar këto njohuri në programin e detyrueshëm shkollor të arsimit të mesëm dhe të lartë si dhe duke organizuar një fushatë shtetërore disavjeçare. Kjo fushatë, do të synojë që ta sjellë evoluimin e kulturës së ekonomisë në vend, rritjen e mbështetjes së publikut për sistemin e ekonomisë së lirë të tregut dhe thellimin e njohurive të qytetarëve për mënyrën se si funksionon ekonomia moderne sot, si mund të menaxhohen më së miri financat personale dhe si të bëhet nxitja e vetëdijes për përgjegjësitë individuale.

Po ashtu, duke pasur parasysh se ka shumë nxënës të cilët kanë talent dhe ide të ndryshme për biznes, mirëpo ata nuk kanë njohuri se s'i ti aplikojnë këto ide, PDK synon që përmes aktiviteteve e trajnimeve ekstrakurrikulare në shkolla, të fuqizojë sensin e ndërmarrësisë dhe inovacionit të nxënësit.

## FUSHATA “KOSOVA LEXON”

Duke pasur parasysh rëndësinë e leximit për cilësinë e burimeve njerëzore dhe për zhvillimin e shoqërisë, do të ndërmerret një fushatë intensive që do ta synojë masivizimin e leximit në shoqërinë tonë në përgjithësi, të rinia në veçanti. Kjo fushatë do të ketë për qëllim që të ndërtojë shprehi sa më të mira të leximit dhe një konsum masiv të librit në Kosovë dhe do të shoqërohet me një plan veprimi që do t'i prekë të gjitha institucionet që kanë të bëjnë me librin dhe leximin. Kjo fushatë do të synojë të ndikojë në opinion publik në favor të leximit dhe masivizimit të shpërndarjes dhe përdorimit të librit. Njëherazi, do të investohen dy milionë euro në vit për pasurimin e bibliotekave ekzistuese dhe për hapjen e bibliotekave të reja në shkolla dhe zona periferike. Gjithashtu, do të zbatohet heqja e tarifave doganore për importin e librave.



## SHKOLLA E BIZNESIT E PRISHTINËS

Në epokën e sotme të ekonomisë së bazuar mbi dituri, është bërë e nevojshme që Kosova t'i përgatisë brezat e ardhshëm të kuadrove të mirëkualifikuar dhe konkurrues për tregjet ndërkombëtare jo vetëm nëpërmjet bursave, por edhe duke ndërtuar një institucion akademik të veçantë enkas për fushën e biznesit. Këtë gjë e kanë bërë edhe shtete të tjera të vogla të Evropës, duke ndërtuar shkolla të larta biznesi në kryeqendrat e tyre, duke ofruar trajnime për administrim biznesi që krijojnë liderët e ardhshëm të bizneseve dhe jetës financiare të këtyre vendeve.

PDK-ja nëpërmjet programit të bursave dhe bashkëpunimit ndërkombëtar, do të ndërtojë një shkollë të biznesit me një pjesë të programit në anglisht, duke ndjekur modele të ngjashme të vendeve të Evropës Qendrore. Kjo shkollë, do të jetë formalisht e lidhur me Universitetin e Prishtinës, por do të funksionojë me një autonomi të veçantë e një bord ndërkombëtar për ta garantuar maksimumin e cilësisë dhe profesionalizmit. Po ashtu, do të synohet përdorimi i kurrikulave sa më të avancuara perëndimore, mbajtja e nivelit më të lartë të mundshëm të cilësisë dhe arritja e akreditimit dhe rangimit në institucionet më të rëndësishme akademike të fushës.

Që në hapat e parë do të ndërtohet duke u përpjekur të organizojë diploma të dyfishta me institucione të ngjashme prestigjioze dhe duke pasur për qëllim edhe mobilitet sa më të lartë të profesorëve dhe studentëve të saj. Gradualisht, përveç diplomës master në Administrim Biznesi, me të cilën do të duhej të niste, kjo shkollë do ta shtrijë përgatitjen edhe në fusha të tjera si Administrim Publik, Turizëm, Marrëdhënie Ndërkombëtare, Menaxhim Sportiv, Menaxhim Financiar, Tregti Ndërkombëtare, Menaxhim Burimesh Njerëzore, etj.

## PROGRAMI SHTETËROR I BURSAVE

Që ekonomia e Kosovës të zhvillohet në kushtet e sotme të globalizimit, është e nevojshme të rritet sa më shumë cilësia e burimeve njerëzore për t'i bërë ato sa më konkurruese në nivel ndërkombëtar. Prandaj, do të krijohet një program për bursa të kushtëzuara me kthim të detyrueshëm në atdhe, në mënyrë që të transferohet sa më shumë dituri nga institucionet prestigjioze ndërkombëtare të arsimit drejt Kosovës. Fondi për këtë program do të jetë 30 milionë euro, gjatë mandatit të ardhshëm dhe do të administrohet me një bord akademik e profesional të pavarur, ku do të përfshihen edhe figura të shquara të diasporës, shoqërisë civile dhe personalitete ndërkombëtare.

Pjesë e këtij programi do të jetë ndërtimi i një skeme financimi të 30 bursave të përvitshme për studentë të doktoratës për studime në disa nga 200 shkollat më të mira të botës sipas renditjes së Shangait, për ta plotësuar nevojën e universiteteve të reja të Kosovës me staf akademik të kualifikuar mirë.

Skema e financimit me 40 bursa master për fusha e sektorë deficitarë apo prioritar, në 100 shkollat më të mira të botës sipas Shangait. Këtu përfshihen specializime si ICT, planifikim urban, turizëm, siguri etj., ndërsa 100 bursa për sektorin e minierave dhe energjetikës.

Financimi me 5 bursa doktorate për fushën e biznesit në një nga 100 shkollat më të mira të biznesit sipas renditjes së "Financial Times", për ta mundësuar krijimin e stafit vendës të Shkollës së Biznesit të Prishtinës. Skema e financimit të talenteve me 30 bursa për studime universitare në 100 shkollat më të mira të botës për të rinj që shkëlqejnë në moshë të hershme në art, sport dhe shkencë me nga 10 bursa të përvitshme për secilën fushë.

Për më tepër, PDK gjatë mandatit të parë, të gjitha bursat e studentëve nga 700 Euro sa janë dhënë në nëntor/2020 do t'i rris në 1.000 Euro për të gjitha drejtimet e fakultetet e universitetit të Prishtinës "Hasan Prishtina".

## STUDIMET DUALE

Kosova karakterizohet si një ndër vendet me popullsinë më të re, Kosova ka një rini të shëndoshë dhe ka potencial në zhvillimin profesional për të kontribuar në zhvillimin ekonomik të vendit. Mirëpo, për të arritur këto qëllime, duhet një ndryshim radikal në sistemin arsimor. Një ndryshim i menjëhershëm kërkon një bashkëpunim të ngushtë ndërmjet Universiteteve dhe Industrisë në mënyrë që t'i kuptojmë nevojat dhe specifikat e veçanta të tregut të punës. Bazuar në barometrat e punës dhe nevojave të tregut, më poshtë janë të identifikuar fushat në të cilat mund të përfshihen studimet duale: Teknologji Informative, Gjuhë (me theks në gjuhë gjermane dhe angleze), Biznes, Kontabilitet, Marketing Digjital, Dizajn Digjital, Shëndetësi, Ligj, etj. Në përgjithësi, objektivi i programit është një bashkëpunim i fortë ndërmjet universiteteve dhe industrisë, si dhe duke siguruar punësim për të diplomuarit. Studimet duale kanë objektiva shumë të mira për bizneset, sepse sigurojnë të ardhmen e tyre për shkak se kanë qasje në grup të madh të studentëve të cilët mund të jenë punonjës potencial. Bizneset kanë mundësi t'i trajtojnë individët në bazë të nevojave të tyre. Në perspektivën e universiteteve, studimet duale sigurojnë që kurrikula të jetë e dizajnuar në bazë të kërkesave të tregut, institucioni nxit më shumë inovacionin dhe përmirëson perspektivën e kërkimit të aplikuar, institucioni siguron që të ndjekë objektivat arsimore qeveritare. Përfituesit më të mëdhenj të studimeve duale janë studentët të cilët marrin kualifikim dual duke i rritur aftësitë e tyre në fushën e përzgjedhur, studimet duale mbulojnë të gjitha shpenzimet universitare dhe bashkëpunojnë me punëdhënësit potencial të ardhshëm. Nga studimet duale ka benefite edhe qeveria, për shkak që rritë aspektin praktik, ndihmon uljen e papunësisë në përgjithësi dhe rritë punësimin e studentëve të diplomuar.



## RIMËKËMBJE E ADMINISTRATËS

Pandemia Covid-19, anembanë botës ka demonstruar se një administratë publike efektive dhe funksionale është thelbësore në përballjen me sukses me këtë kërcënim. Fatkeqësisht, në Kosovë, pandemia gjithashtu ka treguar dobësinë në sistemin aktual, veçanërisht në lidhje me aftësinë dhe efektivitetin e integritetit të epokës digjitale në administratën publike të Kosovës. Po ashtu, duhet theksuar se dy qeveritë Kurti dhe Hoti jo vetëm që nuk ndërmorën hapa për rritjen e profesionalizmit, integritetit dhe efikasitetit të administratës, por u morën me spastrime politike dhe emërimet nepotike e klienteliste.

Përveç ndikimit të pandemisë Covid-19, viti 2020 ka qenë një periudhë sfiduese për reformat e administratës publike. Vendimi i Gjykatës Kushtetuese për të rrëzuar Ligjin për Pagat në Sektorin Publik si dhe segmente të Ligjit për Zyrtarët Publikë kërkon përgjigje efektive nga qeveria e re për të adresuar shqetësimet e Gjykatës Kushtetuese. Ligji për Zyrtarët Publikë është jetik për meritokracinë e punësimit në sektorin publik, ndërsa Ligji për Pagat në Sektorin Publik është jetik për të siguruar që parimi i pagës së barabartë për punë të barabartë, të respektohet në administratën publike.

PDK-ja çmon lartë rolin e një burokracie moderne, të qëndrueshme e të depolitizuar dhe do të përpiqet që të sigurohet një administratë publike qendrore dhe lokale e cila do të jetë përbërë nga zyrtarë të kualifikuar të cilët të jenë përzgjedhur nga konkurse meritokratike, të cilët karakterizohen nga niveli i lartë i etikës dhe përkushtimit profesional. Prandaj do të vazhdojë t'i kushtojë vëmendje të veçantë përpjekjeve për të ndërtuar një administratë bashkëkohore që zbaton me saktësi ligjin dhe që ofron shërbime cilësore, efikase, të shpejta e transparente për qytetarët dhe sipërmarrësit.

## REFORMA NË ADMINISTRATËN PUBLIKE

Programi i PDK-së, përfshin ndërtimin e një administrate publike profesionale të shkëputur nga politika dhe ndikimi i saj, që funksionon në mënyrë transparente, llogaridhënëse dhe efektive duke u shërbyer interesave të qytetarëve. Po ashtu, vizioni ideologjik i PDK-së si parti konservatore e qendrës së djathtë e ka qeverisjen e vogël si parim thelbësor, prandaj në qeverisjen e ardhshme do ta synojë racionalizimin e administratës, kursimin e buxhetit të taksapaguesve që shkon për administratën, thjeshtëzimin e procedurave dhe zvogëlimin e burokratëve e burokracive të panevojshme.

Me miratimin e Ligjit të ri për zyrtarët publikë - shërbimin civil, është vendosur një standard i ri në administratën publike në Kosovë dhe për funksionalizimin e ligjit synohet:

1. Të funksionalizohet rekrutimi i centralizuar, i paraprirë nga një planifikim i mirëfilltë i personelit sipas kërkesave të institucioneve, i bërë në periudha të caktuara kohore, e jo rast pas rasti siç ishte deri më tani, që ka ndihmuar ndërhyrjet nga jashtë të cilat në të njëjtën kohë kanë qenë të pamenaxhueshme dhe me një kosto të lartë, por edhe joefektive (mesatarja e një procedurë rekrutimi deri në 6 muaj);
2. Të zhvillohen procedura elektronike të aplikimit për kandidatë të interesuar, të testimit, vlerësimit dhe komunikimit të rezultateve;
3. Zhvillim të procedurave testuese përmes një qendre të vetme moderne, të sigursisë së lartë mbështetur edhe nga forca të rendit, të digjitalizuar ku secili kandidat do të ketë një numër unik dhe kompjuter të vetin të vëzhguar nën syrin e kamerave më të sofistikuar;
4. Një proces të rekrutimit të zhvilluar dhe administruar nga një institucion i vetëm nëpërmjet një departamenti të specializuar brenda MAP-it që do ta ndalojë zhvillimin e procedurave nga institucionet e tjera;

5. Një sistem të klasifikimit të pozitive dhe grupeve të familjeve të administrimit të përgjithshëm dhe të veçantë, ku edhe rekrutimet do të bëhen në grupe të caktuara, si: ligjore, financa, prokurim, etj. e jo sipas pozitës e cila redukton në masë të madhe dukurinë e konkurseve të “kurdisura”;
6. Një listë të vetme të kandidatëve fitues të radhitur sipas pikëve maksimale të dëshmuar sipas meritës në procesin e përzgjedhjes të cilët kanë të drejtë ta zgjedhin pozitën dhe institucionin;
7. Administrimi i burimeve njerëzore nëpërmjet sistemit elektronik i cili e bën më efektiv menaxhimin e burimeve njerëzore në nivel shteti;
8. Një qasje tejet të lehtë, me mundësi të bërjes në çdo kohë të ankesave përmes sistemit elektronik për të gjithë ata që mendojnë se u janë shkelur të drejtat e tyre, të komunikueshme edhe për komisionin e ankesave dhe Këshillin e Pavarur Mbikëqyrës për Shërbimin Civil.

## RACIONALIZIMI I AGJENCIVE

Kosova ka një numër të madh të agjencive ekzekutive të cilat ballafaqohen me mbivendosje të kompetencave si ndër vete, po ashtu edhe me ministri të ndryshme. Nuk kanë linja të qarta raportimi dhe tejkalojnë nevojat për personel, etj. Në këtë kontekst, është i nevojshëm racionalizim në mënyrë që të promovohet qeverisja e mirë, të përmirësohet efikasiteti dhe llogaridhënia, etj. Më konkretisht, ndryshimet në organizimin dhe funksionimin e agjencive duhet t’i sjellin përfitimet e mëposhtme:

1. Zbatim më i mirë i qëllimeve strategjike (afatshkurtra ose afatmesme) të Qeverisë, duke zhvilluar një kornizë më koherente institucionale, duke i bërë agjencitë më përgjegjëse për arritjen e objektivave të Qeverisë;
2. Arritje e efikasitetit për funksionimin e institucioneve dhe agjencive si dhe kursime për buxhetin e shtetit nëpërmjet ndryshimeve organizative;
3. Përmirësim të llogaridhënies së këtyre organeve të publiku i gjerë dhe palët e caktuara, duke bërë publike planet e punës vjetore dhe raportet e performancës.

Po ky proces është shumë i ndërlidhur me funksionalizimin e ligjeve mbi organizimin e administratës shtetërore dhe agjencive të pavarura, zyrtarët publikë dhe pagat. Së bashku, këto procese, do të sigurojnë një sqarim të nevojshëm të statusit të punëtorëve në organe të ndryshme publike, duke përfshirë procedurat e rekrutimit, shkarkimet, pagat, etj. Ndërkaq, të gjitha organet që raportojnë në Kuvend, do të shqyrtohen nga Sekretariati për të vlerësuar nëse linjat e raportimit janë optimale. Për agjencitë që aktualisht raportojnë në Qeveri, fushëveprimi i reformës është i kufizuar në institucionet me më pak se 50 punonjës. Organet kushtetuese, të quajtura institucione të pavarura në Kapitullin XII të Kushtetutës, janë, gjithashtu, jashtë fushës së reformës. Vendimet individuale do të varen nga një rishikim funksional, duke marrë parasysh detyrat dhe përgjegjësitë dhe nivelin e nevojshëm të autonomisë, gjithmonë duke synuar arritjen e sa më shumë objektivave.

## ANGAZHIM QYTETAR NË QEVERISJE NËPËRMJET TË DHËNAVE TË HAPURA - OPEN DATA

Të dhënat e hapura, janë me rëndësi thelbësore për inovacion dhe zgjidhje kreative për sfidat më urgjente të shoqërisë sonë siç janë korrupsioni dhe zhvillimi ekonomik. Të dhënat e hapura fuqizojnë qeverisjen dhe funksionimin demokratik të institucioneve publike.

Iniciativa e të dhënave të hapura ofron një potencial të jashtëzakonshëm, pasi që do të shpie në ide të reja dhe inovacion, në të mirë të të gjithëve. Duke hapur të dhënat qeveritare, ne hapim një rezervuar të informatave dhe dijes e cila krijon një mjedis lehtësues për të gjithë në Kosovë dhe ofron një platformë për nisma të përbashkëta me qytetarë, për t'i njohur më mirë sfidat e zhvillimit kombëtar si dhe për të zhvilluar intervenime dhe politika për t'i shtjelluar këto në mënyrë të duhur.

Të dhënat e hapura, publikohen me qëllim të përmirësimit të qeverisjes dhe angazhimit qytetar në qeverisje.

Qeveria e ardhshme, duhet të sigurojë një bashkëpunim më të madh midis komunitetit të TIK-ut në Kosovë dhe qeverisë, për të siguruar një numër më të madh të të dhënave që publikohen nga ministritë. Qëllimi duhet të jetë krijimi i një kulture që mbështet hapjen pro-aktive të të dhënave në portalet qeveritare. Qeveria, gjithashtu, duhet të mbështesë komunitetin e TIK-ut dhe shoqërinë civile për të përdorur të dhënat e hapura duke mbështetur sfida për projektet dhe iniciativat se si t'i përdorin të dhënat.

## **QEVERISJE ELEKTRONIKE (E-QEVERISJA)**





Qeverisje elektronike (e-Qeverisja) dhe digjitalizimi i administratës dhe shërbimeve, do të luajë rol primar për transformimin e jetesës së qytetarëve, për rritjen e transparencës, për reduktimin e procedurave burokratike, për shmangien e korrupsionit dhe për gjithëpërfshirjen e qytetarëve në vendimmarrje, për uljen e shpenzimeve për qytetarët dhe administratën si dhe për shkurtrimin e kohës për ofrimin e këtyre shërbimeve.

1. Digjitalizimi i shërbimeve për qytetarët dhe bizneset, duke i dhënë rëndësi qeverisjes elektronike (e-Qeverisjes), avancoon ofrimin e shërbimeve, rrit transparencën, forcon llogaridhënien dhe luftën kundër korrupsionit.
2. Krijimi i portalit shtetëror të shërbimeve elektronike, si një dritare unike për qasje online në shërbimet për qytetarët, bizneset dhe administratën;

Përmes qeverisjes elektronike do të rriten përfitimet ekonomike dhe sociale në të gjitha fushat përkatëse, duke përfshirë modernizimin e administratës, zhvillimin e biznesit, inovacionin dhe arsimin, sigurinë, shëndetësinë, drejtësinë, tregtinë, bujqësinë, buxhetin, avancimin e demokracisë dhe integrimin në organizmat ndërkombëtare të e-Qeverisjes.

## **DERREGULLIMI SI MASË PARANDALUESE E KORRUPSIONIT**

Një përparësi thelbësore për reformën e administratës publike duhet të jetë harmonizimi i kuadrit ligjor që kanë krijuar procedura administrative me Ligjin për Procedurat e Përgjithshme Administrative, në mënyrë që të zvogëlohet burokracia dhe të përmirësojë drejtësinë administrative për qytetarët. Në këtë kuptim, është gjithashtu thelbësore që qeveria e ardhshme të rishikoj qasjen aktuale karshi drejtësisë administrative për qytetarët dhe komunitetin e biznesit. Kjo do të kërkojë rishikimin e Ligjit për Konfliktet Administrative.

Eliminimin e shumë certifikatave, autorizimeve, lejeve të ndryshme, si dhe shumë barrierave administrative, duke i zvogëluar vetëm ato të cilat janë të domosdoshme dhe që nuk kanë asnjë kosto (shpenzim), për krijimin e bizneseve të reja dhe për zgjerimin e atyre ekzistuese. Të gjitha licencat, do të lëshohen përmes një sistemi elektronik, pa pasur nevojë që pala të paraqitet fizikisht pranë sporteleve të ndryshme në administratën e shtetit. Nëpërmjet këtyre masave do të kontribuojmë për dekurajimin e informalitetit, zvogëlimin e korrupsionit si dhe për rritjen e efikasitetit të bizneseve;

3. Thjeshtëzimi dhe eliminimi i procedurave administrative të panevojshme;
4. Harmonizimi i procedurave të veçanta administrative me ligjin për procedurat e përgjithshme administrative si garanci për një mbrojtje më të mirë të të drejtave dhe interesave të ligjshme të qytetarëve dhe bizneseve;
5. Përforcimi i parimit të hetimit administrativ që nënkupton se organet publike për realizimin e të drejtave të palëve kërkojnë nga to vetëm ato dokumente të cilat nuk i ka asnjëri organ publik;
6. Përmirësimi i ofrimit të shërbimeve administrative nëpërmjet zgjidhjeve që ofron teknologjia informativë;
7. Reduktimi i lejeve dhe licencave duke lënë në fuqi vetëm ato të cilat janë të domosdoshme për mbrojtjen e interesit publik;
8. Jetësimi i parimit për ofrimin e shërbimeve administrative pa pagesë;
9. Reforma në reduktimin e inspektimeve duke lënë në fuqi vetëm ato lloje të inspektimeve të cilat janë të nevojshme për mbrojtjen e interesit publik, të planifikuara paraprakisht dhe të bazuara në risk.

Pra, synimi ynë kryesor është komunikimi dhe transparenca me qytetarët. Pa dyshim se zbatimi i këtyre masave, do të jetë synimi kryesor për një administratë të pavarur efikase dhe sa më afër qytetarëve.

Po ashtu, do të thjeshtëzohen procedurat, eliminohen paqartësitë dhe mbivendosjet, në mënyrë që zyrtarët të mos kenë hapësira apo mundësi për t'i shantazhuar qytetarët në këmbim të rryshfeteve apo për të marrë vendime selektive që favorizojnë aktorë të caktuar.

## PAJISJA ME CERTIFIKATA

Në këtë kohë të zhvillimit të teknologjisë dhe digjitalizimit të proceseve, është e pakuptimtë që qytetarët të humbin kohë të pajisen me certifikata të ndryshme të gjendjes civile. Është, po ashtu e panevojshme që institucionet e Qeverisë së Kosovës t'u kërkojnë qytetarëve certifikata të cilat lëshohen nga vetë institucioni i saj. I gjithë procesi do të digjitalizohet dhe institucionet publike e qeveritare do të ndërlidhen në mes vete. Kjo do t'i largojë mundësitë për keqpërdorime dhe korrupsion, ndërsa shpenzimeve dhe pritjeve të qytetarëve në sportele për certifikata do t'u vijë fundi.

## RIMËKËMBJE E NDËRMARRJEVE PUBLIKE



## RIMËKËMBJE E BUJQËSISË, BUJQËSIA DHE ZHVILLIMI RURAL

Qeveria jonë e konsideron bujqësinë si një degë mjaft të rëndësishme për ekonominë e Kosovës dhe do ta trajtojë atë dhe zhvillimin e saj me vëmendje të veçantë. Kjo do të bëhet për arsye se zhvillimi i këtij sektori do të ketë ndikim të shumëfishtë: do ta rrisë prodhimin e ushqimit dhe gjenerimin e të hyrave për familjet rurale dhe buxhetin shtetëror, do ta zvogëlojë papunësinë, do ta ngrit standardin jetësor dhe mirëqenien e qytetarëve, do të zbusë varfërinë në zonat rurale dhe më pak të zhvilluara të vendit, si dhe do të sigurojë një Kosovë më ekologjike për qytetarët dhe gjeneratat e ardhshme. Gjithashtu, nëpërmjet zhvillimit të bujqësisë do të sigurohen lëndë të para për industrinë agropërpunuese, do të bëhet zëvendësimi i produkteve të importuara me produkte vendore, do të shtohet vëllimi i eksporteve dhe do të zvogëlohet deficitit tregtar l vendit.



Për t'i arritur këto synime, do t'i ndërmarrim këto masa:

- Hartimin e dokumenteve strategjike dhe të politikave adekuate të sektorit të bujqësisë dhe zhvillimit rural, ku do të përcaktohen prioritetet e sektorit dhe do të sigurohet mbështetja e duhur buxhetore dhe financiare. Do të angazhohemi që me politika, veprime dhe masa të veçanta ta rrisim produktivitetin në prodhimtarinë bujqësore;
- Do ta bartim Agjencinë e Ushqimit dhe të Veterinës në kuadër të Ministrisë së Bujqësisë dhe kjo do të bëhet për shkak të ndërlidhjes funksionale të saj me pjesët tjera institucionale të sektorit dhe Ministrisë;
- Do t'i fuqizojmë shërbimet e këshillimeve profesionale për fermerët, me qëllim që ata t'i zbatojnë në praktikë masat agroteknike dhe të arriturat e fundit të shkencës dhe teknologjisë në këtë sektor, si dhe duke zbatuar diversifikimin rural dhe shfrytëzuar mundësitë e tij për rritjen e punësimit;
- Ne kemi planifikuar, gjithashtu, ndërtimin e 500 kilometrave rrugë rurale të asfaltuara që do t'i lidhin zonat rurale me rrugët kryesore dhe qendrat urbane, për t'iu siguruar qasje më të mirë te lënda e parë dhe te tregjet e shitjeve. Për më tepër, brenda mandatit do të mbulojmë me ujitje 50% të totalit të tokës së punueshme.

## KONSOLIDIMI DHE KOMASACIONI I TOKËS BUJQËSORE

PDK-ja konsideron se fragmentimi i madh i tokës bujqësore, përkatësisht sipërfaqja e ulët mesatare e parcelave bujqësore e bën shumë të vështirë dhe thuajse të pamundur zhvillimin e bujqësisë intensive dhe aplikimin e teknikave dhe teknologjive të avancuara. Prandaj, do të konsolidohen tokat bujqësore, duke përfshirë edhe komasacionin e tyre, që do të shërbejë si stimulim për grumbullimin e tokës dhe krijimin e fermave të mëdha intensive.

## KRIJIMI I SISTEMIT TË SIGURIMIT TË PRODHIMTARISË BUJQËSORE

Do ta themelojmë një sistem për sigurimin e prodhimtarisë bujqësore bazuar në praktikat e shteteve të zhvilluara. Përmes krijimit dhe funksionimit të tij, do të kemi rritje substanciale të prodhimit në tërë sektorin e bujqësisë, pastaj rritje të produktivitetit dhe rentabilitetit, përmirësim të qasjes së fermerëve në financa, në të njëjtën kohë edhe rritje të prodhimit, rrjedhimisht edhe të standardit jetësor dhe mirëqenies së tyre. Me qëllim të stimulimit të zbatimit të këtij sistemi dhe përdorimit të tij nga fermerët, do të fillohet subvencionimi i një pjese të kostos së polisave të sigurimit.

## INVESTIMET NË PËRMIRËSIMIN E INFRASTRUKTURËS BUJQËSORE

Do të bëjmë investime në infrastrukturën bujqësore, në veçanti investime të reja për ngritjen dhe përmirësimin e sistemit të ujitjes dhe të kullimit. Po ashtu, nëpërmjet partneritetit publik privat dhe formave të tjera të financimit do të ndërtohen qendra të grumbullimit dhe të distribuimit të produkteve bujqësore, të bimëve mjekësore, frutave pyjore, etj. Do të investojmë edhe në rritjen e numrit të frigoriferëve dhe të depove për ruajtjen afatgjatë të frutave dhe të perimeve, si dhe për ndërtimin e kapaciteteve të grumbullimit, konservimit, paketimit dhe marketingut të produkteve bujqësore.

- Do të investojmë në sistemin e ujitjes duke investuar në ujëmbledhës dhe kanalizime për të bërë të mundur që brenda një mandati së paku gjysma e tokave të punueshme të kenë mundësi që të ujitjen.
- Do të rritet numri i njësive të testimit laboratorik për cilësinë e prodhimit privat të farërave dhe përmirësimi i standardeve fitosanitare.

## RRITJA E MBËSHTETJES FINANCIARE PËR BUJQËSINË

Për ta shtuar zhvillimin e bujqësisë dhe zhvillimin rural, PDK-ja, zotohet se do të punojë për të tërhequr investime, për të ndihmuar me financime, subvencionime dhe kreditime me kushte të volitshme, në mënyrë që të shtohet prodhimtaria primare, të rritet numri i fermave, i prodhimit në ambient të mbyllur (në serra) dhe në të gjithë nën sektorët e tjerë në të cilët vendi ynë ka përparësi krahasuese në prodhim.

- Një vëmendje e veçantë do t'i kushtohet ndërlidhjes së punës shkencore, kërkimeve dhe hulumtimeve në institute dhe ente profesionale, që nëpërmjet shërbimeve të këshillimit dhe të ekstensionit, të barten dija dhe njohuritë të fermerët nëpërmjet zbatimit të teknikave dhe teknologjive të reja në prodhimitin bujqësor.
- 
- Do ta trajtojmë me prioritet mbështetjen dhe stimulimin e sektorëve me potencial të madh zhvillimi si, p. sh.: pemëtarinë, vreshtarinë, prodhimin e perimeve, blegtorinë, etj.
- 
- Do ta rrisim buxhetin për sektorin e bujqësisë dhe të zhvillimit rural, duke përfshirë këtu edhe kategoritë e mbështetjes së drejtpërdrejtë nëpërmjet granteve dhe subvencioneve. Me qëllim të rritjes së efektivitetit dhe efikasitetit të tyre do të rritet mbikëqyrja e realizimit të granteve dhe subvencioneve nga institucionet, duke përcaktuar kritere të qarta të vlerësimit të projekteve. Në këtë drejtim fillimisht do të bëhet përcaktimi i prioritetëve të nën sektorëve, kulturave bujqësore dhe produkteve të mbështetura dhe kjo veprimtari, do të ndërlidhet me sasinë dhe cilësinë e produkteve të dorëzuara të fermerëve në industrinë përpunuese;
- 
- Do të fillohet, po ashtu, me programin e subvencionimit të kamatave të interesit deri në 50% të kredive për fermerët dhe përpunuesit në sektorin e prodhimit primare dhe të agropërpunimit;
- 
- Do ta mbështesim zhvillimin e blegtorisë përmes masave të posaçme dhe politikave bujqësore, me qëllim që të rritet prodhimi i produkteve blegtorale si mishi, qumështi e produkte të tjera, posaçërisht përpunimi industrial i tyre. Në këtë drejtim, do të mbështeten sidomos zonat malore kufitare të cilat janë të përshtatshme për kultivimin e dhenve dhe të kafshëve të tjera të imta.

## KONSERVIMI I TRADITËS



Partia Demokratike e Kosovës, si parti konservatore i kushton shumë rëndësi konservimit të traditës së lashtë të popullit tonë në bujqësi dhe blegtori. Për këtë arsye, do ta subvencionojë ruajtjen dhe vazhdimin e kësaj tradite, duke subvencionuar kulturat tradicionale vendëse, mbarështimin e bagëtive tradicionale të zonës si dhe produktet e ndryshme tradicionale artizanale kosovare.

## ZHVILLIMI I BALANCUAR RAJONAL

PDK-ja ka për qëllim që të gjithë qytetarët të përfitojnë nga zhvillimi ekonomik i vendit, të trajtohen në mënyrë të barabartë e të kenë qasje të njëjtë në shërbimet publike. Prandaj, do të ketë vëmendje të veçantë ndaj zonave periferike rurale dhe do të marrë masa konkrete që të garantojë mirëqenie dhe cilësi jete edhe në këto zona, si më poshtë:

- Do të hartohet programi i veçantë për rigjallërimin e zonave të caktuara në rajonet e Kosovës;
- Do të ketë mbështetje të veçantë përmes mundësisë për të siguruar hapësirë tokësore nga shteti për bizneset që investojnë në zonat më pak të zhvilluara të Kosovës;
- Do të bëhet subvencionim i pagave të të punësuarave, deri në 50% për vitin e parë për të punësuarit e rinj në fillimin e bizneseve kur investohet në zonat më pak të zhvilluara të Kosovës;
- Do të ofrohet infrastruktura përcjellëse për bizneset që investojnë në zonat më pak të zhvilluara të Kosovës, të caktuara sipas programit qeveritar;
- Do të shtohen aktivitetet që promovojnë turizmin në zonat periferike;
- Do të ketë përfshirje të fermave familjare në prodhimin e produkteve ushqimore me vlerë të lartë, apo të produkteve “bio”.

## ORIENTIMI DREJT PRODHIMTARISË ALTERNATIVE

Qeveria jonë do t'i mbështesë kërkimet shkencore dhe analizat e tregut që do ta hulumtojnë potencialin e kultivimit në Kosovë të kulturave të reja që nuk janë tradicionale, si: hortikultura dhe bimët industriale që shërbejnë për farmaceutikë apo kozmetikë; fruta apo perime që nuk janë kultivuar më parë, por që janë të përshtatshme për klimën dhe tokën si, për shembull, kivi, shpargulli, etj.; ferma të kulturave të reja që po tregohen të suksesshme në vendet fqinje, etj.

Do ta mbështesim fuqimisht edhe bletarinë, pasi kemi potenciale për rritjen e prodhimit. Po ashtu, do t'u kushtohet vëmendje e madhe edhe kulturave jo tradicionale të cilat kanë potencial të madh eksporti siç është kultivimi i bimëve etero-vajore, etj.





## PYLLTARIA

Pyjet janë resurs shumë i rëndësishëm kombëtar i vendit tonë, prandaj PDK, do t'i kushtojë vëmendje të posaçme zhvillimit të pylltarisë dhe, në këtë kuadër, edhe industrisë përpunuese të drurit. Kosova është e pasur me pyje, me biodiversitet dhe lloje të ndryshme të drurëve. Do t'i kushtojmë vëmendje të veçantë mbrojtjes së pyjeve nga dëmtimet dhe prerjet e pakontrolluara, duke zhvilluar një menaxhim modern të tyre.

## FUSHATA E PYLLËZIMIT

Do të zhvillojmë programe të veçanta të pyllëzimit të sipërfaqeve të reja, por edhe të ripyllëzimit të pyjeve të dëmtuara. Për këtë qëllim do të ndërmerret fushatë kombëtare e pyllëzimit. Kjo fushatë do të ndërmerret për qëllime të shumfishta, si: për ta nxitur industrinë vendëse të përpunimit të drurit, për t'i mbrojtur tokat nga degradimi i erozionit, për ta mbrojtur mjedisin dhe rritur biomasën që do ta rrisë cilësinë e ajrit, për ta inkurajuar turizmin natyror si dhe për të mundësuar punësim sezonal për mijëra të rinj. Fushata do të konsistojë në mbjelljen e 500 mijë fidanëve të rinj çdo vit, për të arritur dy milionë në fund të mandatit qeverisës të PDK-së.

Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet edhe sektorit të produkteve jo drusore nga pyjet, si dhe mbështetjes së bizneseve që merren me këtë veprimtari, pasi kjo fushëveprimtari është një mundësi shumë e mirë për eksporte të prodhimeve të kësaj natyre.

Do ta shtojmë mbështetjen buxhetore-financiare për ruajtjen dhe menaxhimin e pyjeve.

Prioritet yni do të jetë hartimi dhe miratimi i shpejtë i projektligjit të ri për pyjet, nëpërmjet të cilit do të rregullohet menaxhimi dhe administrimi i pyjeve dhe tokave pyjore shtetërore, por edhe atyre private. Nëpërmjet këtij menaxhimi, përgjegjësia për shfrytëzimin dhe mbrojtjen e pyjeve do të bartet nga niveli qeverisjes komunale në të cilin është tash, në nivelin qendror, ashtu siç është praktikë në të gjitha shtetet e zhvilluara.

## RIMËKËMBJE E SEKTORIT TË ENERGJISË

Sektori i energjisë është dëmtuar si pasojë e keq-qeverisjes dhe papërgjegjshmërisë së dy qeverive të fundit. Kryeministrat Kurti dhe Hoti ishin më shumë të shqetësuar që të bënin punësime partiake e siguronin përfitime prej këtij sektori, sesa që të siguronin mirëfunksionimin e këtij sektori në shërbim të qytetarëve dhe ekonomisë si dhe përmbushjen e nevojave që kanë qytetarët e shumë që punojnë në këtë sektor. Këtë mungesë përgjegjësie dhe neglizhencë të lartë, e dëshmon më së miri fakti që për herë të parë, pas më shumë se një dekade, janë duke u rishfaqur kufizimet e shpeshta të furnizimit me rrymë.





PDK-ja e konsideron këtë sektor prioritar për zhvillimin e vendit dhe rritjen ekonomike të Kosovës dhe do të japë maksimumin që të shfrytëzohet me sukses potenciali i jashtëzakonshëm që ka ky sektor për vendin. Prandaj, PDK-ja angazhohet që sektori i energjisë të zhvillohet në bazë të kornizës strategjike, programore dhe ligjore, sipas obligimeve që dalin nga Traktati i Komunitetit të Energjisë dhe nga procesi i integritimit në Bashkimin Evropian. Shtyllat kryesore që PDK-ja ka përcaktuar për zhvillimin e këtij sektori, janë si vijon:

Sigurimi i furnizimit të qëndrueshëm dhe cilësor me energji elektrike dhe me kapacitete të nevojshme për një sistem stabil të energjisë elektrike;

Siguria e furnizimit me energji elektrike bazohet në energjinë e gjeneruar me bazë të thëngjillit (mesatarisht prodhimi vjetor prej tetë milionë tonësh) nga dy termocentralet: TC Kosova A dhe TC Kosova B. Për ta përmbushur furnizimin e qëndrueshëm të Kosovës, PDK-ja parashikon hapat në vazhdim:

- a) TC Kosova e Re: pritet të ndërtohet me një kapacitet rreth 450 MW Do të implementohet në konceptim BOT (Build, Operate and Transfer).
- b) TC Kosova B, do të vazhdohet me implementimin e masave të ambientit me synim që nga 1 janar i 2028-s do të performojë në bazë të standardeve të derivuara nga direktivat LCP (Large Combustion Plan) dhe IED (Industria Emission Direktive).
- c) TC Kosova A pritet të mbyllet dhe dekomisionohet në vitin 2023, kurdo që hyjnë kapacitetet e reja të TC Kosova e Re. E tëra kjo për shkak të teknologjive të vjetra dhe impaktit të lartë në ambient si rezultat i emisioneve të gazrave.

## INTEGRIMI NË TREGUN RAJONAL TË ENERGJISË

Tregu i energjisë do të vazhdojë të liberalizohet duke synuar përfitimet për qytetarët e vendit dhe bizneset në kuptim të çmimit dhe cilësisë. Për këtë arsye, është parashikuar që të bëhet:

- d) Përafrimi i legjislacionit të Kosovës me legjislacionin e BE-së për tregun e energjisë;
  - e) Forcimi i mëtejme i kapaciteteve të Rregullatorit, Autoritetit të Konkurrencës dhe Zyrës së Ndihmës Shtetërore për ta monitoruar tregun e liberalizuar të energjisë - aktivitet permanent;
  - f) Hapja e tregut për konsumatorët e mëdhenj 220 dhe 110 kw, pra kompanitë si “Trepça”, “Sharr Cem”-i apo “Ferronikel”-i do të mund ta blejnë energjinë në treg dhe jo të jetë e rregulluar siç janë aktualisht konsumatorët 35 kw e deri në 0.4 kw. Do të duhet të hapet tregu edhe për konsumatorët tjerë si për kategorinë 35 kw deri në 0.4 kw, në mënyrë që të kemi konkurrencë dhe çmimet të përcaktohen nga tregu i energjisë;
  - g) Liberalizimi i tregut nëpërmjet hyrjes në treg të operatorëve të rinj. Të kërkohet nga kompanitë që kanë marrë licenca për furnizim me energji elektrike të fillojnë të operojnë sa më parë, në mënyrë që të kemi shërbime më të mira dhe konsumatorët ta kenë mundësinë që vetë ta përzgjedhin operatorin për furnizim me energji elektrike;
  - h) Anëtarësimi i KOSTT në ENSTO-E është parakusht për funksionimin e bursës energjetike me Shqipërinë, komisionin e linjës 400 kw si dhe integrimin e sektorit të energjisë elektrike të Kosovës në tregun rajonal dhe gjithë evropian.
- Rritja e kapaciteteve ekzistuese të sistemeve termike dhe ndërtimi i kapaciteteve të reja. Aktualisht sektori i energjisë termike bazohet kryesisht në operimin e dy ngrohtoreve:
- l) Ngrohtoren e Prishtinës - “Termokos”, e cila ka ndryshuar burimin e energjisë nga mazuti në avull dhe aktualisht furnizohet me avull nga TC Kosova B; si dhe
  - j) Ngrohtoren e Gjakovës, e cila është në procesin e ndryshimit të teknologjisë nga mazuti në burime të ripërtëritshme të energjisë - biomasës.

PDK-ja synon që këtë shërbim ta shtrijë edhe në qytetet tjera, duke mundësuar ngrohje me çmim të ulët, njëherësh përkujdesje për ambientin dhe shëndetin e qytetarëve. Prandaj, do të ndërmarrë studime fizibiliteti për ta vlerësuar mundësinë e ndërtimit të ngrohtoreve në qytetet si në vijim: Prizren, Pejë, Gjilan, Ferizaj, Mitrovicë, Kastriot dhe Drenas, etj. Në varësi të këtij studimi, do të procedohet më tutje në zgjerim të rrjeteve të reja.

## GAZIFIKIMI I KOSOVËS

Kosova aktualisht nuk ka infrastrukturë të gazit, mirëpo me ndërtimin e TAP-it në rajonin tonë, është e mundur që në një të ardhme të afërt të sigurohet qasje. Për këtë arsye, PDK-ja parashikon që në mandatin e ardhshëm, të ndërmarrë dy studime fizibiliteti e të përzgjedhë më të favorshmin. Së pari, ka për ta ndërmarrë studimin e fizibilitetit për zhvillimin e sistemit të gazit në Kosovë, ku do të analizohen mundësitë e konektimit përmes Shqipërisë, në pjesën veriore të Shqipërisë. Po ashtu, do të bëhet e njëjta gjë për t'i analizuar mundësitë e konektimit edhe përmes Maqedonisë duke marrë në konsideratë që tashmë një trase është aktuale për këtë konektim.

## PLOTËSIMI I CAQEVE DHE OBLIGIMEVE NË EFIÇIENCË TË ENERGISË, BURIME TË RIPËRTËRITSHME TË ENERGISË DHE MBROJTJE TË MJEDISIT

Gjendja aktuale e eficiencës së energjisë, lë për të dëshiruar, prandaj, PDK-ja ka një plan për ta adresuar këtë problem. Deri më tani, sipas raporteve të komunitetit të energjisë, Kosova nuk e ka arritur cakun dhe kërkohet të bëhet më shumë në terma të implementimit të masave të EE, detyrë kjo e Agjencisë së Kosovës për EE-AKEE. Fondi për EE është krijuar, por nuk është funksional, edhe pse në portofolin e tij, tashmë janë zotuar mjete nga BRK - 1 milion euro, KE- 10 milionë euro dhe, gjithashtu, ka edhe një kontribut financiar nga Banka Botërore.

Prandaj, PDK-ja ka parashikuar këto masa, për këtë çështje:

- k) Kursimi i energjisë në masën prej 30-32 % përmes implementimit të masave të ndryshme të eficiencës në të gjithë sektorët (që gjithsejtë janë pesë: amvisëri, shërbime, transport, bujqësi dhe industri);
- l) Funksionalizimi i one stop shop-eve për t'i përkrahur investitorët për lehtësimin e procedurave për investime në funksion të mbështetjes së investimeve në fushën e BRE-së;
- m) Funksionalizimi i fondit për eficiencë të energjisë, duke mundësuar disbursimin e mjeteve financiare për bizneset dhe amvisëritë.

Për sa iu përket burimeve të ripërtëritshme të energjisë (BRE), caku i Kosovës është prej 25% i obligueshëm (i dëshirueshëm prej 29.89%) dhe i cili do të duhet të arrihet deri në vitin 2020. Aktualisht, caku është arritur rreth 24.6%, ndërsa në fushën e BRE-së, te pjesa e dedikuar për energjinë elektrike, kemi këto kapacitete të implementuara:

- n) Kapacitetet hidrike - 99.056 Mw
- o) Kapacitetet solare - 7.02 Mw
- p) Kapacitetet me energjinë e erës - 33.75 Mw.

Gjithashtu, në fazën e marrjes së autorizimit janë edhe kapacitetet në vijim:

- q) Kapacitetet hidrike - 74.54 Mw
- r) Kapacitetet solare - 105 Mw
- s) Kapacitetet në energjinë e erës - 349.55 Mw.

Për t'i përmbushur caqet e paracaktuara, PDK-ja planifikon masat e mëtejshme:

f) Përcaktojmë cakun për prodhimin e energjisë së gjeneruar nga burimet e ripërtëritshme rreth 35% për periudhën 2020-2030;

u) Funkcionalizimi i one stop shop-it për BRE;

v) Hartimi i politikave mbështetëse fiskale për investitorët në fushën e BRE-së, përmes lirimeve të mëtejme të tatimeve për teknologjitë, zhvendosjen e TVSh-së nga importi në prodhim, krijimin e linjave kreditore për investime etj.;

w) Skemat mbështetëse do të jenë në linjë me përvojat më të mira evropiane siç janë skema premium, skema e ankandit, etj.

Në fushën e mbrojtjes së mjedisit nga ndotja industriale e ajrit, PDK-ja ka parashikuar masa konkrete në TC Kosova B dhe njësitë përkatëse. Koncretisht, është parashikuar që të përkrahen masat ambientale në kuadër të TC Kosova B deri në vitin 2027, sipas rekomandimit të studimit të bërë, vlera totale për financim sillet rreth 350 milionë euro. Po ashtu, synohet dekarbonizimi i sektorit të energjisë, për periudhën 2030 e tutje.

## RIMËKËMBJE E SEKTORIT TË MINIERAVE

Pasuria natyrore nëntokësore e Kosovës është e jashtëzakonshme dhe përbën një potencial shumë të madh për të rritur ekonominë e vendit dhe për të përmirësuar jetën e qytetarëve. Sektori i minierave në Kosovë, nuk është në nivelin ku do të mund të ishte e madje nuk është bërë mjaftueshëm për të mbajtur në funksion të plotë industrinë ekzistuese. Prandaj, është bërë një domosdoshmëri që të rimëkëmbet, modernizohet dhe zgjerohet kjo industri, duke marrë më shumë vëmendje nga qeverisja e ardhshme.



PDK-ja, do të angazhohet të revitalizojë sektorin minerar duke tërhequr investitorë të huaj seriozë nëpërmjet partneritetit publiko-privat, në mënyrë që këto burime natyrore të vihen në funksion të rritjes ekonomike, hapjes së vendeve të reja të punës dhe rritjes së mirëqenies së qytetarëve të Kosovës.

Sektori minerar i Republikës së Kosovës, zhvillohet bazuar në dokumentet strategjike dhe kornizën ligjore të hartuar në përputhje me direktivat e BE-së dhe standardeve ndërkombëtare për sektorin minerar, në mënyrë që të sigurohen hulumtimi, shfrytëzimi, pasurimi, administrimi dhe mbrojtja e vlerave ekonomike të mineraleve të dobishme në shërbim të zhvillimit të vendit duke respektuar kërkesat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e komuniteteve (subjekteve që operojnë në sektorin minerar), të ndikuara nga aktivitetet minerare. Prioritetet kryesore janë:

## REVITALIZIMI I TREPÇËS

Tashmë është miratuar Statuti për “Trepça Sh. A.” dhe është regjistruar “Trepça Sh. A.” Hapat e mëtejshëm për revitalizimin e plotë të Trepçës, janë:

- Ristrukturimi dhe reformimi i saj në aspektin e avancimit teknologjik dhe kuadrove të reja të punës në harmoni me trendët ndërkombëtarë. Fillimisht, nevojitet mbështetje financiare për “Trepça Sh. A.” si periudhë kalimtare në fazat e zhvillimit të saj në mënyrë që kapacitetet prodhuese të stabilizohen me qëllim të rritjes së rentabilitetit të Trepçës;
- Futja e kapitalit privat duke pasur kujdes në zhvillimin strategjik të Trepçës si shtyllë e veçantë e interesit kombëtar e shtetëror.

## ZHVILLIMI I SEKTORIT TË MINIERAVE

Një ndër potencialet më të mëdha të zhvillimit ekonomik të Kosovës, janë resurset minerale metalore, linjiti dhe shumë vendburime të mineraleve industriale. Minierat më të rëndësishme të shfrytëzimit të Pb-Zn janë: “Trepça” në Stantërg, Hajvalia, Badofci, Kizhnica, Artana, Bellobërda dhe Cërnaci. Po ashtu, linjiti është resursi më i rëndësishëm energjetik i Kosovës.

Në kuadër të nismave të tjera për t’i tërhequr investimet e huaja, për ta nxitur sektorin e prodhimit si dhe për të siguruar qasje në kapital, PDK-ja do të ketë prioritet të veçantë rimëkëmbjen dhe konsolidimin e sektorit minerar. Po ashtu, edhe duke investuar në asistencë teknike dhe rritje kapacitetesh do të përpiqet të inkurajojë projekte të reja strategjike në sektorin minerar që do të hapnin vende të reja të punës. Në veçanti, me rëndësi do të jenë ato iniciativa private që do të krijonin industri prodhuese, produkte përfundimtare për eksport, për të cilat PDK-ja do të jetë gati që të japë mbështetje të ndryshme, duke përfshirë edhe investimin në infrastrukturën mbështetëse të transportit dhe energjisë. Vëmendje e veçantë do t’i kushtohet rehabilitimit të sistemit hekurudhor të Kosovës duke u përpjekur që vendburimet kryesore të xeherorëve të kenë qasje në hekurudhë. Po ashtu, për ta zhvilluar këtë sektor do të mbështetet në programe të reja kërkimore gjeologjike dhe minerare si dhe do të ndërmerret hartimi i një kornize ligjore sa më të përshtatshme për t’i zgjidhur çështjet pronësore që lidhen me shfrytëzimin e minierave.

## PROMOVIMI I SEKTORIT MINERAR

Rëndësi të veçantë ka edhe promovimi i kapaciteteve minerare të Kosovës në arenën ndërkombëtare. Përveç mundësisë së tërheqjes së investimeve, ka ndikim të jashtëzakonshëm edhe promovimi i shtetit në kuptimin e politikave, klimës dhe sigurisë për kushte të favorshme në aspektin e sigurisë së investimeve nga investitorët privatë. Masat për ta realizuar tërheqjen e investimeve janë:

- Ristrukturimi dhe funksionalizimi i minierave,
- Trajtimi i problemeve mjedisore historike,
- Përmirësimi i kushteve të punës dhe siguria në punë,
- Zhvillimi i industrisë përpunuese në sektorin minierar,
- Krijimi i politikave tatimore favorizuese për tërheqjen e investimeve, rritjen dhe valorizimin e shkallës përpunuese të mineraleve në vend,
- Për ta nxitur zhvillimin e sektorit të energjisë dhe atë minierar do të krijohet Agjencia për Energji dhe Miniera, e cila do të shërbejë si “one-stop shop/gjithçka nën një çati”, veçmas për ta lehtësuar licencimin e shfrytëzimeve minerare,
- Hulumtime të reja për identifikimin e resurseve minerale në Kosovë.

## RIMËKËMBJE E TURIZMIT

Turizmi është një nga sektorët ekonomik që ofron numrin më të madh të vendeve të punës, duke ndikuar drejtpërdrejtë në mirëqenien e shumë familjeve të Kosovës. Ky sektor, ka qenë më i dëmtuari gjatë pandemisë e sidomos në periudhën e karantinës dhe fatkeqësisht nuk është ndihmuar sa do të duhej dhe shumë kanë biznese të turizmit falimentuar. Jo vetëm që nuk është ndihmuar, por edhe është dëmtuar pa nevojë prej qeverisë për shkak të vendimeve të pamatura, ndalim-qarkullimeve të pamenduara mirë apo politikave ad-hoc të improvizuara. Për më tepër, për shkak të kontrolleve e ndëshkimeve të shpeshta arbitrare të inspektorëve.



Ajo që e rëndoi akoma më shumë këtë sektor ishte edhe mbyllja e kufijve ndërkombëtarë dhe pamundësia e diasporës për të vizituar vendlindjen. Prandaj, PDK-ja e shikon si obligim të qeverisë së ardhshme që t'i kushtojë vëmendje të posaçme bizneseve të këtij sektori që janë prekur e dëmtuar rëndë prej pandemisë.

Gjithashtu, ky është një sektor me potencial të madh zhvillimor në Kosovë, prandaj meriton një përkrahje edhe më të madhe se më parë, për të mundësuar më shumë investime e hapje të reja të vendeve të punës. Prandaj gjatë qeverisjes së ardhshme të PDK-së, turizmi do të marrë një tjetër trajtim duke formuar fillimisht një agjenci shtetërore të turizmit, sikurse kanë bërë shumë vende fqinje. Kosova ofron mundësi shumë të mira të zhvillimit të disa lloje të turizmit, duke filluar me atë dimëror e malor, kreativ-sportiv, kulturor, transit, etj. Pozita e mirë gjeografike pranë vendeve me turizëm të zhvilluar, infrastruktura moderne me të cilën Kosova është duke u lidhur me vendet fqinje, ka ndikuar dhe do të ndikojë edhe më shumë pozitivisht për rritjen e fluksit të turistëve në Kosovë. Në mandatin e ardhshëm PDK-ja, do të ndërmarrë disa hapa të rëndësishëm për ta përparuar këtë sektor.

## **KRIJIMI I AGJENCISË PËR PROMOVIMIN DHE MBËSHTETJEN E TURIZMIT**

Nevoja për politika të shumta ndërsektoriale e të specializuara për një sektor gjithnjë e më konkurrues, sikurse është turizmi, ka bërë që shumë vende të kenë institucione të posaçme shtetërore për turizmin. Në këtë aspekt, krahasuar me vendet fqinje, Kosova është relativisht e vonuar, prandaj krijimi i kësaj agjencie është bërë domosdoshmëri. Ky institucion shtetëror do të merret me hartimin e reformave, politikave, studimeve e analizave të ndryshme në sektorin e turizmit. Detyra e parë e këtij institucioni do të jetë hartimi i një strategjie gjithëpërfshirëse të zhvillimit të turizmit, bashkë me sektorët përkatës duke eksploruar, gjithashtu, edhe forma jo konvencionale të turizmit.

Po ashtu, do të angazhohet që të merret me marketingun e Kosovës si një destinacion për turizëm të turistët potencialë të huaj si dhe tek investitorët potencialë në këtë sektor. Në kushtet e konkurrencës së ashpër ndërkombëtare, marketingu është bërë një domosdoshmëri për turizmin kosovar që nuk ka përvojë e reputacion ndërkombëtar, prandaj PDK-ja do të përpiqet që të mundësohet një promovim sa më dinjitoz ndërkombëtar i turizmit në Kosovë, duke angazhuar kompanitë më cilësore të marketingut.

Së fundmi, kjo agjenci do ta nxisë bashkëpunimin ndërkombëtar, shkëmbimin e përvojave, rritjen e kapaciteteve teknike dhe do të ndërveprojë me ministri e institucione të tjera shtetërore për ta koordinuar punën në shërbim të zhvillimit të turizmit në Kosovë. Nëpërmjet kësaj agjencie, PDK-ja do të angazhohet për krijimin e kushteve përmes qeverisjes që oferta turistike kosovare të jetë në përputhje me kërkesën turistike bashkëkohore, duke stimuluar rrjetet kulturore që merren me art dhe kulturë për prezantim sa më dinjitoz në forma të ndryshme të mundshme.

## **MODERNIZIMI I MËTUTJESHËM I INFRASTRUKTURËS**

PDK-ja do ta vazhdojë ndërtimin e rrugëve që çojnë drejt vendeve kryesore turistike në vend si dhe do të investojë më shumë në qasjen me ujë, rrymë dhe të tjera shërbime të nevojshme. Po ashtu, do të investohet edhe në infrastrukturën e ndihmës shëndetësore dhe ndihmës së shpejtë si dhe në sigurinë e rendit gjatë sezonit apo në vendet kryesore turistike.

## **TËRHEQJA E INVESTITORËVE SERIOZË NË HOTELERI**

PDK-ja gjykon se vendi ynë ka potencial të madh për turizëm elitare dhe do të këmbëngulë që të krijohet klimë e përshtatshme dhe të tërhiqen investitorë sa më seriozë në fushën e turizmit, të cilët do të mund të ndërtojnë komplekse hotelerie të kategorisë së lartë, duke sjellë në Kosovë emra të njohur të botës së turizmit, të cilët do t'i transferojnë në vendin tonë përvojat dhe praktikat më të mira ndërkombëtare.



## TURIZMI MALOR

PDK-ja do të përpiqet që të jetësohet projekti i Brezovicës duke promovuar në nivel ndërkombëtar këtë projekt dhe duke përmirësuar kushtet që të tërhiqen investitorë sa më seriozë për zbatimin e këtij projekti. Po ashtu, do të investohet në analizimin e potencialit për pista për ski në pjesë të tjera të Sharrit si dhe në Bjeshkët e Nemuna, bjeshkët e Istogut e zona të tjera malore në Kosovë. Vëmendje e veçantë do t'i kushtohet hapjes së shtigjeve malore, organizimit të sporteve malore, infrastrukturës së ndihmës së shpejtë si dhe ngritjes së cilësisë së shërbimeve të hotelierisë dhe atyre kulinare. Po ashtu, me angazhimin e Ministrisë së Jashtme dhe asaj të Diasporës, përpjekje të mëdha, do të bëhen që të nxitet turizmi patriotik dimëror. Pra, do të nxitet mërgata shqiptare që pushimet dimërore dhe sportin e skive ta bëjnë në Kosovë.

## NXITJA E TURIZMIT SHËNDETËSOR

Për të mundësuar një ofertë turistike sa më të pasur, të gjatë e të larmishme, PDK-ja beson se duhet eksploruar potenciale për turizmin shëndetësor. Duke nxitur shfrytëzimin e banjave apo ambienteve të tjera kurative si dhe duke nxitur ndërtimin e komplekseve turistike, ofron shërbime terapeutike ose rehabilituese për të moshuar, pushues të sëmurë ose sportistë.

Në Kosovë, ekzistojnë kushte ideale për mjekësinë e lartësisë, pra për ndërtimin e qendrave turistike që të shfrytëzohen për pushim, rekreacion dhe qëndrim në ajër të pastër në lartësi të madhe mbidetare. Duke pasur parasysh rritjen e kostove të shërbimeve mjekësore në Evropën e Veriut dhe plakjen e popullsisë, Kosova ka një situatë demografike të favorshme për të ofruar shërbime të përshtatshme shëndetësore, për të plotësuar këtë kërkesë në rritje. Po ashtu, shërbime të posaçme si ato dentare, dietetike, dezintoksikuese apo estetike, janë bërë veçanërisht të shtrenjta në botën perëndimore, ndërkohë që ka vende të Evropës Lindore të cilat janë bërë tërheqëse për ata qytetarë që kërkojnë shërbime të tilla më të lira dhe këto praktika të suksesshme mund të përshtaten në Kosovë.

Pas resorteve të turizmit dimëror, banjat përbëjnë pjesën më të rëndësishme të ofertës turistike. Në territorin e Kosovës njihen tashmë Banja e Pejës, Banja e Kllokotit dhe Banja afër Mitrovicës. Megjithatë, duke pasur parasysh numrin e madh të burimeve termale, mund të thuhet se ende ka shumë hapësirë dhe potencial për ta zgjeruar këtë sektor dhe për ta shndërruar Kosovën në një qendër të banjave termale sikurse është bërë tashmë Bullgaria.

Banjat në Kosovë, më shumë shfrytëzohen për kurim dhe veprimtari terapeutike, mirëpo gama për të cilën mund të shfrytëzohen është shumë e gjerë dhe në mandatin e ardhshëm, PDK-ja, do të kujdeset që të shtohen investimet në këtë sektor. Sot, ujërat termalë konsiderohen se janë të dobishme për t'u përdorur gjerësisht për ripërtëritjen dhe kalitjen e shëndetit të njerëzve të shëndetshëm si edhe për dëfrimin e tyre, të cilët janë edhe shumica e popullsisë, krahas klinikave me konceptin modern për kurimin e shumë sëmundjeve.

## TURIZMI SPORTIV

PDK-ja ka identifikuar turizmin sportiv si një tjetër potencial që vlen për t'u marrë në konsideratë në të ardhmen në Kosovë, prandaj do të merret seriozisht me promovimin e sporteve të larmishme në natyrë, për ta bërë më interesant qëndrimin e turistëve në Kosovë, si dhe për t'i tërhequr të pasionuarit e këtyre sporteve, që të vijnë e t'i ushtrojnë te ne gjatë dhe jashtë sezonit turistik tradicional. Të tilla sporte që do të meritojnë vëmendje janë: lundrimi në lumenj e liqene, vozitja me kanoe, kajak, ngasja e makinave 4x4, shigjetaria, pastaj hiking, paragliding, trekking, mountainbiking, alpinizëm dhe suditja e shpezëve. Në të ardhmen, PDK-ja do të krijojë lehtësira dhe hapësira financimi për ta nxitur dhe masivizuar ushtrimin e këtyre sporteve, në mënyrë që Kosova të bëhet një vend konkurrues për pushuesit që janë në kërkim të sporteve në natyrë.

Gjuetia ka dëshmuar se ka shërbyer si tërheqëse e shumë vizitorëve të huaj dhe burim i shumë të ardhurave, prandaj PDK-ja, do të përpiqet që ta kultivojë më tepër këtë pasion duke stimuluar nxitjen e rezervateve të gjuetisë, si dhe të fermave që merren me mbarëshkrimin e kafshëve të egra, për të tërhequr sa më shumë turistë gjuetarë gjatë sezonit dimëror, si dhe për ta pasuruar ofertën ushqimore të restoranteve dhe hoteleve.



Natyra e Kosovës është shumë e pasur dhe e përshtatshme për zhvillimin e këtij lloji turizmi. Rezervatet e gjuetisë shtrihen në 107.300 hektarë, në të cilat jetojnë lloje të ndryshme të kafshëve dhe të shpendëve të egra. Interesi për këtë turizëm ka ardhur duke u rritur në nivel ndërkombëtar dhe çmimi i kafshëve të gjuajtura është shumë i leverdishëm, duke përbërë një potencial të madh për të siguruar të ardhura. Duke vepruar në mënyrë të matur e të planifikuar, do të shndërrohet në ofertë shumë joshëse për turistët e huaj.

Ngjashëm me gjuetinë, edhe peshkimi është një veprimtari që tërheq shumë turistë të pasionuar. Fauna lumore dhe liqenore e Kosovës është mjaftë e pasur dhe destinacione si Drini i Bardhë, Sitnica, Ibër-Lepenci, në Bistricën e Pejës dhe të Deçanit, si dhe Liqeni i Batllavës, i Badovcit, i Radoniqit, dhe mund të shndërrohen në vende tërheqëse për turistët që adhurojnë peshkimin.

## TURIZMI RURAL DHE KULTUROR



Turizmi rural apo agroturizmi përbën një tjetër sektor me potencial të madh zhvillimi në Kosovë. Numri i turistëve që pëlqejnë këtë lloj turizmi në nivel ndërkombëtar, por edhe në nivel vendor, sa vjen e rritet. Po ashtu, po vihet re tendencë e qytetarëve të zonave urbane të Kosovës për të kaluar kohë në zonën rurale në kontakt të drejtpërdrejtë me natyrën dhe me veprimtaritë tradicionale të bujqësisë dhe blegtorisë.

Prandaj, PDK-ja, beson se zhvillimi i agroturizmit, duke huazuar nga përvojat më të mira ndërkombëtare, në zonat piktoreske të shumta të Kosovës, ka për ta bërë sa më të larmishme dhe të gjatë ofertën turistike të vendit tonë dhe ka për ta shtuar ndjeshëm punësimin dhe të ardhurat në sektorin e turizmit. Përveç aspektit të bukurisë së natyrës, agroturizmi në Kosovë mund të stimulohet edhe prej pranisë së kulinarisë karakteristike, traditës së pasur folklorike si dhe bujarisë tipike kosovare. Në mandatin e ardhshëm, PDK-ja, do të hartojë një analizë të thellë për këtë formë turizmi dhe do të kanalizojë një pjesë të fondeve për ta stimuluar këtë sektor.

Në këtë aspekt, rëndësi të madhe merr edhe përkujdesja për monumentet, shfrytëzimi i trashëgimisë sonë të pasur kulturore si dhe organizimi i aktiviteteve të shumta folklorike, tradicionale, tregjeve, lojërave popullore, etj. në mënyrë që oferta jonë turistike të pasurohet edhe me dimensionin kulturor.

## TURIZMI TRANSIT

Kosova ka potencial të rëndësishëm edhe të turizmit transit që nënkupton ofrimin e shërbimeve turistike për vizitorët afatshkurtër apo kalimtarë. Shtimi i këtyre udhëtarëve që kalojnë nëpër Kosovë do të përkthehet për rritjen e konsumatorëve për shërbime turistike për hotele, restorante, furnizime me karburant, ushqime apo shërbime dytësore. Ky potencial lidhet në mënyrë të veçantë me pozitën gjeografike dhe vendndodhjen në një hapësirë që është e rëndësishme për lidhshmërinë e rajonit. Tanimë, rrugët e Kosovës përdoren dendur nga individë të cilët udhëtojnë nëpërmjet Kosovës drejt vendeve të tjera turistike finale si Shqipëria, Greqia, Turqia apo Kroacia.

Përmirësimi radikal që ka pësuar infrastruktura rrugore falë nismave të kaluara të PDK-së dhe modernizimi që do të vijojë në mandatin e ardhshëm qeverisës, do ta bëjë shumë të leverdishme, të rehatshme dhe të shpejt transportimin e udhëtarëve ndërkombëtarë nëpërmjet Kosovës. Përfundimi i ndërtimit të rrugës 6 dhe 7, në kuadër të projektit të transportit rajonal të Evropës Juglindore, do ta bëjë Kosovën një nyje lidhëse të rëndësishme, duke e bërë për shumë shtetas të huaj kalimin nga Kosova si itinerarin më të shpejtë.



## RIMËKËMBJE E KULTURËS

Largimi i PDK-së nga drejtimi i ministrisë së kulturës, solli një përkeqësim të madh në këtë sektor, ku shumë prej projekteve madhore që ishin parashikuar të zbatoheshin u bllokuan apo u lanë anash. PDK-ja është dalluar nga partitë e tjera në Kosovë për sa i përket kujdesit dhe mbështetjes së dhënë për kulturën dhe me rikthimin në qeverisje po ashtu do ta revitalizojë këtë sektor që partitë tjera e përçmojnë. Pandemia me imponimin e distancës sociale, ndalimin e qarkullimit, kufizimin e pjesëmarrjes së publikut në aktivitete, ka bërë që jeta kulturore në vend të gjymtohet rëndë. Për rrjedhojë edhe të ardhurat e qytetarëve që janë të punësuar në këtë sektor, janë prekur rëndë dhe fatkeqësisht, ky përkeqësim i gjendjes së tyre ekonomike nuk e ka vënë qeverinë në lëvizje për t'iu ardhur në ndihmë.

Për ta rimëkëmbur e ringjallur jetën kulturore dhe përkrahur punonjësit e kulturës, PDK-ja do të ndërmarrë një sërë masash.

Së pari, për t'i motivuar më shumë njerëzit e botës së artit e kulturës, do të shtohen fondet për rroga, shpërblimet për financime projektesh si dhe për mundësimin e pjesëmarrjes në konferenca apo ngjarje të tjera kulturore ndërkombëtare, kur kufijtë të rihapen.

Me rëndësi të madhe për mandatin që vjen, ka për të qenë hartimi dhe miratimi i Ligjit për krijuesit e performuesit e artit e të kulturës, i cili do të sigurojë status të veçantë për artistët. Përpos këtij, do të hartohet programi për çmimet dhe dekoratat për arritjet në fushën e kulturës.

Infrastruktura fizike e kulturës është, gjithashtu, një mangësi e madhe së cilës ka për t'iu përkushtuar me shumë energji PDK-ja gjatë mandatit të ardhshëm.

Ndërtimi i Shtëpisë së Operës dhe Baletit si dhe Muzeut të Artit Bashkëkohor janë projektet madhore që duhet të realizohen në fushën e investimeve kapitale në kulturë. Dy qeveritë Kurti dhe Hoti, nuk kanë bërë asnjë gjë në këtë aspekt. Po ashtu, rinovimi dhe përshtatja e objekteve të tjera të institucioneve të kulturës do të mbetet objektiv tjetër që do të marrë vëmendje në mandatin e ardhshëm qeveritar.

Institucionet e kulturës që veprojnë në kuadër të Ministrisë së Kulturës do të vazhdojnë të marrin përkrahje jo vetëm në fushën e investimeve kapitale, por edhe për rritjen e performancës së tyre. Një tjetër prioritet me rëndësi do të jetë promovimi i kulturës në skenën kulturore ndërkombëtare. Përmes pranisë në ngjarje të rëndësishme kulturore ndërkombëtare jo vetëm se promovohen arritjet tona në fushën e kulturës, por promovohet edhe shteti dhe subjektiviteti ynë ndërkombëtar.

Një objektiv tjetër domethënës për kulturën, është konsolidimi i të drejtës së autorit në Kosovë. Në këtë fushë, gjatë mandatit të ardhshëm do të bëhet:

- Funkcionalizimi i shoqatave kolektive në të gjitha fushat e të drejtës së autorit dhe mbledhja e të hyrave për autorët dhe të gjithë mbajtësit e tjerë të të drejtave;
- Avancimi i kornizës legjislativë, nxjerrja e ligjeve dhe akteve nënligjore të reja, me qëllim të adresimit të çështjeve si dhe harmonizimi i plotë me legjislacionin e BE-së;
- Forcimi i bashkëpunimit mes institucioneve përgjegjëse, pra atyre anëtare të Task-Forcës dhe të Këshillit Kombëtar të Pronësisë Intelektuale;
- Organizimi i aktiviteteve të ndryshme si: Konferenca për medie, seminare, fushata vetëdijesuese, përfshirë atë online, me qëllim të ngritjes së vetëdijes për të drejtën e autorit dhe nxitjes së krijimtarisë kreative.

## TRASHËGIMIA KULTURORE

Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore është përparësi e madhe për një parti konservatore si Partia Demokratike e Kosovës. Prandaj, plotësimi dhe avancimi i kornizës ligjore dhe institucionale bazuar në praktikat dhe standardet ndërkombëtare më të mira do të jetë një objektiv i rëndësishëm i PDK-së në mandatin që vjen.

Trashëgimia kulturore përcaktohet si shtyllë e rëndësishme e zhvillimit të qëndrueshëm të vendit që mund të ndihmojë edhe në nxitjen e turizmit kulturor. Ruajtja, mbrojtja dhe promovimi i trashëgimisë kulturore, gjatë mandatit të ardhshëm qeveritar, është e përmbledhur në tri shtylla kryesore, si më poshtë, të cilat mbështeten në parimin bashkëkohor të konceptit të trashëgimisë si nocion i hapur dhe dinamik.

1. Avancimi i sistemit ligjor dhe institucional i mbrojtjes në përputhje me Kushtetutën e Republikës së Kosovës, ligjeve të tjera relevante, angazhimeve të Kosovës, si dhe orientimin e Qeverisë së Kosovës karshi Prioriteteve të Partneritetit Evropian dhe anëtarësimit në UNESCO;
2. Qasja e integruar në mbrojtje sipas parimeve dhe trendëve të planifikimit dhe zhvillimit të qëndrueshëm urban, ekonomik, shoqëror dhe kulturor. Nën këtë objektiv, prej vitit 2020 planifikohet të zbatohet digjitalizimi i koleksioneve të Muzeut Kombëtar të Kosovës, sistemi i biletarisë për asetet më kapitale të vendit dhe projekte të tjera që ndërlihen me qëllim të promovimit të turizmit kulturor;
3. Edukimi, promovimi dhe ndërgjegjësimi qytetar me qëllim të nxitjes së ndjenjës së identitetit kulturor dhe si burim i frymëzimit dhe inovacionit.

Me përparësi në mandatin e ardhshëm, do të trajtohen ndërtesa e Muzeut Kombëtar të Kosovës, ndërtesa e Institutit të Kosovës për Mbrojtje të Monumenteve, Kompleksi Etnologjik “Emin Gjiku”, ndërtesa e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Prizren, Muzeu Arkeologjik në Prizren, Muzeu në Kalanë e Prizrenit, ndërtesa e Qendrës Rajonale për Trashëgimi Kulturor në Gjakovë e shumë të tjera. Këto ndërtesa, përveçse janë asete të mbrojtura dhe nga më reprezentativet, edhe u shërbejnë institucioneve që funksionojnë brenda tyre.

Për të ekspozuar dhe promovuar trashëgiminë tonë monumentale, si dhe për ta nxitur turizmin kulturor, vëmendje të veçantë do të marrin lokalitetet e rëndësishme arkeologjike si: Parku Arkeologjik Ulpiana, Lokaliteti i Dresnikut, Kalaja e Harilaqit, Kalaja e Korishës, Kalaja e Dardanës, etj.

## RIMËKËMBJE E SPORTIT

Sporti u prek rëndë prej masave kufizuese të pandemisë të cilat bllokuan shumë gara, aktivitete, ngjarje apo vizita të sportistëve tanë. Përpos këtyre, ndalimi i qarkullimit dhe mbyllja e ambienteve publike, ka bërë që ata të mos ushtrohen rregullisht e mos të mbajnë formën e duhur sportive. Prandaj, në kuadër të platformës elektorale të Rimëkëmbjes, një ndër prioritetet kryesore ka për të qenë edhe revitalizimi i jetës sportive.



Pandemia, gjithashtu, nxori në pah rëndësinë e madhe që ka një jetë e shëndetshme e pasuruar me aktivitete fizike për qytetarët. Sporti luan një rol kyç në shëndetin e qytetarëve, prandaj në mandatin e ardhshëm, do ta promovojmë masivizimin e sportit, pasi përgjegjësia kryesore për të qëndruar të shëndetshëm u takon vetë qytetarëve dhe sporti është garancia më e mirë.

PDK-ja do të hartojë politika që ta mundësojnë pajisjen e publikut me më shumë informacion për ta inkurajuar atë për angazhim në sport, por edhe për të mësuar që të ndjekë stile sa më të shëndetshme të jetës, për të përdorur masa parandaluese si dhe për të ndjekur terapi rigjeneruese dhe konvaleshence, nëse janë të sëmurë kronikë ose persona në risk. Për këtë arsye, do të investohet më shumë në ambiente sportive për publikun.

Rëndësia e madhe e sportit nuk lidhet vetëm me mbajtjen e një shoqërie të shëndetshme dhe të lumtur, por edhe me pajisjen e të rinjve me aftësi dhe shprehje që do t'i bëjnë edhe më të suksesshëm në jetë duke i shndërruar në faktor të zhvillimit të Kosovës.

Falë përvojës sportive, të rinjtë pajisen me shprehje të disiplinës, durimit, këmbënguljes dhe fitojnë edhe etikën e punës. Sporti i pajis ata me kurajë, me besim në vetvete, me shpirt iniciative, me aftësi për ta menaxhuar kohën si dhe me shpirtin e ekipit. Sportistët kanë zotësinë për të mbajtur një objektiv të qartë para tyre dhe e kuptojnë që fitorja vjen vetëm nëpërmjet punës së palodhur.

Të gjitha këto, janë shprehje, shkathtësi që kultivojnë një karakter dhe personalitet të njerëzve të suksesshëm. Pra, sporti jo vetëm se do t'i mbajë larg veseve e parazitizmit, por do t'i bëjë të rinjtë tanë profesionistë më të zotë, punëtorë më efikas, liderë më të realizuar dhe sipërmarrës më të suksesshëm. Prandaj, sporti do të luajë një rol thelbësor për rritjen e cilësisë së kapitalit njerëzor të Kosovës për shpалosjen e potencialit të jashtëzakonshëm të rinisë sonë si dhe për rritjen e konkurrueshmërisë në nivel ndërkombëtar të tregut tonë të punës.

Duke mbështetur sportin, rinia jonë jo vetëm është më edukuar dhe e aftë, por edhe mund të ndikojë në përmirësimin e imazhit të Kosovës në botë. Për rrjedhojë, do të vazhdojë mbështetja dhe shpërblimi i sportistëve elitare të cilët me medaljet e tyre ia kanë zbardhur fytyrën Kosovës. Po ashtu, do të dyfishohet numri i bursave që do të jepen për të talentuarit në sport.

Duke synuar rritjen e cilësisë dhe masivizimit të sportit, në mandatin e ardhshëm qeveritar, PDK-ja do t'i ndërmarrë veprimet në vijim:

Do të mbështeten në veçanti masivizimi i sportit, sportet për persona me aftësi të kufizuara dhe sportet për vajza, në mënyrë që të forcohet përfshirja në shoqëri për pjesëtarët e këtyre dy komuniteteve. Do të hartohet ligji i ri për sportin dhe do të zbatohet plotësisht ligji për sponsorizime, në mënyrë që të shtohen fondet që shkojnë për sportistët.

Do të hartohet rregullore për shfrytëzimin e objekteve sportive, duke krijuar sa më shumë hapësira dhe lehtësira për klubet sportive dhe sportistët. Në mënyrë të veçantë, me rëndësi është përdorimi prej tyre i ambienteve sportive të shkollave jashtë orarit të mësimi.

Do të hartohet një rregullore për çmime dhe dekorata për sportistët kulminantë dhe veteranët sportivë.

Në bashkëpunim të ngushtë me Ministrinë e Arsimit, sporti do të bëhet pjesë thelbësore përbërëse e programeve të detyrueshme arsimore parauniversitare. Po ashtu, do të finanohen dhe promovohen aktivitetet sportive jashtëshkollore në mënyrë që sporti shkollor të shërbejë si mundësi për të identifikuar dhe promovuar talente të reja. Për këtë qëllim, do të ndërtohet një sistem garash mes shkollave dhe nxitet krijimi i ligave dhe kampionateve shkollore.

Përkushtimi i PDK-së ndaj sportit, do të manifestohet edhe tek investimi masiv tek infrastruktura sportive në vend. Të tilla nisma do të jenë:

- Ndërtimi i stadiumit kombëtar,
- Rinovimi i stadiumeve aktuale,
- Ndërtimi i stadiumeve ndihmëse,
- Palestra e re në Prishtinë,
- Adaptimi dhe kategorizimi i palestrave në qytetet e Kosovës,
- Pajisja me infrastrukturë adekuatë për të gjitha llojet e sporteve.

## FUQIZIMI I POZITËS SË GRAVE NË SHOQËRI

Arritja e barazisë gjinore dhe forcimi i rolit të gruas, janë një parakushte për një shoqëri të zhvilluar dhe përbëjnë një pjesë të rëndësishme të programit politik të PDK-së. Prandaj, partia jonë do ta vazhdojë ndërmarrjen e hapave për avancimin e pozitës së gruas në shoqëri, duke adresuar me kujdes dhe seriozitet të madh probleme të mprehta si përfshirja e grave në mënyrë të barabartë me burrat, heqja e paragjykimeve ndaj mundësive të grave, dhuna në familje, shkollimi me vështirësi, sidomos në zonat rurale apo problemet e trashëgimisë pronësore.



Në krye të këtyre përpjekjeve, ka për të qenë synimi i fuqizimit ekonomik të grave në Kosovë. Për këtë arsye, PDK-ja, do të hartojë politika të veçanta për të siguruar lehtësira tatimore për bizneset private që punësojnë gra si dhe për ato biznese që themelohen e udhëhiqen nga gratë. Në fondet apo subvencionet e dhëna nga Qeveria, përparësi të madhe do të kenë aplikantët që i përkasin gjinisë femërore. Përpos kësaj, PDK-ja do të angazhohet në një fushatë intensive për t'i dhënë fund diskriminimit të grave për ndarjen e pasurisë familjare. Po ashtu, do të merren nisma ligjore që t'u garantojnë grave drejtësi të barabartë përpara ligjit për çështjet e trashëgimisë.

Për PDK-në, arsimimi është një ndër mënyrat më efektive për ta përmirësuar statusin social të grave në shoqëri, prandaj do të angazhohet që të ndihmojë për aq sa mundet, mbulimin e shpenzimeve të shkollimit. Po ashtu, do të hartojë programe të posaçme të bursave për t'i ndihmuar familjet që t'i dërgojnë vajzat e tyre në universitete, brenda dhe jashtë vendit.

Me rreptësi të madhe, do të trajtohet gëzimi i të drejtës së vajzave për t'u shkolluar duke angazhuar inspektorët e arsimit që të kontrollojnë me vëmendje të lartë nëse prindërit ua mohojnë vajzave të tyre të drejtën për shkollim.

PDK-ja do të angazhohet për një program masiv shtetëror të ndërtimit të çerdheve kudo në vend. Investimi në arsimin parashkollor do të mundësojë që shumë nëna të reja të kenë mundësi që t'i çojnë fëmijët në çerdhe dhe të bëjnë një jetë më aktive në ekonomi dhe shoqëri.

Po ashtu, vëmendje do t'u kushtohet shërbimeve cilësore sociale për gratë dhe vajzat e reja në rrezik. Dhuna ndaj grave është një shkelje e shpeshtë e të drejtave dhe lirive të grave në Kosovë dhe sjell një pengesë serioze për arritjen e barazisë gjinore. Prandaj, PDK-ja, do ta aplikojë politikën e tolerancës zero kundrejt dhunës ndaj grave dhe dhunës në familje. PDK-ja do të angazhohet për përmirësimin e legjislacionit nga këndvështrimi gjinor dhe për marrjen e masave të rrepta ligjore ndaj formave të ndryshme të dhunës ndaj grave. Po ashtu, do të investohet për krijimin e një infrastrukture shtetërore efektive që jep shërbime të përgjithshme dhe të specializuara për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj grave e dhunës në familje. Riintegrimi i grave dhe vajzave viktime të dhunës, do të bëhet nëpërmjet ofrimit të banesave sociale, punësimit, formimit profesional dhe ndihmës dhe shërbimeve sociale.

Prioritet i veçantë do të jetë për sistemin shëndetësor parësor dhe përkujdesjen ndaj grave shtatzëna dhe fëmijëve të vegjël të cilët janë segmente të shoqërisë më në risk.

Me rëndësi do të jetë për PDK-në forcimi i rolit shoqëror të grave dhe vajzave, nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje, duke shtuar përfshirjen në lista dhe në emërimet e ndryshme në poste të larta shtetërore. Po ashtu, për t'iu kundërvënë stereotipave të prapambetur, PDK-ja do të angazhohet që ta rrisë praninë e grave në profesione të konsideruara si jo tradicionale për to, si ushtria, policia, etj.

Për ta ndryshuar statusin e grave në shoqëri, shumë e nevojshme është që të ndryshohet edhe mentaliteti shoqëror dhe t'u jepet fund sjelljeve stereotip, paragjyquese, si dhe modeleve që nxisin veprime të dhunshme dhe diskriminuese. Për këtë qëllim, PDK-ja, do të ndërmarrë fushata sensibilizuese për promovimin e barazisë gjinore dhe do ta përfshijë këtë çështje në programet shkollorë të arsimit të detyrueshëm parauniversitar.

Do të synohet forcimi i rolit të shoqëror të grave dhe vajzave nëpërmjet rritjes së pjesëmarrjes së tyre në vendimmarrje, duke shtuar përfshirjen në lista dhe në emërimet e ndryshme në poste të larta shtetërore nga ana e PDK-së.



Me qëllim të eliminimit të stereotipave gjinor, do të vendosen kuota të punësimit për gratë në sektorë të administratës publike që konsiderohen jo tradicionale për gratë, sikurse: siguria, mbrojtja, Agjencia e Inteligjencës, zjarrfikësit, etj.

Agjencisë për Barazi Gjinore do t'i jepet ta administrojë Fondin për Barazi Gjinore i cili do të jetë specifikisht i dedikuar për Credit Guarantee Fund dhe për Start-Ups nga gratë dhe vajzat, si dhe programet e ndryshme të kualifikimit për gra në aspektin menaxherial.

Një tjetër masë për fuqizimin të grave, është vendosja e pushimit të lehonisë për burrat, gjithashtu, duke u dhënë ndihmë grave në karrierë. Pushimi i lehonisë njihet si një ndër arsye pse gratë nuk punësohen nga bizneset private, prandaj, qeverisja e PDK-së, do ta ulë koston e lehonisë në dy mënyra: 1) subvencionim i zëvendësuesit gjatë pushimit të lehonisë; 2) kompensim i një pjese të pagës së punëdhënësit për pushimin e lehonisë.

Për ta rritur forcën ekonomike dhe autonominë e rolit në jetën shoqërore të grave e vajzave, do të hartohen politika të veçanta inkurajuese në formën e lehtësirave tatimore për:

Bizneset private që punësojnë gra - për çdo grua të punësuar me kontratë njëvjeçare, tre muajt e parë të kompensimit të pensioneve- i paguan shteti;

Bizneset që themelohen e udhëhiqen nga gratë - femra do trajtim me përparësi në aplikimet që bëjnë për kredi, grante dhe subvencione, licenca, tenderë, etj.;

Ta hartojë dhe zbatojë projektin e "Programit të artizanatit", siç janë, tekstil, filigran, punë dore në përgjithësi, pra që mundësojnë punë nga shtëpia. Target: Zonat e thella rurale dhe malore.

## RINIA

Pavarësisht premtimeve të shumta elektorale të LVV-së dhe LDK-së, dhe faktit që një pjesë e mirë e votës që i sollti në pushtet këto dy parti vinte nga rinia, qeverisja e tyre nuk ka bërë asgjë domethënëse për rininë. Qeveritë Kurti dhe Hoti, ishin tepër të zëna për t'u marrë me spastrime politike të administratës dhe me punësime militantësh, dhe nuk kanë treguar asnjë vëmendje për të përmirësuar jetën e rinisë së Kosovës e cila ende vazhdon të jetë e prekur nga plaga e madhe e emigracionit.



Prandaj, PDK-ja, do ta ketë përmirësimin e cilësisë së jetës së rinisë dhe hapjen e mundësive të reja për të rinjtë, si një nga objektivat kryesor në kuadër të programit të Rimëkëmbjes. Rinia është një ndër asetet kryesore të vendit dhe që ekonomia e Kosovës të zhvillohet në kushtet e sotshme të globalizimit, është e nevojshme që të rritet sa më shumë cilësia e burimeve njerëzore, për t'i bërë ato sa më konkurruese në nivel ndërkombëtar. Modeli më i suksesshëm ekonomik sot në botë është ai i ekonomisë së bazuar në dituri dhe kjo do të thotë që kërkesë e kohës është që arsimit në Kosovë të jetë sa më ngushtë i lidhur me kërkesat e ekonomisë.

Një ndër shtyllat kryesore të programit të Partisë Demokratike të Kosovës, ka për të qenë rritja e cilësisë së arsimit, inkurajimi i shkencës dhe transferimit të teknologjisë, rritja e arsimit profesional dhe pajisja me aftësi të transferueshme, për t'i bërë të rinjtë tanë sa më konkurrues në tregun e punës. Po ashtu, që të ulët papunësia te rinia, do të bëhet lehtësimi i barrës fiskale dhe ofrimi i një pakete me iniciativa për kompanitë që punësojnë të rinj. Kështu, Qeveria do t'i mbulojë kontributet shoqërore që duhen paguar nga punëdhënësi, për çdo kontratë që është së paku njëvjeçare për një të ri.

Nxitja e mundësive që të rinjtë të fitojnë sa më herët përvojë pune, duke përfshirë praktikën në punë si pjesë të programeve arsimore. Në këtë mënyrë do të sigurohet një lidhje më e hershme dhe më e përshtatshme e të rinjve me tregun e punës, duke ua lehtësuar atyre gjetjen e vendeve të punës pas shkollimit. Prandaj, do të bëhet subvencionim i pagës së internshipit – 5.000 studentë nga 100 euro si dhe do të llogaritet si përvojë pune internshipi i bërë gjatë kohës së shkollimit.

Prioritet do të jetë zhvillimi i aftësive sipërmarrëse te të rinjtë, duke i përgatitur dhe mbështetur në aktivitete ekonomike. Rëndësi e madhe do t'u kushtohet programeve të trajnimit me aftësi menaxheriale dhe administrative të rinisë. Po ashtu, do të investohet në inkubatorë të specializuar në start-up, të cilët do ta bëjnë më të lehtë themelimin dhe funksionimin e ndërmarrjeve të reja prej të rinjve.

Mbështetja e kompanive të të rinjve, gjithashtu, do të jetë një ndër mënyrat se si do të synohet përmirësimi i gjendjes së të rinjve në Kosovë. Konkretisht, PDK-ja, do të angazhohet me skema financimi, me norma të ulëta e të favorshme interesi, për të financuar ide të sipërmarrësve të rinj. Paralelisht me to, do të organizohen programe konsultimi për t'i ndihmuar sipërmarrësit e rinj për konsolidimin e kompanive të tyre të reja.

Promovimi dhe masivizimi i sportit ka për të qenë një ndër prioritetet e PDK-së në fushën e rinisë. Do të bëhen investime serioze për krijimin e një infrastrukture sa më moderne në vend si dhe do të modernizohen terrenet dhe pajisjet sportive në shkollat shtetërore. Paralelisht, do të ndërmerren lehtësira tatimore dhe doganore për sipërmarrësit privatë që investojnë në aktivitete, klube apo ambiente sportive.

PDK-ja do ta aplikojë politikën e mbështetjes së pakursyer për talentet e reja duke shpërblyer arritjet e rinisë në fushën e sportit e artit dhe shkencës si dhe duke siguruar bursa për t'i vijuar studimet në institucionet më prestigjioze të botës, për ata të rinj që demonstrojnë se zotërojnë talent të veçantë në fusha të ndryshme.

Forcimi i zërit të rinisë ka për të vijuar si politikë e brendshme e PDK-së, duke mbajtur dyer të hapura në strukturat e partisë për kuadro të rinj si dhe duke siguruar një konkurrencë dhe mundësi karriere meritokratike brenda saj. Po ashtu, rëndësi të veçantë do t'i jepet përfaqësimit të rinisë në listat e kandidatëve për deputetë apo asamblatë komunale, në të ardhmen. PDK-ja do të angazhohet intensivisht që rinia të jetë sa më e përfshirë në vendimmarrje duke mundësuar nivele sa më të larta të përfaqësimit të të rinjve në të gjitha nivelet politike.

Duke pasur parasysh rëndësinë e leximit për cilësinë e burimeve njerëzore dhe për zhvillimin e shoqërisë, PDK-ja, do të ndërmarrë një fushatë intensive për masivizimin e leximit të rinia në veçanti. Kjo fushatë do të ketë për qëllim që të ndërtojë shprehi sa më të mira të leximit dhe një konsum masiv të librit në Kosovë nga rinia dhe do të shoqërohet me një plan veprimi që do t'i prekë të gjitha institucionet që kanë të bëjnë me librin dhe leximin. Përpos kësaj, kjo fushatë do të synojë të ndikojë në opinion publik në favor të leximit dhe masivizimit të shpërndarjes dhe përdorimit të librit.

Të tjera masa që do të ndërmerren nga PDK-ja në mandatin e ardhshëm, janë si më poshtë:  
Do të bëhet fuqizimi dhe zgjerimi i rrjetit të qendrave rinore duke shtuar kështu edhe aktivitetet dhe trajnimet që ata ofrojnë;

Do të bëhet i mundur krijimi i Kartës së Rinisë deri në moshën 26-vjeçare e cila do të ofrojë lirime në shërbime publike në modelin e European Youth Card. Po ashtu, do të aktivizohet karta e studentit dhe do të përfshihet në rrjetin ndërkombëtar International Student Identity Card (ISIC);

Do të ndërtohet programi shtetëror i “Shërbimit të Vullnetarizmit”, ku vullnetarizmi do të njihet si përvojë pune e vlefshme për komunitetin e të mbështetet me një rrogë minimale;

Do të hartohet programi i përkujdesjes për të miturit në formën e një strategjie kombëtare në mënyrë që mos të ketë më fëmijë që lypin apo punojnë nëpër rrugët e Kosovës;

Do të krijohen institucione të specializuara dhe fushata promovuese për shëndetin riprodhues të të rinjve;

Do të nxitet sistemi i kredive dhe mikrokredive si dhe do të krijohen lehtësira fiskale për sipërmarrjet e të rinjve.

## MJEDISI

Rrezikimi i jetës prej pandemisë ka rikthyer në vëmendje të opinionit publik të nevojës për më shumë mbrojtje të mjedisit. PDK-ja e konsideron shumë të rëndësishme garantimin e një mjedisi të shëndetshëm për qytetarët, prandaj, do i kushtoj një vëmendje të posaçme përmirësimit të marrëdhënies midis njerëzve dhe mjedisit në Kosovë duke huazuar dhe aplikuar praktikatat dhe përvojat më të suksesshme ndërkombëtare.



Mjedisi ka nevojë për t'u përfshirë në prioritetet e Rimëkëmbjes, sepse ballafaqohet me shqetësime të shumta sikurse: ndotja e ajrit, ndotja e ujit, ndotja e tokës, ndryshimet klimatike, ngrohja globale, shpyllëzimi, çështjet e shëndetit publik, humbja e biodiversitetit, mbeturinat shtëpiake, deponitë e mbeturinave dhe industriale, minierat, shfrytëzimi i burimeve natyrore, etj.

Në rrethanat të cilat e kanë karakterizuar zhvillimin shoqëror dhe ekonomik të Kosovës në të kaluarën, mbrojtja e mjedisit ka qenë çështje e anashkaluar dhe në të shumtën e rasteve e nënshtruar interesave të atëhershme ditore.

Vetëm përmes një menaxhimi më të mirë, mund të arrihen qëllimet themelore të zhvillimit - të përmirësohet jeta dhe perspektiva e popullatës në aspektin mjedisor dhe social si dhe ekonomik.

Përparesitë kombëtare varen nga faza e zhvillimit dhe agjenda jonë e re, me të cilën ne do ta ndryshojmë gjendjen aktuale, duke e trajtuar mjedisin si një dimension integral të zhvillimit sesa si një pengesë.

Programi qeverisës i PDK-së, angazhohet fuqishëm për arritjen e kushteve për procesin e negociatave për pranimin dhe anëtarësimin e plotë në BE, ku një nga sfidat e veçanta është harmonizimi me aquis komunitare, për fushën e mbrojtjes së mjedisit. Harmonizimi me aquis për fushën e mbrojtjes së mjedisit kërkon ndryshime sistematike institucionale, organizative dhe investime në teknikat më të mira në dispozicion, në mënyrë që të përmbushen objektivat e vendosura në lidhje me zvogëlimin dhe parandalimin e efekteve të dëmshme në të gjitha komponentët e mjedisit. Për të pasur një zhvillim të qëndrueshëm në vend janë tri shtyllat që janë një mjet i fuqishëm për përcaktimin e problemit të plotë të qëndrueshmërisë, shtyllat ekonomike, sociale dhe mjedisore. Nëse ndonjë shtyllë është e dobët, sistemi në tërësi është i paqëndrueshëm. Prandaj PDK-ja do të ketë qasje koherente për një mjedis të pastër, të shëndetshëm dhe të mbrojtur mirë që mbështet popullatën dhe produktivitetin ekonomik të qëndrueshëm.

Trajtimi i mbeturinave është, gjithashtu, një ndër temat kryesore lidhur me mjedisin. Prandaj, PDK-ja, në mandatin e ardhshëm qeverisës do ta nxisë ndërtimin e një infrastrukture sa më moderne për menaxhimin dhe trajtimin e mbeturinave komunale, të ngurta, të ndërtimit, industriale dhe të rrezikshme dhe të lymit nga ujërat e ndotura. Do të nxitet rritja e efikasitetit të kompanive publike për mbledhjen e mbeturinave si dhe do të nxitet kontraktimi i operatorëve ekonomikë përmes partneriteteve publiko-private për menaxhimin e mbeturinave (në fushën e deponimit, trajtimit dhe riciklimit).



## UJËRAT

Kosova fatkeqësisht nuk është e pasur me ujëra, gjë që e bën akoma më të rëndësishme që të kujdesemi sa më shumë për këtë pasuri të çmuar. PDK-ja konsideron se shfrytëzimi racional i resurseve ujore dhe mbrojtja e tyre nga ndotja, është një ndër elementet kyçe të zhvillimit të shtetit tonë.

Zhvillimin industrial e përcjell shtimi i nevojës për resurse ujore të shfrytëzuesve të ndryshëm industrialë, prandaj duhet pasur parasysh që në të ardhmen nevoja për furnizim me ujë do të shtohet. Fusha e mbrojtjes së ujërave është shumë komplekse dhe kërkon një qasje komplekse. Kjo shpesh shihet nga institucionet tjera edhe si e metë për zhvillim ekonomik dhe shihet me skepticizëm nga institucionet tjera.

Fokusi i politikës sonë, për mandatin e ardhshëm, do të përqendrohet me vëmendje të shtuar në:

Ndalimin e derdhjes së ujërave të zeza të qyteteve dhe fshatrave drejtpërdrejt nëpër lumenjtë tanë. Deri më sot, shumë pak ka pasur aktivitete për këtë problematikë;

Rëndësi të veçantë ka për të pasur edhe çështja e ujërave të zeza, prandaj, do të bëhen përgatitje për ndërtimin e fabrikave të përpunimit të ujërave të zeza në Prishtinë, Gjiilan, Ferizaj, etj.;

Mirëmbajtje të zonave sanitare të shpallura dhe ato që pritet të shpallen;

Shfrytëzim racional dhe të qëndrueshëm të sasive të disponueshme të ujit;

Parashikim dhe ndërtim i akumulacioneve të reja për të siguruar sasi të reja të ujit;

Mbrojtje të shtretërve të lumenjve dhe ndërtim i infrastrukturës mbrojtëse;

Sigurime të digave (akumulimeve sipërfaqësore);

Menaxhim të ujërave ndërkuftare.

## REGJISTRI I PRONAVE UJORE

- Do të investojmë në projektin për rehabilitimin e sistemit të Lepencit për ujitje dhe ujë të pijes;
- Do të angazhohemi për zhvillimin e projektit për zgjerimin e kapacitetit të Liqenit të Radoniqit;
- Do të investojmë në zhvillimin e projektit për hidrosistemin në Desivojcë - Kremenatë - Gjyrishevc.

## PLANIFIKIMI HAPËSINOR

Planifikimi Hapësinor (PH) si sektor, ka funksion zhvillimor dhe rregullues të qëndrueshëm dhe të baraspeshuar të planifikimit hapësinor për tërë territorin e Kosovës si vlerë e përgjithshme kombëtare përmes qeverisjes së mirë, shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore. Për shkak të rëndësisë së fushës në zhvillim ekonomik dhe impaktit që ka në investimet private, publike, investimet strategjike, trajtimi i fushës së planifikimit hapësinor ka për të qenë prioritet i Qeverisë së ardhshme të udhëhequr nga PDK-ja.

Për këtë arsye, do të ndërmerren hapat e mëposhtëm:

Hartimi dhe finalizimi sa më i shpejtë i dokumenteve të Planifikimit Hapësinor në Nivel Qendror (Plani Hapësinor i Kosovës, Harta Zonale e Kosovës, Planet Hapësinore për Zona të Veçanta) dhe në nivel të pushtetit lokal (Planet Zhvillimore Komunale, Hartat Zonale komunale dhe dokumente të tjera);

Rregullim të qëndrueshëm të hapësirës përmes shfrytëzimit të përshtatshëm të tokës, mbrojtjes së mjedisit dhe trashëgimisë kulturore dhe natyrore;

Fuqizim të administratës, ristrukturim dhe ngritje të përgjegjësisë profesionale dhe etike në përputhshmëri me nevojat për zbatim të legjislacioni të kësaj fushe;

Fuqizim të inspektoratit të planifikimit dhe ndërtimit në nivel qendror dhe lokal, të ndalohet menjëherë dhe të merren masa për çdo ndërtim privat apo publik pa leje apo tejkallim të tyre; Administrim, kontroll dhe mbikëqyrje ndaj institucioneve për zbatim të planeve, dhënieve të lejeve të ndërtimit;

Të përmbillet kapitulli i anarkisë në ndërtim dhe të fillohet të ndërtohet me standarde dhe rregulla të përcaktuara në ligjet përkatëse;

Të vazhdohen reformat, në mënyrë që vendi të jetë edhe më konkurrues në tregun ndërkombëtar, gjithashtu, të përkrahet unifikimi i procedurave me rajonin dhe të jemi të hapur për investime të investitorëve të brendshëm dhe të huaj.

Ndërtimi, lidhur ngushtë me planifikimin hapësinor, është një ndër sektorët që siguron që planifikimet e investime publike dhe private në ndërtim në nivel vendi të ofrojnë siguri gjatë ndërtimit, por edhe gjatë jetëgjatësisë së shfrytëzimit. Aktualisht, sektorët më aktivë në Kosovë janë ndërtimi dhe industria ndërtimore, të cilët ndikojnë dukshëm në GDP-në e vendit. Investimet janë kapitale dhe me tendencë rritjeje, të cilat kryhen si nga sektori privat, po ashtu edhe nga ai publik.

Si sfida aktuale është trajtimi i ndërtimeve pa leje në nivel vendi, ku nga procesi i legalizimit, i filluar në vitin 2013, janë identifikuar mbi 352 mijë ndërtime pa leje. Andaj, fokusi i PDK-së është që të krijojë një qasje për ta mundësuar legalizimin sa më të shpejtë të këtyre ndërtimeve.

Një tjetër objektiv me rëndësi i PDK-së në fushën e ndërtimit, ka për të qenë funksionalizimi i plotë i odës së arkitektëve dhe inxhinierëve në fushën e ndërtimit. Ky funksionalizim do t'i shërbejë rritjes së përgjegjësisë profesionale të pjesëmarrësve në fushën e planifikimit, projektimit, ndërtimit, mbikëqyrjes dhe për të siguruar që ndërtimet projektohen, ndërtohen dhe shfrytëzohen të sigurta nga qytetarët e vendit.

Të tjera veprime që do të ndërmerren nga PDK-ja, në mandatin e ardhshëm qeverisës, do të jenë:

- Modernizim të normave dhe standardeve të ndërtimit;
- Kodi i ndërtimit të miratohet e të garantohet ndërtim sipas standardeve evropiane;
- Licencim të profesionistëve/arkitektë dhe inxhinierë të të gjitha profileve;
- Digjitalizim të planifikimit, E-lejet ndërtimore/transparenca për publikun;
- Efijencë të energjisë në objekte;
- Thjeshtëzim të procedurave dhe afateve për leje ndërtimore.

## BANIMI

Banimi është çështje vendimtare për stabilitet social, shëndet dhe zhvillim kualitativ të mirëqenies qytetare. Banimi si shfrytëzues më i madh i hapësirës, ndikon në rrjedhën e zhvillimit të gjithmbarshëm të shoqërisë dhe është komponent i rëndësishëm i zhvillimit social-ekonomik, gjegjësisht standardit jetësor.



E drejta në banim gjithnjë e më shumë është e pranishme në kuadër të politikave globale dhe në luftë për të drejtat njerëzore, e sanksionuar edhe me konventa ndërkombëtare.

Banimi luan rol kyç në krijimin e vendeve ku njerëzit dëshirojnë të jetojnë, vendet ku dëshirojnë të investojnë për biznes dhe t'i rrisin mundësitë e zhvillimit ekonomik.

Misioni i programit qeverisës të PDK-së, është krijimi i kushteve për banim të përshtatshëm dhe të qëndrueshëm në një mjedis të sigurt të jetesës për të gjithë qytetarët e Republikës së Kosovës. Përmes zhvillimit të politikave, hartimit të kornizës ligjore, financiar dhe institucional, synojmë ta realizojmë promovimin e ndërtimit të banimit modern të bazuar në norma, standarde dhe rregulla teknike ndërtimore dhe standarde të EU-së.

Dy ndër prioritetet specifike në këtë fushë, janë banesat sociale dhe banesat në bashkëpronësi, për të cilat PDK-ja ka parashikuar:

**Banimi social:** Programi për banim social është konceptuar në ofrimin e banimit social për familjet ose individët të cilët nuk janë në gjendje ekonomike t'i përballojnë ofertat e tregut të lirë të banesave përmes investimeve kapitale për ndërtimin e banesave;

**Administrimi i banesave në bashkëpronësi:** Ndërtesat e banimit në bashkëpronësi, rregullohen të drejtat, detyrimet dhe përgjegjësitë e pronarëve të njësive të ndërtesës në lidhje me shfrytëzimin, administrimin dhe mirëmbajtjen e pjesëve, hapësirave dhe pajisjeve të përbashkëta të ndërtesës në bashkëpronësi.

Do të krijojmë një menaxhim të qëndrueshëm dhe efikas të objekteve të banimit të cilat janë në pronësi të përbashkët.

Do të themelohen shoqatat e pronarëve për ta mundësuar mirëmbajtjen e ndërtesave dhe renovimin e tyre dhe regjistrimin në kadastro. Pastaj:

Certifikim të administratorëve;

Stimulim të kompanive ndërtimore dhe organizatave joqeveritare për këtë veprimtari;

Renovim të objekteve të banimit duke ngritur Efiçencën e Energjisë (EE) në ndërtesat në bashkëpronësi;

Mundësi punësimi përmes personave juridikë që do të merren me administrimin e ndërtesave në bashkëpronësi për ushtrimin e menaxhimit, mirëmbajtjen apo shërbime të tjera për ndërtesën në bashkëpronësi;

Rritje të numrit të administratorëve;

Rritje të numrit të të punësuarve që do t'i kryejnë punët elektrike, të ujësjellësit dhe mekanike.

## REFORMA NË KADASTËR





Zhvillimet në fushën e administrimit të tokës, sektori në rritje i ndërimit dhe kërkesat gjithnjë në rritje nga palët e ndryshme për të dhëna të sakta, të sigurta, të hapura, qasje të shpejtë në të dhëna, janë duke imponuar ndryshime dhe avancime ligjore në teknologjinë informative edhe në vendin tonë. Po ashtu, ky sektor delikat është shpesh vatër korrupsioni dhe abuzimesh, prandaj, PDK-ja e sheh si një sektor nevralgjik për t’u trajtuar me shumë vëmendje, në mënyrë që të garantohet një Rimëkëmbje e mirëfilltë e vendit.

PDK-ja e ka të qartë vizionin dhe i ka të qarta reformat që duhen ndërmarrë me qëllim të avancimit të administrimit të tokës në një vijë me shtetet e zhvilluara dhe në pajtueshmëri me kërkesat e komunitetit të shteteve anëtare të BE-së. Duke freskuar administratën publike me kuadro të rinj të kualifikuar dhe profesionistë, PDK-ja do t’ia dalë që ta shndërrojë kadastrën e Kosovës në një model për gjithë rajonin dhe me standarde të njëjta me vendet më të zhvilluara të Evropës.

Reforma e kadastrës e parashikuar nga PDK-ja, duhet të qëndrojë në këto katër shtylla:

- a. Reforma ligjore,
- b. Reforma organizative,
- c. Reforma në teknologjinë informative, dhe
- d. Gjithëpërfshirja shoqërore.

PDK-ja me programin e vet qeverisës për kadastrë, parasheh vertikalizimin e administrimit të sistemit kadastral, respektivisht sistemimin e zyrave kadastrale komunale nën ombrellën e Agjencisë Kadastrale Kosovës. Programi qeverisës i PDK-së për kadastrë, do të obligonte që këto dikastere t’i udhëheqin profesionistët. Po ashtu, vertikalizimi do të ndikonte në eliminimin e mundësive për korrupsion. Aktualisht, ekziston një përshtypje që nëpër zyra kadastrale komunale ka pagesa joformale për shërbime, të raportuara nga qytetarët. Vertikalizimi i administrimit të kadastrës e pengon një gjë të tillë, pasi do të avanconte llogaridhënia dhe, për fund, do ta lehtësonte krijimin e politikave të avancuara për administrimin e tokës dhe do ta lehtësonte vendimmarrjen.

PDK-ja do ta bëjë edhe shpërndarjen e të dhënave të sakta, të harmonizuara e në kohë reale, në mënyrë obliguese. Përfitimi nga një proces i tillë do të ishte i madh, pasi qasja në grupe të shumta të të dhënave, prodhuar nga institucione të ndryshme, do të bëhej përmes një adrese të vetme, atë të gjeoportalit shtetëror.

Realizimi i këtyre reformave do të sjellë përfitime të drejtpërdrejta për të gjitha palët e interesit, veçanërisht për qytetarët, pasi që do të zvogëlohej burokracia, do të respektohej rregulli i aplikimit “i pari që aplikon, i pari shërbehet”, do t’u ofroheshin shërbime online të cilat do ta kursenin kohën për qytetarët, duke u monitoruar dhe shtuar konkurrencën e tregut të gjeodetëve dhe kompanitë gjeodete të licencuara, qytetarëve do t’u ofrohen më shumë mundësi zgjedhjesh, e që si çdo ekonomi e lirë e tregut, por e monitoruar, do të nënkuptonte ofrim të shërbimeve më të mira, më të sakta dhe më të shpejta për qytetarët.

Gjithashtu, përmes këtyre reformave do të luftohej informaliteti që sot ekziston në tregun e punës së gjeodetëve. Po ashtu, do të eliminohej mundësia e keqpërdorimit të detyrës zyrtare dhe korrupsioni pasi që zyrtarët në zyra kadastrale nuk do të kenë nevojë në asnjë hap të procedurës të kenë kontakt me palët e interesit që janë kryesisht qytetarët, por do të jenë më të fokusuar në kontrollimin, aprovimin dhe regjistrimin e të dhënave kadastrale.

Një tjetër dimension me rëndësi e që lidhet me rëndësinë që PDK-ja i kushton fuqizimit të grave, është gjithëpërfshirja. Të drejtat pronësore luajnë një rol të madh edhe për avancimin e mirëqenies së qytetarëve si përmes shitblerjes së pronave, po ashtu edhe përmes hipotekimit për nevoja të kredimarrjes. Po ashtu, PDK-ja rëndësi të veçantë do t’i kushtojë përfshirjes së grupeve potencialisht të marginalizuara në të drejtat pronësore, me theks të veçantë gratë, komunitetet pakicë dhe personat me nevoja të veçanta.

Programi qeverisës i PDK-së do të bëjë lehtësim të procedurave dhe masave ekzistuese për regjistrim të pronës në emër të dy bashkëshortëve, duke targetuar edhe ndryshimin e qëndrimit në përgjithësi rezistues në opinion, për trajtimin e gruas dhe të drejtës së saj në pronë.

**#PDK134**



**Enver  
HOXHAJ**

**1**

**#Rimëkëmbje**

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS

**#PDK134**

**#Rimëkëmbje**

PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS



*PARTIA DEMOKRATIKE E KOSOVËS*